RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

"Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë"

BASHKIA TEPELENË

Tiranë, tetor 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
sh.a	Shoqëri Anonime
sh.p.k	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			**2**
I		**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4**
	1.	Përshkrim i shkurtër i institucionit	4
	2.	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.	4
	3.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit:	4-5
	4.	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	5
	5.	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
	6.	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-7
	7.	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	7-8
	8.	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	8-9
II.		**HYRJA**	**10**
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	10
	2	Identifikimi i çështjes	10-11
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
	4	Përgjegjësitë e audituesve	12
	5	Kriteret e vlerësimit	12-13
	6	Standardet e auditimit	13-14
	7	Metodat e auditimit	14-15
	8	Dokumentimi i auditimit	15
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**15**
	1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-16
	2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16
	2.1	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	16-25
	2.1.6	Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe arkëtimi i detyrimeve.	25-33
	2.2	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.	33
	2.2.1	Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.	33
	2.2.2.	Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.	34
	2.2.3	Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.	34-66
	2.2.4	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.	67-75
	2.3	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.	76-86
	2.4	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e inspektoratit mbrojtjes së territorit të njësisë vendore (IMTV).	86-97
	2.5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM.	97-99
	2.6	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	99
	2.6.1	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	99-114
	2.6.2	Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.	114-120
	2.6.3	Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.	120-123
IV.		**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**123-148**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Tepelena kufizohet në veri me Bashkinë Memaliaj, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Gjirokastër dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një populsi prej 6,761 banorësh. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km^2 me një densitet prej 15.67 banorë/km^2 (disafish më i ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore). Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror. Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 531 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Tepelenë. Struktura organizative aktuale është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 7, datë 27.01.2023, dhe numri i punonjësve prej 235 vetash me VKB nr. 95, datë 25.11.2022.

2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij:

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"* nenit 50 *"Auditi i jashtëm"* pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *"1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjore".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Tepelenë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i auditimit përfshin dy komponentë kryesorë: Auditimin Financiar dhe Auditimin e Përputhshmërisë.

Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejt në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.

Ndërsa në Auditimin e Përputhshmërisë, synimi është të vlerësohet shkalla në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kodet e sjelljes dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Përmes këtyre dy komponentëve, auditimi synon të ofrojë një vlerësim të gjithanshëm mbi saktësinë e raportimit financiar, përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

4. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM-ve.
6. Të ndryshme të dala gjatë auditimit
6.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.
6.2. Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.
6.3. Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.

4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve, Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 32 gjetje dhe ka dhënë 43 rekomandime, nga ku masa organizative me 21 gjetje dhe 29 rekomandime, 3 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën 3,685,246 lekë, 8 gjetje dhe 9 rekomandime si efekt negativ dhe të ardhurat.

6. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***

- Në **3 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një ***dëm ekonomik në vlerën 3,685,246 lekë pa TVSH në*** projektet e investimit me objekt: *"Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi", "Ndërtimi i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari", "Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë, Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran".*
- Në **2 raste** janë konstatuar punime joefektive pa efiçencë dhe pa ekonomicitet, në kundërshtim me parimin e 3E në vlerën totale **63,989,547.84 lekë pa TVSH.**

- ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

- Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, rezultoi se:
a- Në **5** procedura prokurimi me fond limit 162,383 mijë lekë, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj.
b- Në **8** procedura prokurimi, me fond limit prej 201,338 mijë lekë, u konstatuan parregullsi në hartimin e kritereve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet;
c- Në **5** procedura prokurimi, u konstatua se OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Tepelenë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tij u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT

- ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit***

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, rezultoi se:

a- Në **2 (dy) raste**, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për katin përdhe me përdorim shërbim dhe distancat nga kufiri i pronës;

b- Në **3 (tre) raste** janë konstatuar problematika në lidhje me zhvillimin e objekteve në përputhje me projektet e miratuara, dhe në një rast zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar;

c- Në asnjë nga **4 (katër) aplikimet e miratuara**, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi;

d- Në të gjitha **7 (shtatë) raste**t, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Tepelenë konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 24,069 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 3,557 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 6,661 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **27,174 mijë lekë** dhe i përket 355 bizneseve.

- Nga auditimi i të ardhurave lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje më datë 31.12.2024, detyrimi i papaguar i taksës së ndikimit në infrastrukturë arrin vlerën 2,051 mijë lekë për 59 përfitues. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 394 mijë lekë për 16 persona, nga i cili është arkëtuar vetëm shuma 380 mijë lekë, duke rezultuar debitorë në vlerën 13 mijë lekë. Më datë 31.12.2025 gjendja totale debitore është 1,972 mijë lekë për 59 persona, shumë e cila përfaqëson të ardhura të paarkëtuara për Bashkinë Tepelenë

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se në territorin e Bashkisë Tepelenë për vitin ushtrimor 2025 kanë ushtruar aktivitetin 6 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, u konstatua se në fund të vitit 2025, gjithsej rezultojnë 3 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5-vjeçar, të cilat e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit.

Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se 3 subjekte kanë kryer total pagesën në vlerën 1,000,000 lekë, ndërsa 3 subjekte kanë kryer pagesa të pjesshme nga 200,000 lekë çdo vit.

- Nga auditimi i kontratave të qirasë rezultoi se Bashkia Tepelenë në datën 31.12.2025 ka 226 kontrata qiraje dhe nga këto 77 kontrata janë me vlerë debitore 6,911,839 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar për secilën prej kontratave të qirasë, konstatohet se, për arkëtimin e detyrimeve kontraktore, Bashkia Tepelenë nuk ka marrë masa në mënyrë shteruese, pra zgjidhjen e njëanshme të kontratës, në përputhje me përcaktimet në kontratë.

Në vlerën e detyrimit të palikuiduar për secilin subjekt, nuk është përllogaritur edhe kamatëvonesa.

- ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve***

Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Tepelenë, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:

- nuk është kryer inventarizimi i plotë i tyre;

- nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe të trojeve të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet akteve ligjore / nënligjore;
- nga 2996 asete në tërësi, Bashkia Tepelenë ka regjistruar dhe pajisur me certifikatë 216 asete me sipërfaqe 1,010.3 ha tokë të llojit pyje, kullota, truall, ose 7.2%;

Konstatohet se Bashkia Tepelenë nuk ka një strukturë të posaçme me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masat e nevojshme për të regjistruar në DVASHK Tepelenë, ndryshimet në kartelën e pasurive, të cilat janë dhënë me qira me afat mbi 9 vjet.

7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Tepelenë në lidhje me ***zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit*** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **3,685,246 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga moskryerja e punimeve.
- Bashkia Tepelenë në lidhje ***me procedurat e prokurimeve publike*** të marrë masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. AK për punët/mallrat/shërbimet për të cilat është e mundur ndarja në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, për rritjen e konkurrencës dhe efikasitetin. Në procedurat e prokurimit në vijim, të kryejë përllogaritjen e saktë të vlerës së kontratës. Titullari i AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST-ve në kualifikimin e OE, gjë që përbën risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
- Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPULMI) ***në lidhje me lejet e ndërtimit***, t'i kërkojë çdo subjekti që aplikon për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik.
- Në lidhje me ***inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e aseteve në ASHK*** Bashkia Tepelenë nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për NJA, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve**.** Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pahipotekuara të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Gjirokastër**.**
- Bashkia Tepelenë në lidhje ***me inspektoratin e mbrojtjes së territorit*** të marrë masa për plotësimin e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në përputhje me dispozitat ligjore (minimalisht 1 kryeinspektor dhe 5 inspektorë). Gjithashtu, nga Bashkia Tepelenë duhet të merren të gjitha masat që arsimimi i punonjësve të IMTV-së të jetë sipas kritereve të parashikuara.

- Për të hartuar periodikisht, respektuar dhe përmbushur planet dhe programet e punës (mujore/tremujore/vjetore). Gjithashtu, nga IMTV duhet të merren masa për të rritur bashkëpunimin me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim monitorimin e të gjitha lejeve të miratuara nga Bashkia Tepelenë;
- Për të raportuar periodikisht në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) çdo tre muaj për masat e marra nga IMTV;

- Për të kryer inspektime dhe për të mbajtur akt-konstatimet nga minimalisht dy punonjës të pranishëm;
- Për të dokumentuar në çdo rast me fotografi kundërvajtjet e konstatuara, si dhe të bëhen pjesë e dosjeve individuale të çdo procedure.

- ***Bashkia Tepelenë në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave***

- Të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 27,174 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mosndjekja e tyre.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 1,972 mijë lekë.
- Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Tepelenë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 2,000,000 lekë për subjektet.
- "O." sh.p.k me NIPT J.....I me vlerë detyrimi 800,000 lekë;
- "K." sh.p.k me NIPT J.....P me vlerë detyrimi 400,000 lekë;
- "S.G." sh.p.k me NIPT K.....V me vlerë detyrimi 800,000 lekë;

8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit:

I. Opinioni i pasqyrave financiare të vitit 2025:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Tepelenë për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2025 - 31.12.2025, ku përfshihen pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, konkludojmë se pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Tepelenë nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruar në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura; ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Tepelenë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të përllogaritur 7,055 mijë lekë dhe nivelin e gabimit të lejuar 706 mijë lekë.

Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më

poshtë:
Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime kontabël që kanë sjellë pasqyrim jo të drejtë të këtyre ngjarjeve, konkretisht:
- Llogaria 101 *"Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar"* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 207,182,272 lekë;
- Llogaria 231 *"Investime"* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 10,811,634 lekë;
- Llogaria 212 *"Ndërtesa dhe konstruksione"* është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 10,811,634 lekë;
- Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 13,084,637 lekë;
- Të ardhura të paarkëtuara në vlerën totale prej 31,146 mijë lekë, nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore, përfshirë detyrimet e debitorëve familjarë/privatë në vlerën 27,174 mijë lekë, taksën e ndikimit në infrastrukturë nga 59 debitorë në vlerën 1,972 mijë lekë, si dhe detyrimet e 3 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të hidrokarbureve në vlerën 2,000 mijë lekë.

Opinioni i auditimit të përputhshmërisë:
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Tepelenë për periudhën 01.01.2023-31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Tepelenë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar***[1].

Baza për opinionin:
Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:
- Nga auditimi i **5** procedurave me fond limit 162,383 mijë lekë nga **10** të audituara, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit;
- Nga auditimi i **10** procedurave në **8** procedura me fond limit prej 201,338 mijë lekë janë konstatuar shkelje të dispozitave të LPP, konkretisht parregullsi në hartimin e kritereve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet;
- Në **5** procedura nga **10** të audituara, u konstatua se OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Tepelenë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tij u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT;
- Në 3 raste të zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit janë konstatuar punime të pakryera me një dëm ekonomik në vlerën **3,685,246 lekë;**
- Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u evidentuan problematika në respektimin e kushteve urbane dhe projekteve të miratuara, përfshirë mosrespektimin e lartësisë së lejuar dhe distancave nga kufiri i pronës, si dhe mosrealizimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara. Gjithashtu, në 7 (shtatë) rastet e shqyrtuara nuk është kërkuar mendimi i autoriteteve përkatëse gjatë procesit të miratimit, ndërsa dokumentacioni teknik dhe shoqërues nuk ka qenë i plotë dhe janë evidentuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve.

[1] *Një "Opinion i kualifikuar", jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1021/1 Prot, datë 28.10.2025, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 30.10.2025 deri më datë 20.04.2026 në subjektin Bashkia Tepelenë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2025, u krye auditimi "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.S., Përgjegjës Grupi
2. K.H., Anëtar
3. P.X., Anëtar
4. B.B., Anëtar
5. A.D., Anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar dhe i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kritereve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 "Kriteret e vlerësimit". Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre. Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes:

Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

2.1 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj,).

2.1.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.1.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
2.2.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
2.2.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.
2.2.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

2.3 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
2.3.1. Auditim mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.
2.3.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave.

2.4 Mbi organizimin dhe funksionimin e inspektoratit mbrojtjes së territorit të njësisë vendore (IMTV).
2.4.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
2.4.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV. Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të paarkëtuara nga IMTV.
2.4.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM-ve.
2.5.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
2.6.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.
2.6.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
2.6.1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
2.6.1.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
2.6.1.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.
2.6.2. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.
2.6.3. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:
Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së Bashkisë, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

4. Përgjegjësia e audituesve:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;
Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:
Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm publik*"; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues"*; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010, *"Për miratimin e manualit të MFK"*; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, datë 16.10.2017, *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"*.
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008, *"Për huamarrjen e qeverisjes vendore"*; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* i ndryshuar; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" etj.; Udhëzimi i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të*

monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore".
- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*"; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar; Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*".
- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar*"; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave lokale*", i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*", me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave* " i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*"; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*"; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "*Për lejet e mjedisit*"; Ligji Nr. 107-2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"; Ligji nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "*Për miratimin e manualeve të ndërtimit*"; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar*"; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*"; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

6. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022 dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë,

miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit:

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[2]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

[2] ***ISSAI 1320 (ISA 320)*** *trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të auditimit financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuan në zyrën e protokollit të Bashkisë Tepelenë në datë 20.04.2026, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizëm nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin:

Tepelena kufizohet në veri me Bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Gjirokastër dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i Kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror. Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të programit të auditimit nr. 1021/1 prot, datë 28.10.2025, i ndryshuar të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Bashkinë Tepelenë u ushtrua auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2025, sipas drejtimeve:

2.1 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
2.3 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
2.4 Mbi organizimin dhe funksionimin e inspektoratit mbrojtjes së territorit të njësisë vendore (IMTV).
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas vkm.
2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.1 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak ***"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026"*** për miratim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*.
- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 2 datë 10/01/2023.
- **Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** është paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me VKB nr. 31, datë 29.03.2023. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
- **Tavanet Buxhetore** për PBA 2024-2026 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr. 31, datë 29.03.2023 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Referuar pikës nr. 64 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2024-2026 janë miratuar me VKB nr. 80, datë 21/09/2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 814/1 prot, datë 28/09/2023 në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, neni 37, pika 1 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 79 "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik".*
- **Faza e dytë e PBA** 2024-2026

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në kundërshtim me udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pika 82 " *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, bëhen pjesë e dokumentit të projektit të PBA".*

Pika 84 "Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë".

PBA 2024-2026 është miratuar me VKB nr. 87, datë 30.11.2023 dhe buxheti i vitit 2024 për Bashkinë Tepelenë është miratuar me VKB nr. 88, datë 30.11.2023. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela 1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Tepelenë dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	105,598	98,084	104,580
2	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	36,664	39,240	39,884
3	Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)	3,333	3,866	3,602
4	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	10,703	14,359	13,625
5	Rrjeti rrugor rural (04520)	20,799	21,571	24,086
6	Menaxhimi i mbetjeve (05100)	33,052	33,430	3,430
7	Shërbimet Publike vendore (06260)	33,725	32,925	36,260
8	Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)	10,436	10,235	10,235
9	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë (0910)	66,673	69,419	67,420
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)	12,509	15,482	15,482
11	Përkujdesje Sociale fëmijët (10430)	7,570	7,862	7,582
12	Fonde Rezervë	3,000	5,000	5,000
13	Fond Emergjencë	3,000	5,000	5,000
	Totali	**347,062**	**356,473**	**336,186**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 2: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	192,783	55.5	193,961	54.4	196,161	53.6
2	Sigurime (601)	30,050	8.7	28,695	8.1	28,196	7.7
3	Shpenzime operative (602)	56,179	16.2	59,338	16.6	63,620	17.4
4	Shpenzime (603)	0	0	0	0	0	0
5	Shpenzime (604)	5.650	1.6	5,150	1.4	5,150	1.4
6	Shpenzime (606)	4.500	1.3	5.500	1.5	6,500	1.8
7	Shpenzime (609)	20,000	5.8	22,500	6.3	23,500	6.4
8	Shpenzime për investime (230-231)	37,900	10.9	41,329	11.7	43,059	11.7
	Totali	**347,062**		**356,473**		**366,186**	

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 3: Sipas PBA 2025-2027 Bashkia Tepelenë tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara	2,000	2,000	2,000
I	**Totali**	**2,000**	**2,000**	**2,000**
1	Nga taksat	63,000	65,000	67,000
II	**Totali**	**63,000**	**65,000**	**67,000**
1	Transferta e pakushtëzuar	155,192	162,320	169,743
2	Transfertë specifike	126,870	127,153	127,443
III	**Shuma e transfertave**	**282,062**	**289,473**	**297,186**
	Totali I burimeve të veta (I +II+III)	**347,062**	**356,473**	**366,186**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.

Për vitin 2025, buxheti është miratuar me vendim të KB nr. 72, datë 27.11.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 975/1 datë 13.12.2024.
Sipas VKB nr. 72 *"Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025"* rezulton se të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën **63,000 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **129,123 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **152,939 mijë lekë.**
I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2025 paraqitet në vijim:

Tabela 4: Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2025	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor 2024	65,000	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	155,192	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	126,870	
4	Paga (600)		192,783
5	Sigurime shoqërore (601)		30,050
6	Shpenzime operative (602)		56,179
7	Transferta (604-606)		10,150
8	Fondi Rezervë dhe kontingjencës (609)		20,000
9	Investime (230-231)		37,900
Totali i buxhetit		**347,062**	**347,062**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **347,062 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon:
Gjatë vitit 2025 sipas VKB nr. 72, datë 27.11.2024 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 37,900 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.
- Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 28,200 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2025 janë në vlerën 9,700 mijë lekë.

Tabela 5: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Fondi limit	2025	2026	2027
1	Implementim i sistemit të ri në fushën e tatim-taksave	2,500	2,500	0	0
2	Rikonstruksion rrugë në qytet+ blloqe banimi, (Detyrim i prapambetur)	7,553	1,200	2,997	3,356
3	Sistemim shtresa asfaltike në qytet	4,305	0	0	4,305
4	Rruga e Birbilenjeve (Detyrim i prapambetur)	3,450	1,500	1,950	0
5	Rikonstruksion rrugë fshati Mamaj, (Detyrim i prapambetur)	6,000	3,000	3,000	0
6	Bashkëfinacim, Rikonstruksion Shkolla Avni Rustemi 15%	14,930	4,500	5,645	4,785
7	Rikonstruksion rrugë rurale	14,139	5,000	685	8,454
8	Blerje kontenierë për mbetjet urbane	7,200	1,200	3,000	3,000
9	Rikonstruksion salla e Këshillit Bashkiak	800	800		
Total Investime		**60,877**	**19,700**	**17,277**	**23,900**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Tabela 6: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Fondi limit	2025	2026	2027
1	Rikonstruksion rrugë fshati Mamaj (Detyrim i prapambetur)	4,254	2,000	2,254	-
2	Rikonstruksion blloqe banimi (ish kinemaja), (Detyrim i prapambetur)	6,200	1,200	2,500	2,500
3	Rikonstruksion godina Njësia qendër	9,500	5,000	3,000	1,500
4	Rikonstruksion lera dhe përmirësim kullota	8,500	1,500	3,500	3,500
5	Mbikqyrje shkolla 9 vjeçare Avni Rustemi	2,139	1,000	1,139	-
6	Hartim plan mbarështimi pyje, kullota	4,442	1,500	1,471	1,471
Total Investime		**35,035**	**12,200**	**13,864**	**8,971**

Burimi: Bashkia Tepelenë

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë.

Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon: Në **aneksi nr. 2/2/1** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela nr. 7: Paraqiten të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB përkatës:

000/ lekë

Burimet e financimit	**Buxheti fillestar 2025**	**Ndryshimet gjatë vitit 2025**		**Buxheti përfundimtar**	**Emërtimi i shpenzimeve**	**Buxheti fillestar 2025**	**Buxheti përfundimtar**
		Shtesa	**Pakësime**				
Të ardhura të trashëguara	2,000	2,839	-	4,839	Art. 600 Paga	192,783	187,485
Transfertë e pakushtëzuar	129,123	-	-	129,123	Art. 601 Sigurime	30,050	30,050
Transfertë e pakushtëzuar sektoriale	152,939	-	-	153,939	Art. 602 Shp. Operative	56,179	114,218
Të ardhura të vitit	63,000	12,500	-	75,000	Art. 603 Subvencione	-	-
Sponsorizime	-	-	-	-	Art. 604 Transferta korente familjare	5,650	7,950
Grand UNDP	-	-	-	-	Art. 606 Transferta të buxhetit familjare	4,500	8,250
Transfertë e kushtëzuar	-	-	-	-	Art 609 Fonde Rezerve	20,000	-
	-	-	-	-	Art 231 Investime	37,900	24,874
Total	**347,062**	**15,339**	**-**	**362,401**	**Total**	**347,062**	**372,827**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tepelenë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tepelenë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Tepelenë, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Në **aneksi nr. 2/2/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit të auditimit paraqitet të dhënat realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar akt-rakordimet me thesarin.

Tabela nr. 8: Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve në mënyrë të përmbledhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lek

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani përfundimtar 2025	Plani i çelur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	192,783	187,485	187,485	183,012	97
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	30,050	30,050	30,050	28,733	95
Shpenzime operative (602)	56,179	114,218	114,218	110,742	96
Transferta tek organizatat (604)	5,650	7,950	7,950	5,940	74
Transferta tek individët (606)	4,500	8,250	8,250	7,957	96
Fondi rezervë+e kontingjencës (609)	20,000	-	-	-	-
Shpenzime për Oponenca teknike (230)	4,500	1,500	1,500	1,500	100
Shpenzime për Investime (231)	33,400	23,374	23,374	**14,874**	63
Total Bashki + Institucione	**347,062**	**372,827**	**372,827**	**352,760**	**94**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 352,760 mijë lekë nga 372,827 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 94%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

Shpenzimet për investime llog. 230-231 nga buxheti i Bashkisë janë realizuar në masën 63%.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime nga të ardhurat e Bashkisë Tepelenë në shumën ***24,874 mijë lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura) dhe janë ***realizuar në vlerën 16,375 lekë, ose në masën 65.8%***.

Tabela realizimit te Investimeve 2025:

Investimet e realizuara me fonde të Bashkisë Tepelenë.

1-Rruga e Birbilenjëve (detyrim i prapambetur) në vlerën 1,500 mijë lekë.
2-Blerje kontenierë në vlerën 861 mijë lekë.
3-Rikonstruksion rruga fshati Manaj në vlerën 2,000 mijë lekë.
4-Rikonstruksion lera dhe përmirësim kullota në vlerën 1,500 mijë lekë.
5-Rikonstruksion Njësia qendër në vlerën 1,942 mijë lekë.
6-Bashkëfinancim shkolla Avni Rustemi në vlerën 4,500 mijë lekë.
7-Hartim plan mbarështimi (pyje, kullota) në vlerën 1,500 mijë lekë.
8-Blerje mjet transporti në vlerën 1,758 mijë lekë.
9-Blerje pajisje kompjuterike në vlerën 814 mijë lekë.

Investimet e realizuara me fonde të buxhetit të shtetit.

1-Blerje mjete fadromë dhe kamion në vlerën 8,568 mijë lekë.
2-Përmirësim i banesave për familjet e pafavorizuara në vlerën 7,870 mijë lekë.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontingjencës, emergjencë.

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontingjencës.
Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontingjencës është në total në shumën 20,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 72 datë 27.11.2024 *"Për miratimin e Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 i Bashkisë Tepelenë"*, dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 975/1 datë 13.12.2024.

b. Fondet e emergjencës.
Në bazë të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 65, nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) Bashkia Tepelenë ka përfituar fonde. Bazuar në VKM nr. 414, datë 08.07.2021 *"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"* dhe me VKB përkatëse është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira, duke i detajuar ato, sipas zërave të shpenzimeve dhe më pas është kryer prokurimi i tyre, sipas të cilave janë kryer shpenzimet.

Për vitin 2025 me shkresën nr. 492/1, datë 25.02.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" Bashkisë Tepelenë i është akorduar *fondi në vlerën **2,588 mijë lekë*** me VKB nr. 14 datë 27.02.2025 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura në **tabelën nr. 9** si mëposhtë:

në 000lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Ndihme financiare për familjet e dëmtuara nga zjarret	819	235	584
2	Blerje materiale ndërtimi për familjet ne kushte emergjencë	1,769	1,769	0
Total		**2,588**	**2,004**	**584**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Gjatë vitit 2025 nga fondet e bashkisë janë përdorur edhe 800 mijë lekë për ndihmë financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri. Këto fonde jepen të detajuara si më poshtë:
- Me VKB nr. 14 datë 27.02.2025 për dhënien e ndihmës financiare për 44 familje për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tyre etj në vlerën 1,769 mijë lekë.
- Me VKB nr. 32, datë 30.05.2025 për dhënie ndihmë financiare për rikonstruksion.banese për 3 familje dhe 400 mijë lekë dhe dëmtime nga zjarri për 2 familje 400 mijë lekë
- Me VKB nr. 34, datë 30.05.2025 për dhënie ndihmë financiare për emergjencë për dëmtime nga zjarri për 1 familje në shumën 235 mijë lekë

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit
Për vitin 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.
Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2024" me shkresën nr. 876, datë 13.05.2025

"Raport monitorimi Janar-Gusht 2024" me shkresën nr. 1610, prot datë 11.09.2025

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Bashkia Tepelenë në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 37,028,193 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2025 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2025 vlera 16,500 mijë lekë si mëposhtë.

Tabela nr. 10: Informacion për planifikimin e likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2025	37,028,193	16,500,000	nr. 72, datë 27.11.2024	11,000,000	5,500,000

Burimi: Bashkia Tepelenë

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 260 prot, datë 03/02/2026.

Tabela Nr. 10: Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2025:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2025 - 31.12.2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	-		-
b. Investime nga Bashkia	3,708,229	9,051,352	12,759,581
INVESTIME:	-	-	-
Mallra dhe shërbime	33,196,986	(229,750)	32,967,236
Vendime gjyqësore		424,600	424,600
Totali:	**37,028,214**	**9,123,203**	**46,151,417**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta Bashkia Tepelenë nuk duhet të marri angazhime të reja buxhetore, fillimisht duhet të shlyerje detyrimet nga kontrata e mëparshme. Për këtë duhet të rishikohet edhe buxheti i vitit të ardhshëm duke pakësuar disa nga investimet e parashikuara për mos të pasur përkeqësim të situatës së detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 55 "Probleme financiare"

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91.

Tabela Nr. 11: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

Në lekë

		Viti 2025		
NR	Emërtimi	Stoku në vlerë ne fund te vitit 2024	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua afatgjatë			

a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**46,151,417**		**13.08%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	424,600		
4864200	Det. Prap. Shërbime	5,418,290		
4864201	D.P.Eneri Elektirke	7,920,295		
4864300	Det. Prap. Mirëmbajtje	8,714,545		
4864400	Det. Prap. Investime	12,759,581		
4864500	Det. Prap. Rimbursi. TVSH			
4864600	Mallra	10,914,106		
4864900	Det. Prap. Te Tjera			
4864601	Det. Prap. Sig. Shoqërore			
4864602	Det. Prap. Sig. Shendet			
4864603	Det. Prap. Ardh. Personal			
4864604	Det. Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans. Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**46,151,417**	**352,760,844**	**13.08%**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela Nr. 12: Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025	Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2025	Detyrimi në lekë më 31.12.2025
Dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna	0	0	0	0	0
Dëmshpërblim pension invaliditeti	0	0	0	0	0
Vendime të tjera gjyqësore	122,999	1	424,600	122,999	424,600

Burimi: Bashkia Tepelenë

Tabela nr. 13: Paraqiten në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme.

Emri i kreditorit		Vendim Gjykate nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit te Gjykatës	Gjendja e palikuiduara 31/12/2024	Vendime të ardhura gjatë vitit 2025		Detyrimi total	Likujduar ne vitin 2025	Gjendja e palikuiduar më 31.12.2025	
						Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit				
1		2		3	4	5	6	7	8=5+7	9	10=8-9
Dëmshpërblim të tjera											
Z.	Z	Nr. 89-2025/735/511 datë 24.04.2025	Përfitimi suplementar	424,600	0	Nr. 89-2025/735/511 datë 24.04.2025	424,600	424,600	0	424,600	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

Bashkia Tepelenë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2025 ka shpenzuar vlerën 122,999 lekë, e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page.

Vlera totale **122,999 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025 nga Bashkia Tepelenë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analizë nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.*

2.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR dhe Ministrive, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka 5 (pesë) kontrata aktive të cilat janë më bashkëfinancim me Ministritë e Linjës. Projektet e financuara i përkasin periudhës 2021-2025 si mëposhtë:

Tabela Nr. 14: Projektet e investime të financuara nga Ministritë e Linjës:

Nr.	Procedura te realizuara (Emërtimi)	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Burimi i financimit	Financimi sipas viteve	Likuidimi sipas viteve	Likuidimi deri në 31.12.2025	Sa është pa likuiduar financim i ardhshëm	Sa pa likuiduar për mungesë burimesh financimi
1	Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "A.Rustemi" (është likuiduar nga fondet e buxhetit.	108,776,265	107,997,000	Vendimi KB nr. 88, datë 30.11.2023 dhe shkresa M.Arsimit	2023=55,476,000 2024=60,660,000 2025=4,500,000 2026=8,960,400 Totali=129,596,400	2023=55,476,000 2024=60,660,000 2025=4,500,000	120,636,000	8,960,400	8,960,400
2	Projekt zbatim objekti "Mikriptje dhe histori ne Divanin e Pashait"	15,869,299	14,758,448	FZHSH					
3	Përmirësimi I banesave sociale për familjet e pafavorizuara (M.ekonomisë)	17,455,701	15,197,648	Buxheti shtetit dhe buxheti pavarur me VKB nr. 6, datë 30.1.2025	2025=8,378,736 2026=8,378,736 2026=4,198,368 nga Bashkia Totali=20,955,840	0	0	0	0
4	Drejtimi i punimeve "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë"	2,893,111	2,891,444	Buxheti shtetit, Ministria Infrastrukturës dhe Energjitikes shkresa nr. 232, date28/01/2021	2021=694,347 2022=347,173 2023=347,173 Vitet e tjera =2,083,040 Totali=3,469,733	2021=694,347 2022=340,000 2023=0 2024=2,336,000	3,370,347	99,386	Financimi sipas viteve
5	Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë" (ka mbetur vetëm 15 mil)	195,833,333	193,889,182	Buxheti Shtetit, Ministria e infrastrukturës dhe energjisë, shkresa nr. 376, datë 12/02/2021	2021=67,000,000 2022=20,000,000 2023=0 2024=145,667,000 Totali=232,667,000	2021=67,000,000 2022=20.000.000 2023=0 2024=130.481.000	217,481,000	15,186,000	Finacim Në pritje të financimit

Burimi: Bashkia Tepelenë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi

- z. T.P. në cilësinë e ish-Kryetarit të Bashkisë Tepelenë
- z. S.K. në cilësinë e Drejtori i Financës dhe Buxhetit

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.6. Burimi i krijimit i të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e Bashkisë Tepelenë e aplikuar për vitin 2024-2025 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 797, datë 20.12.2023, me objekt "Për miratimin e strukturës, organigramës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Tepelenë" në të cilën përfshihet edhe Sektori i Taksave dhe Tarifave.

Tabela nr. 15: Struktura e sektorit të tatim- taksave vendore për vitin 2024-2025.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni
	Sektori i Tatim Taksave	
1	G.G.	Përgjegjës sektori
2	R.H.	Specialist i taksave
3	B.K.	Specialist i taksave

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Tepelenë për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin nr. 85, datë 30.11.2023, të Këshillit Bashkiak me objekt *"Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Tepelenë"*. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2024-2025 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Tabela nr. 16: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2024-2025, Bashkia Tepelenë

lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2024	Fakti 2024	% e realizimit/plan	Plani 2025	Fakti 2025	% e realizimit/ plan
A	**Të ardhurat nga taksat**	**42,684,000**	**31,555,608**	**73**	**37,384,000**	**32,141,134**	**85**
1	Taksa mbi ndërtesën	5,460,000	4,125,126	75	5,460,000	4,227,573	77
2	Taksa mbi tokën bujqësore	6,900,000	4,321,164	62	1,100,000	1,977,817	179
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	20,000,000	10,305,799	51	20,000,000	11,321,334	56
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	12,000	0	0	12,000	0	0
5	Taksa e regjistrimit të automjeteve	5,621,000	5,563,725	98	5,621,000	7,538,977	134
6	Taksë tabele	233,000	486,876	208	233,000	559,480	257
7	Taksa e Rentës minerale	120,000	59,817	49	120,000	410,508	342
8	Taksa e truallit	498,000	839,858	168	498,000	594,512	119
9	Tatim i thjeshtuar i biznesit të vogël	495,000	194,096	39	495,000	5,000	1
10	Taksë tregu	250,000	444,000	177	250,000	581,500	232
11	Taksë kullotë	595,000	1,009,761	169	595,000	1,161,649	195
12	Tatim mbi të ardhurat personale TAP	2,500,000	4,205,385	168	3,000,000	3,762,783	125
B	**Të ardhurat jo tatimore**	**30,316,000**	**43,435,114**	**143**	**27,616,000**	**30,198,446**	**109**
1	Tarifa e pastrimit	4,577,000	8,118,036	177	5,077,000	6,836,096	134
2	Tarifa për hapësirat publike	429,000	728,738	169	429,000	587,128	136
3	Tarifa e ndriçimit	3,406,000	3,066,048	90	3,406,000	3,116,920	91
4	Tarifa e gjelbërimit	1,785,000	2,573,637	144	2,085,000	2,776,262	133
5	Tarifa për reklamë	0	0	0	0	0	0
6	Tarifa për parkim	0	0	0	0	0	0
7	Tarifa e shërbimit veterinar	180,000	65,000	36	180,000	0	0
8	Tarifa për shërbime të tjera administrative	0	0	0	0	0	0
9	Tarifa për dhënie lejesh, licencash dhe autorizime	600,000	850,000	141	0	0	0
10	Tarifë ndotje mjedisi	0	0	0	0	0	0
11	Qira kullotë	5,630,000	6,934,096	123	5,630,000	2,895,744	51
12	Qira tokë	1,075,000	2,795,096	260	1,075,000	1,339,136	124
13	Qira ndërtese	70,000	217,510	310	70,000	33,090	47
14	Dhurata dhe sponsorizime	0	100,000		0	2,138,333	

15	Të ardhura nga kamata	110,000	117,650	106	110,000	27,052	24
16	Të ardhura nga pagesat kopsht dhe çerdhe	1,200,000	803,420	66	1,200,000	989,190	82
17	Sekuestrime dhe zhdëmtime	0	0	0	0	0	0
18	Të tjera jotatimore	11,254,000	17,065,880	151	8,354,000	9,459,492	113
19	Grant nga nivele të tjera	0	0	0	0	0	0
20	Tarifa për shërbim komunitar	0	0	0	0	0	0
Totali		**73,000,000**	**74,990,722**	**102**	**65,000,000**	**62,339,580**	**95**

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë

Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **73,000 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **74,990 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit Tepelenë ose në masën **102%** me një diferencë mbirealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **1,990 mijë lekë.** Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Qira tokë" është planifikuar në vlerën 1,075 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,795 mijë lekë ose realizuar në masën 260%.

b. "Tatim mbi të ardhurat personale TAP" është planifikuar në vlerën 2,500 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,205 mijë lekë ose realizuar në masën 168%.

c. "Qira kullotë" është planifikuar në vlerën 5,630 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 6,934 mijë lekë ose realizuar në masën 123%.

d. "Tarifë pastrimi" është planifikuar në vlerën 4,577 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,118 mijë lekë ose realizuar në masën 177%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Taksa e ndikimit në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 20,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,305 mijë lekë ose realizuar në masën 51%.

b. "Taksa mbi tokën bujqësore" është planifikuar në vlerën 6,900 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,321 lekë ose realizuar në masën 62%.

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **65,000 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **62,339 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit të datës 13.01.2025, me Degën e Thesarit Tepelenë ose në masën **95%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **2,661 mijë lekë.** Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Taksa mbi tokën bujqësore" është planifikuar në vlerën 1,100 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,977 mijë lekë ose realizuar në masën 179 %.

b. "Taksë mbi regjistrimin e automjeteve" është planifikuar në vlerën 5,621 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,538 mijë lekë ose realizuar në masën 168%.

c. "Tatim mbi të ardhurat personale" është planifikuar në vlerën 3,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,762 mijë lekë ose realizuar në masën 125%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Taksa e ndërtesës" është planifikuar në vlerën 5,460 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,227 mijë lekë ose realizuar në masën 77%.

b. "Taksa e ndikimit në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 20,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,321 mijë lekë ose realizuar në masën 56%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon

negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Nga DTT nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Tepelenë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj, në dëm të interesave të publikut.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore", neni 64*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c",* Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar,* Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200.*

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2024-2025 nga Bashkia Tepelenë, miratuar me vendimin nr. 8 prot, datë 27.01.2023, nga Kryetari i Bashkisë me objekt *"Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Tepelenë"*, nuk është caktuar personi përgjegjës i cili ka për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.
Të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK Gjirokastër për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR Gjirokastër në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura dhe Dega e Doganës Gjirokastër për rentën minerare) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Tepelenë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit duke kuadruar me akt-rakordimin e të ardhurave. Të ardhurat e arkëtuara nga agjentët tatimorë për vitin 2024-2025 paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela nr. 17: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2024 nga agjentët tatimore.

lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2024	Realizimi 2024	% e Realizimit	Plani 2025	Realizimi 2024	% e Realizimit
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (DRT)	495,000	194,096	39%	495,000	5,000	1
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (DRT)	2,500,000	4,205,385	168%	3,000,000	3,762,783	125
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (DSHTR)	5,621,000	5,563,725	98%	5,621,000	7,538,977	134
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (ASHK)	12,000	0	0%	12,000	0	0
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	120,000	59,817	49%	120,000	410,508	342
Totali		**8,748,000**	**10,023,023**		**9,248,000**	**11,717,268**	**126**

Burimi: Bashkia Tepelenë

- Për vitin 2024 ndërmjet DTT Bashkia Tepelenë dhe Degës së Doganës Gjrokastër nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore.

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Tepelenë i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët

tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Tepelenë por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Tepelenë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore", neni 117*, ku përcaktohet që *"Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave".* Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 7,* Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006*, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 15* si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, *"Për taksat kombëtare".*

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore:

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e palikuiduara etj, në Bashkinë Tepelenë kryhet në programin Excel. Bashkia Tepelenë për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë ka lidhur aktmarrëveshje më Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a. Për vitin 2025 është lidhur aktmarrëveshja me nr. 242 prot, datë 05.02.2025.

Tabela nr. 18: Arkëtimet nga UKGJ viti 2024:

Lloji i Taksave/Tarifave	Qyteti Tepelenë	NJA Qendër	NJA Kurvelsh	NJA Lops	Totali
Taks Ndertese	1,236,490.33	362,580.50	175,430.76	58,169.28	1,832,670.87
Tarifë Ndriçimi	1,032,854.47	244,124.34	108,328.41	34,562.38	1,419,869.60
Tarif Pastrimi	1,825,952.41	263,950.05	113,619.07	35,270.52	2,238,792.05
Tarif Gjelberimi	839,913.07	22,610.88	-	-	862,523.95
Tarifë Varreza	841,133.23	135,139.20	60,470.00	19,842.24	1,056,584.67
Totali	**5,776,343.51**	**1,028,404.97**	**457,848.24**	**147,844.42**	**7,410,441.14**

Burimi: BashkiaTepelenë

Tabela nr. 19: Arkëtimet nga UKGJ viti 2025:

Lloji i Taksave/Tarifave	Qyteti Tepelenë	NJA Qendër	NJA Kurvelsh	NJA Lops	Totali
Taks Ndertese	1,210,731.31	355,550.82	207,946.16	67,364.64	**1,841,592.93**
Tarifë Ndriçimi	927,516.89	217,960.67	125,539.70	38,299.13	**1,309,316.39**
Tarif Pastrimi	1,755,097.79	241,197.86	128,017.83	39,029.26	**2,163,342.74**
Tarif Gjelberimi	852,739.58	22,034.79	-	-	**874,774.37**
Tarifë Varreza	854,342.62	137,797.27	74,266.09	23,695.51	**1,090,101.49**
Totali	**5,600,428.19**	**974,541.41**	**535,769.78**	**168,388.54**	**7,279,127.92**

Burimi: BashkiaTepelenë

Bashkia Tepelenë në fund të çdo muaj ka mbajtur akt rakordimin me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a. Në akt rakordimet e mbajtur përcaktohet shuma e arkëtuar sipas llojit të taksave/tarifave vendore dhe e ndarë sipas arkëtimeve të qytetit dhe fshatrave.

Sektori i Tatim Taksave nuk disponon regjistër për abonentët familjarë të cilëve ju lind detyrimi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore sipas pakëtës fiskale të Bashkisë Tepelenë.

Gjithashtu nuk disponohet informacion nga sektori i tatim taksave për debitorët për taksat dhe tarifat vendore të cilët kanë një kontratë me UKGJ.

Ng UKGJ tarifohen vetëm abonentët familjarë të cilët kanë një kontratë me këtë shoqëri abonentët të cilët nuk kanë kontratë nuk ngarkohem me detyrimin për taksa dhe tarifa vendore nga kjo shoqëri dhe as nga Bashkia Tepelenë.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i

ndryshuar", Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

Nga rakordimet e kryera nga Sektori i Tatim- Taksave me UKGJ në fund të vitit 2024 kjo shoqëri nuk ka kaluar fonde në vlerën 18,868,344 lekë të Bashkisë Tepelenë. Fondet e pa transferuara nga UKGJ për vitin 2024 paraqiten në **aneksi nr. 2/2/1/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.
Nga rakordimet e kryera nga Sektori i Tatim- Taksave me UKGJ në fund të vitit 2025 kjo shoqëri nuk ka kaluar fonde në vlerën 16,442,301 lekë të Bashkisë Tepelenë në kundërshtim me akt-marrëveshjen nr. 242 prot, datë 05.02.2025 neni 7. Fondet e pa transferuara nga UKGJ për vitin 2025 paraqiten në **aneksi nr. 2/2/1/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Taksa e tokës bujqësore:

Bashkia Tepelenë për vitin 2024 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 6,900 mijë lekë realizimi i kësaj taksë për vitin 2024 është në vlerën 4,321 mijë lekë në vitin 2024 ka parashikuar të arkëtoi në vlerën 1,100 mijë lekë realizimi i kësaj taksë për vitin 2025 është në vlerën 1,977 mijë lekë.
Sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Tepelenë sipërfaqja totale e tokës bujqësore i përket 2,595 familjeve dhe sipërfaqja e ndarë e tokës është 3,317.6 ha.

Tabelën nr. 20: Paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Cërrik.

Nr.	Njësitë Administrative	Tokë bujqësore gjithsej	Numri familjeve që kanë marrë AMTP	Sipërfaqja e tokës ndarë në fakt ligji nr. 7501	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr. 7501/në hektar							Totali i kategorive	Sipërfaqe e tokës së pandarë
		Ha në 1/8/1991			I	II	III	IV	V	VI	VII		
1	Tepelenë	3.1	9	3.1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Njësia Qendër	1,984.9	1514	1,201.9	-	-	-	-	-	-	-	-	**783**
3	Njësia Kurvelesh	634.9	646	257.9	-	-	-	-	-	-	-	-	**377**
4	Njësia Lopës	694.7	426	356.7	-	-	-	-	-	-	-	-	**338**
Shuma		**3,317.6**	**2595**	**1,819.6**	-	-	-	-	-	-	-	-	**1,498**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Abonentët familjarë debitorë për taksën bujqësore në njësitë administrative dhe në qytetin e Tepelenës paraqiten në fund të vitit 2024 për vlerën 11,604,351 lekë. Gjatë vitit 2025 ka pasur shtesa për vlerën 315,542 lekë dhe totali progresiv është në vlerën 11,919,893 lekë ky detyrim i përket 2.278 familjeve.
Nga strukturat e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Tepelenë në vitin 2024 është hartuar regjistri i taksës bujqësore dhe disponohet vetëm në formatin excel.
Në **tabelën nr. 21**: Paraqiten debitorët për taksën e tokën bujqësore

lekë

Nr	Njësia	Debia progresive 31.1.2024	Shtesa 2025	Debia progresive 31.12.2025
1	Taksa e tokës bujqësore	11,604,351	315,542	11,919,893
	Total	**11,604,351**	**315,542**	**11,919,893**

Punoi: Grupi i Auditimit

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Tepelenë nuk disponon sistem elektronik për administrimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët private. Të dhënat e abonentëve privatë janë të regjistruara

vetëm në excel nuk disponohet regjistër fizik në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni 7.

Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Situata e lëvizjes së subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Tepelenë bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Në **tabelën nr. 22**: Lëvizjet e biznesit gjatë vitit 2024-2025.

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet+Nj. A	1	Biznesi i Madh	2024	116	4	0	120
Qytet+Nj. A	2	Biznesi i Vogël	2024	369	13	6	376
Total 1 + 2				**485**	**17**	**6**	**496**
Qytet+Nj. A	3	Biznesi i Madh	2025	120	10	0	130
Qytet+Nj. A	4	Biznesi i Vogël	2025	376	28	3	401
Total 3 + 4				**496**	**38**	**3**	**531**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Nga informacioni i mësipërm është kërkuar praktika e mbajtur me QKB për bizneset të cilat kanë aplikuar për mbyllje ose pezullim aktivitetit gjatë vitit 2024-2025 paraqiten në **aneksi nr. 2/2/1/3 dhe aneksi nr. 2/2/1/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

<u>Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët biznes:</u>

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të ardhurave Vendore Bashkia Tepelenë janë verifikuar regjistrat elektronike për biznesin e madh.

Referuar të dhënave në marra nga regjistri elektronik sepse nga regjistri fizik nuk disponohet informacion për ngarkesën fiskale dhe debinë e tyre u konstatua se për tarifat vendore abonentët privatë janë ngarkuar në përputhje me paketën fiskale nr. 85, datë 01.12.2023 *"Për miratimin të disa shtesave në sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë".*

Nga regjistri elektronik u verifikuan të dhënat për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Tarifa e pastrimit për biznesin e madh është ngarkuar në përputhje me paketën fiskale të Bashkisë Tepelenë.

<u>Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore:</u>

Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **13,871,855 lekë.** Përgjatë vitit 2024 për llogari të detyrimeve që i përkasin vitit 2023 është likuiduar vlera 2,161,867 lekë si dhe janë krijuar debitorë në vlerën 5,360,059 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2024, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **17,070,047 lekë, borxhi tatimor është i kontabilizuar.**

Në tabelën nr. 23: Të dhënat në mënyrë analitike për vitin 2024 paraqiten si mëposhtë:

lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2023	Deri më datë 31.12.2023 (zbritur pagesat e 2024)	2024	Totali progresiv	Nr i subjektev e debitore
1	Subjektet fizik biznesi i vogël	9,328,486	1,268,276	2,325,367	10,385,577	209
2	Subjektet juridik biznesi i madh	11,536,571	977,322	1,744,436	12,303,685	60
3	Institucione Shtetërore	769,648	20,000	114,880	864528	7
4	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administrative Qendër	599,060	286,324	203,092	515,828	18
Totali		**22,233,765**	**2,551,922**	**4,387,775**	**24,069,618**	**294**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në tabelën nr. 24: Të dhënat në mënyrë analitike për vitin 2025 paraqiten si mëposhtë:

lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2024	Deri më datë 31.12.2024 (zbritur pagesat e 2024)	2025	Totali progresiv	Nr i subjekteve debitore
1	Subjektet fizik biznesi i vogël	10,385,577	-	1,568,965	11,954,542	257
2	Subjektet juridik biznesi i madh	12,303,685	-	1,257,376	13,561,061	68
3	Institucione Shtetërore	864,528	-	176,380	1,040,908	8
4	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administrative Qendër	515,828	-	101,814	617,642	22
Totali		**24,069,618**	**-**	**3,104,535**	**27,174,153**	**355**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në tabelën nr. 25: Të dhënat në mënyrë analitike për vitin 2025 paraqiten si mëposhtë:

Nr	Subjekti	Vlera e debise 31.12.2024	Shtesa 2025	Pagesat 2025	Detyrimi 31.12.2025
1	Sh.p.k	12,303,685	2,719,996	1,462,620	13,561,061
2	Institucione	864,528	233,820	57,440	1,040,908
3	B. Vogel	10,385,577	3,480,707	1,911,742	11,954,542
4	Nja. Qendër	515,828	227,014	125,200	617,642
Total		**24,069,618**	**6,661,537**	**3,557,002**	**27,174,153**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në lidhje me këtë situatë STT i Bashkisë Tepelenë për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, *"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

<u>Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:</u>

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2023 vlera debitore për taksën e infrastrukturës është 2,097,557 lekë. Gjatë vitit 2024 janë likuiduar detyrime në vlerën 45,578 lekë për debitorët dhe detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024 në vlerën 90,030 lekë është likuiduar. Gjendja debitore në datën 31.12.2024 është në vlerën **2,051,979 lekë.**

Gjatë vitit 2025 është likuiduar detyrimi në vlerën 92,835 lekë për debitorët dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 13,599 lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 është në vlerën **1,972,743 lekë.**

Në tabelën nr. 26: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë						
Viti	**Persona**	**Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë**	**Nr. i personave**	**Vlera e arkëtuar**	**Nr. i personave**	**Vlera e detyrimit**
Deri më datë 31.12.2023	61	2,097,557	2	45,578	59	2,051,979
2024	2	90,030	2	90,030	-	-
Totali/Progresiv	**63**	**2,187,587**	**4**	**135,608**	**59**	**2,051,979**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në tabelën nr. 27: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë						
Viti	**Persona**	**Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë**	**Nr. i personave**	**Vlera e arkëtuar**	**Nr. i personave**	**Vlera e detyrimit**
Deri më datë 31.12.2024	59	2,051,979	2	92,835	57	1,959,144
2025	18	394,192	16	380,593	2	13,599
Totali/Progresiv	**77**	**2,446,171**	**18**	**473,428**	**59**	**1,972,743**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nga Bashkia Tepelenë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK Gjirokastër për bllokimin e pasurisë dhe moskryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1,* dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, *"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.*

<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2024-2025 në territorin e Bashkisë Tepelenë dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 6 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2025, gjithsej rezultojnë 6 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5-vjeçar. Nga këto 3 (tre) subjekte kanë paguar të plotë detyrimin dhe 3 (tre) subjekte kanë paguar detyrim pjesor.

Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, *"Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe* VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar* me VKM nr. 344, datë 19.04.2017*, Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15.*

Në tabelën nr. 28: Të dhënat për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Aktivitet	Fillimi	Përfundimi	Detyrime për tu paguar	Detyrimi i paguar	Diferenca
1	"O." sh.p.k	J.....I	Luzat	Tregti karburanti	03.08.2023	02.08.2028	1,000,000	200,000	800,000
2	"B." sh.p.k	J.....I	Tepelenë	Tregti karburanti	08.05.2020	07.05.2025	1,000,000	1,000,000	0
3	"K." sh.p.k	K.....N	Tepelenë	Tregti karburanti	25.02.2020	24.02.2025	1,000,000	1,000,000	0
4	"K." sh.p.k	J.....P	Tepelenë	Tregti karburanti	05.06.2023	04.06.2028	1,000,000	600,000	400,000
5	"S.G." sh.p.k	K.....V	Tepelenë	Tregti karburanti	08.07.2019	07.07.2024	1,000,000	200,000	800,000
6	"A." sh.p.k	K.....B	Tepelenë	Tregti karburanti	30.06.2020	29.06.2025	1,000,000	1,000,000	0

Totali	6,000,000	4,000,000	2,000,000

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në tabelën nr. 29: Të dhënat për pagesën e detyrimeve për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:

Nr	Subjekti	Nipt	Detyrimi 31.12.2023	Shtesa 2024	Pagesa e kryer 2024	Detyrimi 31.12.2024
1	"O." sh.p.k	J.....I	200,000	-	200,000	-
			1,000,000	-	-	1,000,000
2	"B." sh.p.k	J.....I	100,000	-	-	100,000
			200,000	-	-	200,000
3	"K." sh.p.k	K.....N	200,000	-	200,000	-
4	"K." sh.p.k	J.....P	800,000	-	200,000	600,000
5	"S.G." sh.p.k	K.....V	800,000	-	-	800,000
6	"A. "sh.p.k	K.....B	450,000	-	250,000	200,000
Totali			**3,750,000**		**850,000**	**2,900,000**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në tabelën nr. 30: Të dhënat për pagesën e detyrimeve për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:

Nr	Subjekti	Nipt	Detyrimi 31.12.2024	Shtesa 2025	Pagesa e kryer 2025	Detyrimi 30.09.2025
1	"O." sh.p.k	J.....I	-	-		-
			1,000,000	-	200,000	800,000
2	"B." sh.p.k	J.....I	100,000	-	100,000	-
			200,000	-	200,000	-
3	"K." sh.p.k	K.....N	-	-	-	-
4	"K. " sh.p.k	J.....P	600,000	-	200,000	400,000
5	"S.G." sh.p.k	K.....V	800,000	-	-	800,000
6	"A." sh.p.k	K.....B	200,000	-	200,000	-
Totali			**2,900,000**	**-**	**900,000**	**2,000,000**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. G.G. me detyrë Përgjegjës i Taksave dhe Tarifave Vendore;
2. z. R.H. me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. znj. B.K. me detyrë Përgjegjës i Taksave dhe Tarifave Vendore;

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

2.2.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
2.2.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
2.2.3. Mbi saktësinë e procedurave të prokurimit si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.
2.2.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

2.2.1 Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023-31.12.2025. Pas miratimit të regjistrit në sistem nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi, mbështetur në VKB përkatëse "*Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Tepelenë*".

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i

nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB.

2.2.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2023 janë realizuar 4 procedura prokurimi me fond limit 126,450,103 lekë si mëposhtë:

në mijë lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Fondi total i kursyer pa TVSH
1	Blerje materiale ndërtimi	Open simple	4,166,667	3,355,545	811
2	"Mbikqyrje të objektit Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi "	Open Simple	1,782,171	1,426,127	356
3	Blerje Karburant	Open Local	11,725,000	11,572,053	153
4	"Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi "	Open Local	108,776,265	107,997,000	779

Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2024 janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit 49,502,572 lekë si mëposhtë:

në mijë lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Fondi total i kursyer pa TVSH
1	"Rikonstruksion i lerave në Bashkinë Tepelenë"	Open simple	4,208,793	4,200,000	8
2	"Rikonstruksion i godinës së Njësisë Qendër Tepelenë"	Open Simple	8,750,000	6,900,645	1,849
3	Blerje Karburanti për nevoja të Bashkisë Tepelenë 2024"	Open Local	12,512,500	12,465,313	47
4	"Projekt zbatimi objekti: Ndërtimi i vendparkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikepritje dhe Histori ne Divanin e Pashait)"	Open Local	15,869,299	14,758,448	1,111
5	"Blerje pajisje mobileri për arsimin bazë shkolla 9-vjeçare "Avni Rustemi" në Bashkinë Tepelenë"	Open Simple	3,578,647	2,424,690	1,154
6	"Hartime Plane Mbarështrimi pyje dhe kullota në Bashkinë Tepelenë"	Open Simple	4,583,333	4,425,367	158

Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2025 janë realizuar 4 procedura prokurimi me fond limit 48,039,034 lekë si mëposhtë:

në mijë lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Fondi total i kursyer pa TVSH
1	Blerje materiale ndërtimi	Open simple	4,333,333	3,282,044	1,051
2	"Përmiresim të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara "	Open Local	17,455,701	15,197,648	2,258
3	Blerje Karburant	Open Local	13,500,000	13,335,646	164
4	Blerje mjete motorike fadromë dhe eskavator	Open Local	12,750,000	12,485,000	265

2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

1-Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje materiale ndërtimi"*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale ndërtimi" për Bashkinë Tepelenë		
1.Urdhër Prokurimi: nr. 24, datë 02.02.2023	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** nr. 24/1, datë 02.02.2023	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** nr. 10, datë 15.01.2023
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'Procedurë e hapur e thjeshtuar"	1. J.K.–(Përgjegjës Prokurimesh) 2. M.S - (Anëtar) 3. R.H. - (Anëtar)	1. S.K. – (Kryetar) 2. G.G. (Anëtar) 3. G.S.– (Anëtar)

5.Fondi Limit (pa TVSH) 4,166,561 lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** O.E "D.A.'' PF me ofertë 3,355,545 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit:** - 811,016 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 20.02.2023	**9.Burimi Financimit:** Transferta nga buxheti i Bashkisë Tepelenë 2023, 4,166,561 lekë pa TVSH	**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)**Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
	14. Lidhja e kontratës: Nr. 280/3 prot, datë 10.03.2023.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 4,026,654 lekë

Hartimi i fondit limit

Me VKB nr. 95, datë 30.11.2022 është miratuar Buxheti i vitit 2023 për Bashkinë Tepelenë, miratuar nga prefekti i qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1169/1 prot, datë 09.12.2022. Në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar blerja e materialeve të ndërtimit me vlerë 4,166,561 lekë.

Me urdhrin nr. 24, datë 02.02.2023 të Titullarit të Institucionit është autorizuar kryerja e procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje materiale ndërtimi për nevoja të Bashkisë Tepelenë"* me fond limit 4,166,561 lekë pa TVSH.

Preventivi i materialeve të ndërtimit është përgatitur nga komisioni me përbërje:

1.K.S.
2.G.G.
3.D.A.
4.R.H.
5.G.C.

Komisioni i mësipërm është ngritur me urdhrin nr. 16, datë 24.01.2023 *"Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike",* sipas urdhrit përcaktohet të përllogariti fondin limit dhe specifikimet teknike për prokurimet "Blerje të vogla" sa më sipër kemi të bëjmë me procedurë mbi kriterin ligjor për blerjet e vogla 1,000,000 lekë. Janë marrë 3 oferta nga operatorë ekonomik që tregtojnë këto mallra janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse. Përllogaritja e fondit limit nga 3 ofertat e marrë nga studimi i tregut është në përputhje me VKM nr. 285 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 13.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk administrohen dokumentat standarde të tenderit në kundërshti me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 74 pika c dhe e.

Për mungesat e dokumentacionit në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

Hartimi i kritereve

Me shkresën nr. 280/3, datë 06.02.2023 është mbajtur procesverbali për hartimin, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike nga Njësia e Prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP nuk janë vendosur kritere të argumentuara e të mbështetura.

Vlerësimi i Ofertave

Në datë 20.02.2023 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit "*Blerje materiale ndërtimi*" me fond limit 4,166,167 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE.

Në datë 09.04.2024 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i vlerësimit dhe janë kualifikuar 2 (katër) OE pjesëmarrës si mëposhtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"D.A." PF me NIPT L.....T	3,355,545 lekë	Kualifikuar
2	"E." sh.p.k NIPT K.....P	4,077,000 lekë	Kualifikuar

Njoftimi paraprak i fitues ku është fitues "D.A" PF me NIPT L.....T nuk administrohet në dosje.

Raporti përmbledhës pa nr. prot me datë 20.02.2023 i është titullarit të institucionit për procedurën *"Blerje materiale ndërtimi"* me fond limit 4,166,561 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 483 prot, datë 27.02.2023 nga titullari i autoritetit kontraktor është miratuar raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit.

Me datë 08.03.2023 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit OE "D.A" me nipt L.....T me ofertë ekonomike 3,355,545 lekë pa TVSH.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	"D.A." NIPT L.....T	3,355,545	**1.** Për mjetin kamion me vinç me targa AAFD: Certifikata e kontrollit teknik e vlefshme deri në datën 21.12.2021. Siguracioni i mjetit me afat vlefshmërie me datë 19.12.2022. Certifikata dhe siguracioni i mjetit rezultojnë pa afat vlefshmërie në datën e vlerësimit të ofertave (20.02.2023). Pagesa e taksave vjetore me afat deri në dt 21.12.2020 mungon dokumentacioni i pagesës së taksave vjetore për vitin 2021 dhe 2022. **2.** Referuar pikës 2.3 aftësitë teknike profesionale nga OE nuk është paraqitur dokumentacion për të justifikuar punët e ngjashme.

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, gërma a dhe neni 92 *"Shqyrtimi i ofertave",* pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, z. S.K., z. G.G. dhe znj. G.S.

Lidhja e Kontratës dhe zbatimi i kontratës:

Kontrata e blerjes nr. 280/3 prot, datë 10.03.2023 është lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe OE "D.A." në kontratë nuk është përcaktuar afati i kontratës.

Vlera e lidhur e kontratës është 3,355,545 lekë pa TVSH dhe 4,026,654 lekë me TVSH.

2-Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"*.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 25 prot, datë 02.02.2023	**3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 25, datë 02.02.2023 1. J.K. –(P.përgjegjës për prokurim) 2. M.S. - (Anëtar) 3. R.H. –(Anëtar)	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Nr. 10 prot, datë 15.01.2023 1. S.K. (Kryetar) 2. G.G. (Anëtar) 3. G.S. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapur ", e tipit Marrëveshje Kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 11,725,000 lekë	**6. Oferta fituese**: **Loti I:** Gazoil 10 ppm OE "O." sh.p.k me marzh fitimi 24 lekë/litër marrëveshje kuadër.	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.03.2023	**9.Burimi Financimit**: Të ardhurat e Bashkisë Tepelenë në vlerën 11,725,000 lekë	**10. Operatorët Ekonomike:** **Loti I:** Gazoil 10 ppm a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE - OE "O." sh.p.k
11.Ankimime në AK Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP:** Nuk ka

14. Lidhja e kontratës:	15. Vlera e kontratës (me TVSH):	
Loti I: Gazoil 10 ppm Datë 22.03.2023	Gazoil 10 ppm me vlerë kontratë 11,725,000 lekë, 171.04 lekë/litër.	

Hartimi i fondit limit

Me VKB nr. 95, datë 30.11.2022 është miratuar buxheti i vitit 2023 për Bashkinë Tepelenë, miratuar nga prefekti i qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1169/1 prot, datë 09.12.2022. Në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar blerja karburantit me vlerë 11,725,000 lekë.
Preventivi është përgatitur nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 7, datë 15.01.2024 me përbërje:
1.K.S.
2.G.G.
3.D.A.
4.R.H.
5.G.C.
Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e karburant e kërkuar. Mjetet e Bashkisë Tepelenë nuk kanë të miratuar normative sasinë e konsumit të karburanteve.
Nuk administrohen kërkesat nga Drejtoritë e Bashkisë për nevojat për karburante bazuar në disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantin.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

Hartimi i kritereve

Me shkresën me datë 06.02.2023 është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve për kualifikim.
Me formë elektronike (email) në datën 10.02.2023, Agjensia e Prokurimit Publik ka vlerësuar të rishikohen kriteret.
Me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 29, datë 13.02.2023 është pezulluar procedura e blerjes së karburantit për nevoja të Bashkisë Tepelenë deri në shqyrtimin e rekomandimeve të APP.
Shtojca nr. 1 e datës 13.02.2023 "Mbi ndryshimin e dokumentave standarde të tenderit" janë pasqyruar ndryshimet e kritereve të veçanta si mëposhtë:

Ishte	Bëhet
1) OE duhet të paraqesë raport fletë analizë për produktin Naftë Euro-Disel DI 10PPM S.SH.EN: 590-2013/A1;2017, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (nqs është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standardeve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuara jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave.	1) Autoriteti Kontraktor pranon edhe mundësinë e disponimit të certifikatës ekuivalente të njohur nga standardet shqiptare SSH EN 590:2022.

Me urdhër nr. 28/1, datë 13.02.2023 ka përfunduar pezullimi i procedurës së prokurimit blerje karburanti pasi janë rishikuar rekomandimet e APP.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP nuk janë plotësuar DST në përputhje me llojin e kontratës.
1) Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* të ndryshuar, neni 61 procedura e mësipërme kontrata duhet të lidhet e marrëveshje kuadër për shkak sepse të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasitë, specifikimet) dhe është një mall i përsëritshëm/i vazhdueshëm.

2) Referuar plotësimit të DST për procedurën e prokurimit blerje karburanti për vitin 2023 për nevojat e Bashkisë Tepelenë, pika 4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, pika b oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X.
Njësia e Prokurimit ka plotësuar DST në kundërshtim me pikën 2.1, të nenit 45, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, përcaktohet se: "Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:
a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
b) elementet fiskale;
c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

<u>Vlerësimi i Ofertave</u>
Në datë 10.03.2023 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Blerje karburant për vitin 2023" me fond limit 11,725,000 lekë*
Mëposhtë paraqiten ofertat e operatorëve për procedurën blerje karburanti.
1-OE "O." sh.p.k me vlerë oferte 11,572,053 lekë.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 10.03.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "O." sh.p.k	11,725,000	Kualifikuar

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor në datën 19.04.2024 ka mbajtur formularin e njoftimit të fituesit (paraprak).
Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës me datë 16.03.2023 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, 1 OE kanë ofertuar "O." sh.p.k me nipt J.....I dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese me ofertë ekonomike me 11,572,053 lekë.
Me vendimin nr. 11/1, datë 16.03.2023 është miratuar raporti përmbledhës dhe shpallja fitues e prokurimit me objekt *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë".*

<u>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:</u>

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	OE: "O." sh.p.k	11,725,000	Dokumentacioni i paraqitur nga OE në përputhje me DST

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", <u>neni 80</u>, dhe, <u>neni 92 pika 3</u>,

Lidhja e Kontratës (Gazoil 10 ppm):
Kontrata e furnizimit midis Autoritetit Kontraktor dhe OE është lidhur në datën 22.03.2023 me afat 12 muaj. Vlera e kontratës do të jetë 11,572,053 lekë.

3-Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 04 prot., datë 15.01.2024 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "E Hapur ", e tipit Marrëveshje Kuadër	**3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 04, datë 15.01.2024 1. J.K. –(P.përgjegjës për prokurim) 2. M.S. - (Anëtar) 3. R.H. –(Anëtar)	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Nr. 10 prot, datë 15.01.2024 1. S.K. (Kryetar) 2. G.G. (Anëtar) 3. G.S. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 12,512,500 lekë	**6. Oferta fituese**: OE "O." sh.p.k me ofertë 12,465,313 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.02.2024	**9.Burimi Financimit**: Të ardhurat e Bashkisë Tepelenë në vlerën 12,512,500 lekë.	**10. Operatorët Ekonomike:** a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE - OE "O." sh.p.k
11.Ankimime në AK Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Kontratë furnizimi me datë 20.02.2024 me afat 12 muaj	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** Vlera e lidhur e kontratës 12,465.313 lekë pa TVSH ose 159.35 lek/litër pa TVSH.	

Hartimi i fondit limit

Me VKB nr. 87, datë 30.11.2023 është miratuar Buxheti i vitit 2024 për Bashkinë Tepelenë. Në buxhetin e vitit 2024 është parashikuar blerja karburantit me vlerë 12,512,500 lekë.
Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e karburant e kërkuar. Mjetet e Bashkisë Tepelenë nuk kanë të miratuar normative sasinë e konsumit të karburanteve.
Nuk administrohen kërkesat nga Drejtoritë e Bashkisë për nevojat për karburante bazuar në disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantin.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: *"Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".*

Hartimi i kritereve

Me shkresën me datë 15.02.2024 është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve për kualifikim.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP nuk janë plotësuar DST në përputhje me llojin e kontratës.
1) Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,* neni 61 procedura e mësipërme kontrata duhet të lidhet e marrëveshje kuadër për shkak sepse të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasitë, specifikimet) dhe është një mall i përsëritshëm/i vazhdueshëm.
2) Referuar plotësimit të DST për procedurën e prokurimit blerje karburanti për vitin 2024 për nevojat e Bashkisë Tepelenë, pika 4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, pika b oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X.
Njësia e Prokurimit ka plotësuar DST në kundërshtim me pikën 2.1, të nenit 45, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, përcaktohet se: "Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
b) elementet fiskale;
c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K, z. M.S. dhe z. R.H.

Vlerësimi i Ofertave

Në datë 08.02.2024 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Blerje karburant për vitin 2024" me fond limit 12,512,500 lekë*
Mëposhtë paraqiten ofertat e operatorëve për procedurën blerje karburanti.
1-OE "O." sh.p.k me vlerë oferte 12,465,313 lekë.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 08.02.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "O." sh.p.k	12,465,313	Kualifikuar

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor në datën 14.02.2024 ka mbajtur formularin e njoftimit të fituesit (paraprak).
Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës me datë 16.02.2024 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, 1 OE kanë ofertuar "O." sh.p.k me nipt J.....I dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese me ofertë ekonomike me 12,465,313 lekë.
Me vendimin nr. 05, datë 16.02.2023 është miratuar raporti përmbledhës dhe shpallja fitues e prokurimit me objekt *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë".*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	OE: "O." sh.p.k	12,465,313	Dokumentacioni i paraqitur nga OE në përputhje me DST

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80,, neni 92 pika 3.

Lidhja e Kontratës (Gazoil 10 ppm):
Kontrata e furnizimit midis Autoritetit Kontraktor dhe OE është lidhur në datën 20.02.2024 me afat 12 muaj. Vlera e kontratës do të jetë 12,465,313 lekë.

4-Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksioni i godinës së Njësisë Qendër, Bashkia Tepelenë".*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i godinës së Njësisë Qendër, Bashkia Tepelenë".		
1.Urdhër Prokurimi: Nr. 15, datë 25.01.2024	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** nr. 15, datë 25.01.2024 1.J.K. –(P.përgjegjës për prokurim) 2.M.S. - (Anëtar) 3.R.H. (Anëtar)	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** nr. 10, datë 15.01.2024 1. S.K. – (Kryetar) 2. G.S. - (Anëtar) 3. G.G.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 8,750,000 - lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** O.E "A.C." sh.p.k me ofertë 6,900,645 lekë pa TVSH lekë	**7.Diferenca me fondin limit:** - 1,849,355 lekë pa TVSH

8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 27.02.2024	**9.Burimi Financimit:** Bashkia Tepelenë me VKB nr. 88, datë 30.11.2023 për miratimin e buxhetit për vitin 2024 në vlerën 8,750,000 lekë.	**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender 6 BOE/OE **b)**Skualifikuar 0 BOE/OE, **c)** Kualifikuar 6 BOE/OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
14. Lidhja e Kontratës: Kontratë me datë lidhje kontrate 25.04.2024 me afat 4 muaj.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 8,280,774 lekë me TVSH	

Hartimi i projektit dhe fondit limit

Me VKB nr. 88, datë 30.11.2023 *"Për miratimin e buxhetit për vitin 2024"* konfirmuar nga prefekti i qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 994/1, datë 14.12.2023, është parashikuar fondi në vlerën 8,750,000 lekë për rikonstruksion e njësisë qendër.

Projekt-zbatimi i procedurës *"Rikonstruksion i objektit, njësia administrative Qendër"* është hartuar nga BOE "E.C.G." sh.p.k dhe "S." sh.p.k.

Preventivi i punimeve i hartuar nga ing. E.Ç. i "E.C.G." sh.p.k dhe "S." sh.p.k është në vlerën 9,000,000 lekë.

Sipas urdhrit të prokurimit nr. 15, datë 25.01.2024 fondi limit është përllogaritur në vlerën 8,750,000 lekë.

Referuar preventivit të punimeve të hartuar nga ing. E.Ç. u audituan zërat e preventivit dhe vlerat janë në përputhje me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve".*

Hartimi i kritereve

Në datën 19.08.2025 nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike për kualifikim.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht.

1) Pika 2.3.3: Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë të punësuar minimalisht si më poshtë vijon: - Si drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë të paktën 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 arkitekt.

Referuar kërkesës së mësipërme arkitekti ushtron funksionin e tij në fazën e projektimit, përmes hartimit të dokumentacionit projektues. Faza e zbatimit të punimeve realizohet nga inxhinieri i ndërtimit, elektrik dhe hidroteknik. Për rrjedhojë, përfshirja e arkitektit në licencë për fazën e zbatimit nuk paraqitet e nevojshme, pasi roli i tij përmbushet në fazën e projektimit. Referuar kërkesës në pikën nr. 2.3.3 sipas preventivit punimet të cilat parashikohen të kryen dhe kërkesa për 1 (një) Arkitekt nuk është e argumentuar dhe në përputhje me ligjin 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, neni 77, pika 1.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

Vlerësimi i Ofertave

Në datë 27.02.2024 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Rikonstruksioni i godinës së Njësisë Qendër"* me fond limit 8,750,000 lekë në të cilën ka ofertuar 6 operator ekonomik.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 22.09.2025, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "A.C." sh.p.k me NIPT M.....L	6,900,645 lekë	Kualifikuar
2	OE "S." sh.p.k me NIPT J.....K	7,083,536 lekë	Kualifikuar
3	OE "R.C." sh.p.k me NIPT	7,147,690 lekë	Kualifikuar
4	OE "I." sh.p.k me NIPT J.....W	7,286,690 lekë	Kualifikuar
5	OE "I.C." sh.p.k me NIPT L.....D dhe "A.C." sh.p.k me NIPT K.....C	8,455,818 lekë	Kualifikuar
6	OE "A.C." sh.p.k me NIPT L.....A dhe "N. "sh.p.k me NIPT K.....I	8,349,583 lekë	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës me datë 18.03.2024 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës dhe formularit paraprak të njoftimit të fituesit, në këtë procedurë ka marrë pjesë 6 operatorë të cilët janë kualifikuar dhe është shpallur fitues OE "A.C." sh.p.k me nipt M.....L.

Titullari i AK më datë 25.04.2024 ka lidhur kontratën me OE "A.C." sh.p.k për vlerën 6,900,645 lekë pa TVSH dhe vlera 8,280,774 lekë me TVSH, dhe me afat realizimi punimesh 4 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	"A.C." sh.p.k	6,900,645	**1.** Për mjetin me targa AABF është paraqitur certifikatë për transportin e mallrave për llogari të vet ky mjet është marrë me qira dhe nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për të tretë. **2.** Për mjetin me targa AAVU është paraqitur certifikatë për transportin e mallrave për llogari të vet ky mjet është marrë me qira dhe nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për të tretë.

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, gërma a dhe neni 92 *"Shqyrtimi i ofertave",* pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, z. S.K, z. G.G dhe znj. G.S

5-Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti		
1. Urdhër Prokurimi nr. 31 prot, datë 05.02.2025 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "E Hapur"	**3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 31, datë 05.02.2025 1. J.K. –(P.përgjegjës për prokurim) 2. M.S. - (Anëtar) 3. R.H. –(Anëtar)	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Nr. 10 prot, datë 28.01.2025 1. S.K. (Kryetar) 2. G.G. (Anëtar) 3. G.S. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 13,500,000 lekë	**6. Oferta fituese**: OE "O." sh.p.k me ofertë 13,335,646 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 164,354 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 11.03.2025	**9.Burimi Financimit**: Të ardhurat e Bashkisë Tepelenë në shumën 13,500,000 lekë	**10. Operatorët Ekonomike:** a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE - OE "O." sh.p.k - OE "K.E."
11.Ankimime në AK Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP:** Nuk ka

14. Lidhja e kontratës: Kontratë furnizimi me datë 02.04.2025 me afat 12 muaj	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** Vlera e lidhur e kontratës 16,200,000 lekë pa TVSH	

Hartimi i fondit limit

Me VKB nr. 71, datë 27.11.2024 është miratuar Buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Tepelenë. Në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar blerja karburantit me vlerë 13,500,000 lekë.
Nga auditimi konstatohet se është përcaktuar sasia mujore e karburantit për mjetet në pronësi të Bashkisë Tepelenë. Sasia vjetore e përllogaritur është 93,913 litra.
Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e karburant e kërkuar. Mjetet e Bashkisë Tepelenë nuk kanë të miratuar normative sasinë e konsumit të karburanteve.
Nuk administrohen kërkesat nga Drejtoritë e Bashkisë për nevojat për karburante bazuar në disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantin.

Në dosjen e auditimit nga komisioni me përbërje si mëposhtë:
- K.S.;
- G.G.;
- D.A.;
- R.H.;
- G.C.;

Kanë përcaktuar sasinë në muaj të çdo mjeti në pronësi të Bashkisë Tepelenë. Sasia e konsumit të mjeteve nuk mund të përcaktohet me normativa por duhet të mbahen procesverbale nga komisioni për mjetet të cilat janë të përdorura dhe nuk mund t'i referohen dot normativës sipas librit të mjetit për të kuptuar sa harxhojnë për 100 km ose për mjetet teknologjike sasia e konsumit në orë. Në bazë të procesverbalit nxirret normativa e konsumit të mjeteve dhe miratohet në Këshillin Bashkiak. Fondi limit përllogaritet duke ju referuar sasisë së konsumit të viteve të mëparshme.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: *"Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".*

Hartimi i kritereve

Me shkresën me datë 12.02.2025 është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve për kualifikim.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP nuk janë plotësuar DST në përputhje me llojin e kontratës.
1) Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,* neni 61 procedura e mësipërme kontrata duhet të lidhet e marrëveshje kuadër për shkak sepse të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasitë, specifikimet) dhe është një mall i përsëritshëm/i vazhdueshëm.
2) Referuar plotësimit të DST për procedurën e prokurimit blerje karburanti për vitin 2024 për nevojat e Bashkisë Tepelenë, pika 4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, pika b oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X.
Njësia e Prokurimit ka plotësuar DST në kundërshtim me pikën 2.1, të nenit 45, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, përcaktohet se: "Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:
a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;
c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

Vlerësimi i Ofertave
Në datë 11.03.2025 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Blerje karburant për vitin 2024" me fond limit 13,500,000 lekë*
Mëposhtë paraqiten ofertat e operatorëve për procedurën blerje karburanti.
1-OE "O." sh.p.k me vlerë oferte 13,335,646 lekë.
2-OE "K.E." me vlerë oferte 13,474,637 lekë.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 08.02.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "O." sh.p.k	13,335,646	Kualifikuar
2	OE "K.E."	13,474,637	Kualifikuar

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor në datën 26.03.2025 ka mbajtur formularin e njoftimit në përfundim të afateve të ankimimit.
Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me datë 27.03.2025 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, 2 OE kanë ofertuar "O." sh.p.k me nipt J.....I dhe "K.E." me nipt J.....P.
Këto 2 oferta janë kualifikuar dhe është shpallur fituese oferta e OE "O." sh.p.k me vlerë 13,335,646 lekë.
Me vendimin nr. 10, datë 27.03.2025 është miratuar raporti përmbledhës dhe shpallja fitues e prokurimit me objekt *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë".*

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	OE: "O." sh.p.k	13,335,646	1. ISO 45001:2018 (data e skadimit 16.12.2024) 2. ISO 14001:2015 (data e skadimit 16.12.2024) 3. ISO 9001:2015 (data e skadimit 16.12.2024)

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, gërma a dhe neni 92 *"Shqyrtimi i ofertave",* pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, z. S.K, z. G.G. dhe znj. G.S.

Lidhja e Kontratës (Gazoil 10 ppm):
Kontrata e furnizimit midis Autoritetit Kontraktor dhe OE është lidhur në datën 02.04.2025 me afat 12 muaj.

6-Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese"*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese"			
1.Urdhër Prokurimi: nr. 111, datë 27.08.2025	**2.Hartuesit e specifikimeve teknike.**	**2/1. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:**	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** nr. 10, datë 28.01.2025

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'Procedurë e hapur"	nr. 111/1, datë 02.09.2025 1.P.H. ing.mekanik (kryetar) 2.T.M. ing. Mekanik (anëtar) 3.G.C. teknik mekanik (anëtar) 4.D.A. ekonomist (anëtar)	nr. 111, datë 27.08.2025 1.B.X.–(Përgjegjës Prokurimesh) 2. A.A. - (Anëtar) 3. R.H. - (Anëtar)	1. S.K – (Kryetar) 2. G.G (Anëtar) 3. G.S.– (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa TVSH) 12,750,000 lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** O.E 'A.'' sh.p.k me ofertë 12,485,000 lekë pa TVSH		**7.Diferenca me fondin limit:** - 265,000 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 06.10.2025	**9.Burimi Financimit:** Fond i kushtëzuar për mbrojtjen civile për Bashkinë Tepelenë në vlerën 15,300,000 lekë me TVSH. Financimi për vitin 2025 në vlerën 8,568,000 lekë.		**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)**Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka		**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
	14. Lidhja e kontratës: Nr. 1506/8 prot, datë 25.11.2025		**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 14,982,000 lekë

Hartimi i fondit limit dhe i specifikimeve teknike

Me vendimin nr. 127, datë 28.02.2025 *"Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore*", Bashkia Tepelenë është shpallur fituese për 2 financime për blerje mjetesh në vlerën 7,300,000 lekë dhe në vlerën 8,000,000 lekë.

Për procedurën e mësipërme nuk është hartuar një përshkrim për mallrat që do të prokurohen dhe nevojën e këtyre mallrave nga institucioni në kundërshtim me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 2, pika a.*

Nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk administrohet dokumentat standarde të tenderit në kundërshti me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 2 dhe neni 74 pika c dhe e.

Procesverbali pa datë dhe pa nr prot, është mbajtur procesverbali për hartimin, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 111/1, datë 02.09.2025.

Referuar DST-ve kohëzgjatja e kontratës ose zbatimi i kontratës është përcaktuar për një periudhë 60 ditë. Kjo periudhë kohore e përcaktuar në DST- të nuk është e argumentuar pse kërkohet një periudhë kaq e gjatë për sjelljen e mjeteve nga OE i cili do të shpallet fitues në këtë procedurë prokurimi objekti është mallra nuk është punime ndërtimi për të vendosur një afat kaq të gjatë për dorëzimin e mallrave.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. B.X., Z. A.A. dhe Z. R.H.

Hartimi i kritereve

Me shkresën me datë, datë 19.09.2025 është mbajtur procesverbali për hartimin, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike nga Njësia e Prokurimit.

Vlerësimi i Ofertave

Në datë 22.10.2025 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese"* me fond limit 12,750,000 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"S.T.A." sh.p.k me NIPT L.....R	-	S'kualifikuar - Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2	"A." sh.p.k NIPT L.....F	12,485,000	Kualifikuar

Në datën 13.11.2025 sipas shtojcës 12 është hartuar formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimimit, OE fitues është "A." sh.p.k me vlerë ofertë 12,485,000 lekë. Raporti përmbledhës me datë 18.11.2025 për procedurën *"Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese"* me fond limit 12,750,000 lekë pa TVSH. OE i shpallur fitues është "A." sh.p.k me vlerë kontrate 12,485,000 lekë.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	"A." sh.p.k NIPT L.....F	12,485,000	Dokumentacioni i paraqitur nga OE në përputhje me DST

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, neni 92 pika 3.

7-Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje materiale ndërtimi"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale ndërtimi" për Bashkinë Tepelenë		
1.Urdhër Prokurimi: nr. 32, datë 05.02.2025	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** nr. 32, datë 05.02.2025 1. J.K.–(Përgjegjës Prokurimesh) 2. M.S. - (Anëtar) 3. R.H. - (Anëtar)	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** nr. 10, datë 28.01.2025 1. S.K. – (Kryetar) 2. G.G. (Anëtar) 3. G.S.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'Procedurë e hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 4,333,333 lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** O.E 'A.C.'' sh.p.k me ofertë 3,282,044 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit:** - 1,051,289 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 24.02.2025	**9.Burimi Financimit:** Transferta nga buxheti i Bashkisë Tepelenë 2025. 4,333,3333 lekë pa TVSH	**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender 8 OE **b)**Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 8 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
	14. Lidhja e kontratës: Nr. 241/8 prot, datë 14.04.2025.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 3,938,452 lekë

Hartimi i fondit limit

Me VKB nr. 72, datë 27.11.2024 është miratuar Buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Tepelenë, miratuar nga prefekti i qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 975/1 prot, datë 13.12.2024. Në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar blerja e materialeve të ndërtimit me vlerë 4,333,333 lekë. Për procedurën e mësipërme nuk është hartuar një përshkrim për mallrat që do të prokurohen dhe nevojën e këtyre mallrave nga institucioni në kundërshtim me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 2, pika a.* Gjithashtu lloji i procedurës së prokurimit të përzgjedhur është *"e hapur e thjeshtuar"* referuar preventivit të materialeve kemi të bëjmë më materiale të cilat jo të gjitha mund të magazinohen si beton i gatshëm dhe prajmer. Sa më sipër duhet të zgjidhej lloji i marrëveshjes kuadër referuar nenit 61 të VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Preventivi i materialeve të ndërtimit është përgatitur nga komisioni me përbërje:

1.K.S.
2.G.G.
3.D.A.
4.R.H.
5.G.C.

Përllogaritjen e fondit limit nuk dokumentohet dhe është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 13, pika 4.*

Nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk administrohet urdhri i prokurimit dhe dokumentat standarde të tenderit në kundërshti me VKM nr. 285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 2 dhe neni 74 pika c dhe e.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K, z. M.S dhe z. R.H.

Hartimi i kritereve

Me shkresën me datë, datë 06.02.2025 është mbajtur procesverbali për hartimin, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike nga Njësia e Prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP nuk janë vendosur kritere të argumentuara e të mbështetura.

Vlerësimi i Ofertave

Në datë 28.02.2025 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit "*Blerje materiale ndërtimi*" me fond limit 4,333,333 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 OE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"L." sh.p.k me NIPT K.....N	3,102,060 lekë	Kualifikuar
2	"A.C." sh.p.k NIPT L.....A	3,282,044 lekë	Kualifikuar
3	"T.C." sh.p.k NIPT M.....T	3,315,560 lekë	Kualifikuar
4	"O.C." sh.p.k NIPT M.....D	3,843,400 lekë	Kualifikuar
5	"G." sh.p.k NIPT L.....U	3,974,400 lekë	Kualifikuar
6	"Z." sh.p.k NIPT J.....A	3,989,700 lekë	Kualifikuar
7	"A." sh.p.k NIPT L.....N	4,292,060 lekë	Kualifikuar
8	"A." sh.p.k NIPT L.....F	4,298,480 lekë	Kualifikuar

Në datën 13.03.2025 sipas shtojcës 12 është hartuar formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimimit.

Me urdhrin nr. 54, datë 18.03.2025 *"Për rivlerësim prokurimi"* të procedurës blerje materiale ndërtimi duke kaluar tek operatori i radhës sepse operatori i shpallur fitues nuk ka dorëzuar sigurimin e kontratës dhe është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës.

Me shkresën nr. 542 prot, datë 18.03.2025 Bashkia Tepelenë i ka kërkuar shoqërisë Albsig konfiskimin e sigurimit të ofertës sepse është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës.

KVO-ja në datën 18.03.2025 ka mbajtur procesverbalin për rivlerësimin e ofertave të dorëzuara. Operatori i radhës është OE "A.C." sh.p.k me nipt L.....A.

Raporti përmbledhës me nr. 540/2 prot me datë 27.03.2025 për procedurën *"Blerje materiale ndërtimi"* me fond limit 4,333,333 lekë pa TVSH. OE i shpallur fitues është "A.C." sh.p.k me vlerë kontrate 3,282,044 lekë. Në datën 03.04.2025 sipas shtojcës 12 është hartuar formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimimit, OE fitues është "A.C." sh.p.k me vlerë ofertë 3,282,044 lekë.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	"A.C." sh.p.k NIPT L.....A	3,282,044	Dokumentacioni i paraqitur nga OE në përputhje me DST

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, neni 92 pika 3.

Lidhja e Kontratës dhe zbatimi i kontratës:

Kontrata e blerjes nr. 241/8 prot, datë 14.04.2025 është lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe OE "A.C." sh.p.k në kontratë nuk është përcaktuar afati i kontratës. Vlera e lidhur e kontratës është 3,282,044 lekë pa TVSH.

Referuar DST-ve në njoftimin e kontratës është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës për zbatimin e saj me afat 1 muaj. Kontrata e lidhur me datë 14.04.2025 nuk përcakton afat kontrate por vetëm në nenin 4 "dorëzimi" është përcaktuar në pikën (a) *kushtet e dorëzimit, datat dhe vendet e dorëzimit të mallrave dhe pjesëve të këmbimit do të përmbushen në përputhje me grafikun e dorëzimeve të parashikuara në këtë kontratë.*

Kontrata e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik është lidhur në kundërshtim me kushtet e DST.

Nga zbatimi si mëposhtë kontrata ka filluar zbatimin në datën 18.04.2025-05.12.2025.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 9, datë 20.04.2026 dorëzuar me protokoll në Bashkinë Tepelenë).

8-Procedura e prokurimit me objekt: *"Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara".*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Tepelenë".		
1.Urdhër Prokurimi: Nr. 99, datë 11.08.2025	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** nr. 99, datë 11.08.2025 1.B.X. –(P.përgjegjës për prokurim) 2.A.A. - (Anëtar) 3.R.H. (Anëtar)	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** nr. 10, datë 28.01.2025 1. S.K. – (Kryetar) 2. G.S. (Anëtar) 3. G.G.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'E hapur"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 17,455,701 - lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** O.E "A." sh.p.k me ofertë 15,197,648 lekë pa TVSH lekë	**7.Diferenca me fondin limit:** - 2,258,053 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 01.09.2025	**9.Burimi Financimit:** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: - Financim i vitit 2025 në vlerë 8,378,736 lekë pa TVSH. - Financim i vitit 2026 në vlerë 8,378,736 lekë pa TVSH. Bashkia Tepelenë: - Financim i vitit 2025 në vlerën 0 lekë. - Financim i vitit 2026 në vlerën 4,189,368 lekë me TVSH.	**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)**Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
14. Lidhja e Kontratës: Kontratë punë civile me datë lidhje kontrate 02.10.2025 me afat 4 muaj.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 18,237,177 lekë me TVSH	

<u>Hartimi i projektit dhe fondit limit</u>

Me urdhër nr. 196, datë 31.12.2024 *"Për verifikimin e shkallës së dëmtimit, gjendjes së banesave të personave të përfshirë në listën e përfituesve për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara".*

Me VKB nr. 6, datë 30.01.2025 *"Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituesë si dhe vlerën e bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit përmirësimi i banesave ekzistuese për vitin 2025".*

Me shkresën nr. 940 prot, datë 27.05.2025 është dërguar dosja e aplikimit për 21 familjeve përfituese Drejtorisë së Strehimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë".

Me shkresën nr. 8393 prot, datë 24.06.2025 nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bashkia Tepelenë është shpallur fituese me vlerë projekti 20,946,841 lekë me

TVSH nga të cilat Bashkia Tepelenë përfiton nga buxheti i shtetit vlerën prej 16,757,473 lekë dhe bashkëfinancon vlerën 4,189,368 lekë në masën 20%.
Me shkresën nr. 10171/1 prot, datë 09.07.2025 janë transferuar fondet për shpenzimet kapitale nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit.
Preventivet për projektin përmirësim i banesave ekzistuese Bashkia Tepelenë janë hartuar nga ing. A.M.

Hartimi i kritereve
Në datën 19.08.2025 nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike për kualifikim.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht
1) Pika 2.3.3: Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma apo licencë profesionale nëse është rasti, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar me lart, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:
- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier mjedisi 1 (një)

Referuar kërkesës në pikën nr. 2.3.3 sipas preventivit punimet të cilat parashikohen të kryen kanë ndikim minimal në mjedis dhe kërkesa për 1 (një) mjedisi nuk është e argumentuar dhe në përputhje me ligjin 162/2020 *"Për prokurimin publik",* neni 77, pika 1.
2) Pika 2.3.9: Operatori ekonomik Ofertues duhet të disponojnë të paktën.
- 1 (një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet të jetë detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Referuar kërkesës së DST-ve në pikën nr. 2.3.3 për kontratë e punës publike *"Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Tepelenë"* nuk ka elementë të kësaj kontratë që të bëjnë të nevojshëm kërkesën për mjek. AK nuk mund të kërkojë që OE ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri privatë. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës), dhe jo çështje e verifikimit nga autoriteti kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës. Kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me pikën 2, neni 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave
Në datë 22.09.2025 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"* me fond limit 16,995,381 lekë në të cilën ka ofertuar 1 operator ekonomik.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 22.09.2025, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "A." sh.p.k me NIPT J.....O	15,197,648	Kualifikuar:

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me datë 26.09.2025 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe

formularit paraprak të njoftimit të fituesit, në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 operatorë i cili është kualifikuar dhe është shpallur fitues.
Me datë 30.09.2025 është hartuar njoftimi i fituesit në përfundim të afateve të ankimit. Fitues është shpallur oferta e OE "A." sh.p.k me ofertë ekonomike 15,197,648 lekë pa TVSH.
Titullari i AK më datë 21.10.2025 ka lidhur kontratën me OE "A." sh.p.k për vlerën 16,245,922 lekë pa TVSH dhe vlera 19,495,106 lekë me TVSH, dhe me afat realizimi punimesh 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	"A." sh.p.k	16,245,922	Dokumentacioni i paraqitur në përputhje me kërkesat e DST-së

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, neni 92 pika 3.

9-Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i vend-parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait)".*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i vend-parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait)".		
1.Urdhër Prokurimi: Nr. 168, datë 08.11.2024	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Nr. 168/1, datë 08.11.2024 1. J.K. – (Person Përgjegjës/Jurist) 2. M.S. – (Inxhinier Gjeodet) 3. R.H. – (Ekonomist)	**3.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Nr. 10, datë 15.01.2025 1. S.K. – (Kryetar) 2. G.S. – (Anëtar) 3. G.G. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: 'E hapur"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 15,869,299 lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** OE "N.S." sh.p.k me ofertë 14,758,448 lekë pa TVSH, me lidhje kontrate datë 09.06.2025, me afat realizim 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.	**7.Diferenca me fondin limit:** - 1,110,851 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: - REF-28894-11-11-2024 - Data e prokurimit: 09.01.2025 (pas disa pezullimeve)	**9.Burimi Financimit:** Buxheti i shtetit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH, në kuadër të Skemës "Mekanizmi i Nxitjes së Kapaciteteve Bashkiake për Zbatimin e Projekteve") / Buxheti i NJVV.	**10.Operatorët Ekonomikë:** a) Pjesëmarrës: 2 OE b) S'kualifikuar: 1 OE OE "P." sh.p.k – mungesë dokumentacioni c) Kualifikuar: 1 OE OE "N.S." sh.p.k
11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
14. Lidhja e Kontratës: Kontratë pune civile (çelësa në dorë) me datë lidhje kontrate 09.06.2025 me afat 12 muaj.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 17,416,968 lekë me TVSH	

Hartimi i projektit dhe fondit limit

Termat e referencës së procedurës së prokurimit: *"Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait"* janë hartuar nga Bashkia Tepelenë në kuadër të Skemës "Mekanizmi i Nxitjes së Kapaciteteve Bashkiake për Zbatimin e Projekteve", financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).
Pas kësaj thirrje Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 1851 prot, datë 09.10.2024, i dërgoi FSHZH-së dokumentacionin e nevojshëm për projektin, duke përfshirë detyrën e projektimit. Bazuar në dokumentacionin e detyrës së projektimit konstatohet se nga ana e AK Bashkia Tepelenë nuk është sqaruar në mënyrë shteruese se çfarë duhet të përmbajë ky projekt. Në këtë dokumentacion nuk sqarohet se sa do të jetë sipërfaqja e parkimit, gjatësia dhe gjerësia e rrugës që të çon në parking, nëse do të kryhen punime të shtresave rrugore për ndërtimin e parkimit, si: gërmim, mbushje me çakëll, stabilizant, binder, asfalt. Nëse do të ndërhyhet me mure mbajtës/rrethues nëse do të këtë ndriçim apo të dhëna të tjera të nevojshme për hartimin e

projektit. Kjo detyrë projektimi konstatohet se është e firmosur nga grupi i punës, por rezulton vetëm me një firmë dhe nuk figuron nga kush është firmosur (Emër Mbiemër). Në detyrën e projektimit buxheti i parashikuar është në vlerën 20,765,000 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Kosto	Njësia matëse	Sasia	Kosto/njësi	E gjithë periudha				
				Kosto totale neto	TVSH	Totali	Financimi SNKB	Bashkëfinancimi Aplikantit
1	2	3	4	5	6	7 (5+6)	9	10
1. Punë								
Ndërtimi i vend parkimit, pjesëve funksionale dhe Info Point-it	M2	2,963	3,937	11,665,331	2,333,066	14,000,000	14,000,000	
Punë Total				**11,666,667**	**2,333,333**	**14,000,000**	**14,000,000**	
2. Pajisje/Mallra								
Furnizim-Vendosje e sistemeve smart dhe sinjali stikës	L.S	1	2,500,000	2,500,000	500,000	3,000,000	3,000,000	
Pajisje Total				**2,500,000**	**500,000**	**3,000,000**	**3,000,000**	
3. Shërbime								
Përgatitja e funksionalitetit, plani i biznesit, plani i promovimit, realizimi i 1 eventi, Publikimi në Faqen zyrtare të Bashkisë dhe Rrjetet sociale, përgatitja e materialeve dhe strategjive për promovimin turistik	L.S	1	500,000	500,000	100,000	600,000	600,000	
Projekti dhe Relacioni Teknik	L.S	1	641,036	641,036	128,207	769,243	769,243	
Përgatitja e tre videove për interpretimin audio vizual, Krijimi dhe prodhimi i videove për kalanë Ali Pashën dhe trashëgiminë kulturore dhe kulinare	L.S	1	657,379	561,596	112,319	673,915	673,915	
Super vizion / Mbikëqyrje punimesh	L.S	1	320,518	320,518	64,104	384,621	384,621	
Kolaudimi punimeve	L.S	1	31,018	31,018	6,204	37,221	37,221	
Mirëmbajtje (1 vit, staf 2 persona)	Ditë pune	730	1,781	1,300,130	-	1,300,000	-	**1,300,000**
Shërbime Total				**3,354,167**	**410,833**	**3,765,000**	**2,465,000**	**1,300,000**
Total				**17,520,833**	**3,244,167**	**20,765,000**	**19,465,000**	**1,300,000**

Me shkresën nr. 3599/1 prot, datë 11.10.2024 FSHZH-it i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Tepelenë z. T.P., duke e njoftuar për miratimin e projektit në fjalë; si dhe i dërgon të nënshkruara a) Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe b) Marrëveshjen e Investimit. Sipas urdhrit të prokurimit Nr. 168, datë 08.11.2024, Titullari i AK Bashkia Tepelenë urdhëron dhe ngarkon njësinë e prokurimit për kryerjen e prokurimit për projektin në fjalë ku sqaron se fondi limit i vënë në dispozicion është 15,869,299 lekë pa TVSH. Sipas urdhrit me Nr. 168/1, datë 08.11.2024, përcaktohet ndarja e detyrave midis anëtarëve të NJP. Nga kontrolli i dokumentacionit të mësipërm nuk ka një dokument justifikues ku të përcaktohet qartë vlera e fondit limit dhe se si është arritur në këtë vlerë. Në urdhrin e e prokurimit përcaktohet që fondi limit i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit është 15,869,299 lekë pa TVSH, por në urdhrin për ndarjen e detyrave në detyrat e inxhinierit përcaktohet se ka për detyrë sipas: *"pika c) përllogaritjen e fondit limit nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme"*. Nuk ka asnjë dokument justifikues që hartimi i fondit limit të jetë kryer nga një strukturë e posaçme apo të jetë kryer nga inxhinieri i NJP.

Pra përllogaritja e fondit limit nuk dokumentohet se si është hartuar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

Hartimi i kritereve

Pas urdhrit të prokurimit nga ana e NJP me anë të shkresave me nr. 1851/6 dhe 1851/7 datë 11.11.2024 u hartuan procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit si dhe termat e referencës. Nga auditimi i dokumentacionit të sipërpërmendur konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere me problematika të ndryshme si dhe kritere të paqarta. Për shkak të këtyre kritereve dhe ndryshimeve të vazhdueshme në to; procedura e prokurimit ka pësuar katër (4) pezullime dhe rifillime përgjatë muajit dhjetor 2024, si pasojë e ndërhyrjeve të APP-së:

- **Pezullim i parë:** Urdhër nr. 168/2, datë 11.12.2024 (nr. 1851/9 prot,), bazuar në ndërhyrjen e APP; ku i komunikohet AK të rishikojë kriteret lidhur me: kriteret e përzgjedhjes së fituesit, pikat e licencave të OE konkurrues, inxhinierët dhe personelin e stafit të OE, certifikatat ISO etj.
- **Rifillim i parë:** Urdhër nr. 168/3, datë 11.12.2024 (nr. 1851/11 prot,); ku është caktuar data e re e prokurimit 27.12.2024;
- **Pezullim i dytë:** Urdhër nr. 168/4 (nr. 1851/12 prot, datë 23.12.2024); pas koordinimit me APP në datë 19.12.2024.
- **Rifillim i dytë:** Urdhër nr. 168/5 (nr. 1851/13 prot, datë 23.12.2024); ku është data e re e prokurimit 09.01.2025.

Ndërhyrjet e APP mbi DST-të rezultuan në ndryshimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit (Referuar Procesverbalit Nr. 2, datë 23.12.2024 i cili është mbajtur pas ndërhyrjes APP më datë 19.12.2024). Janë lëshuar njoftimet për ndryshimin e dokumenteve të tenderit me datat e reja të prokurimit (data 27.12.2024 dhe 09.01.2025).

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere të paargumentuara dhe të pambështetura teknikisht, konkretisht:

Referuar procesverbalit të argumentimit të kritereve nr. 1851/6 datë 11.11.2024, përcaktohet se procedura e prokurimit do të jetë me "Çelësa në dorë" (projektim + zbatim njëkohësisht), nga ana e NJP nuk sqarohet se për çfarë arsye është përzgjedhur kjo lloj procedure, cili ishte shkaku që nuk u nda më vete me dy procedura prokurimi pjesa e "Projektimit" dhe pjesa tjetër e "Zbatimit" të punimeve. Zgjedhja e llojit të kontratës "çelësa në dorë" e paargumentuar përbën shkelje të nenit 77, pika 1 dhe nenit 78, pika 2 të ligjit nr. 162/2020. Përzgjedhja e kësaj tipi procedure ngushton artificialisht konkurrencën duke e kufizuar grupin e operatorëve ekonomikë të mundshëm vetëm tek ata që disponojnë njëkohësisht kapacitete si për projektim ashtu edhe për zbatim punimesh. Sipas nenit 78, pika 2, çdo specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, duke mos kufizuar konkurrencën pa justifikim të nevojshëm.

Gjithashtu në termat e referencës sqarohen më shumë të dhënat e pajisjeve për vjeljen e pagesës së parkingut, si lexues automatik, tra, software për menaxhimin e të dhënave, vendosja e një kioskë për pikën e pagesës, kamera dhe konfigurimi i tyre. Por këto të dhëna janë pamjaftueshme për hartimin e këtij projekti dhe si rrjedhim edhe të kritereve për kualifikim.

- Në pikën 2 tek Kriteret e veçanta të kualifikimit për projektuesin është kërkuar:

"*2. Licenca profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:*

1. Projektim Urbanist Kat. 1. b 2. Plane sektoriale në nivel bashkie.

Njësia e Prokurimit ka parashtruar se "Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrën e projektimit" dhe se çdo kategori justifikohet nga specifika të projektit

(arkitektë për peizazhin, hidroteknikë për infrastrukturën, gjeodetë për rilevime ekzistuese, etj.).
Njësia e Prokurimit nuk ka justifikuar teknikisht vendosjen e këtij kriteri pasi kjo kategori i referohet planifikimit territorial strategjik, planeve të zhvillimit të territorit të bashkisë dhe nuk ka lidhje funksionale me projektimin e një vend parkimi dhe Info point-i. Procesverbali i argumentimit të kritereve nuk jep asnjë shpjegim specifik pse ky objekt prokurimi kërkon kapacitet planifikimi sektorial. Përfshirja e kësaj kategorie shton artificialisht kriteret e kualifikimit, duke shkelur nenin 46 pika 3 të LPP dhe nenin 27 pika 3 të VKM 285/2021.
- Në pikën 5 tek Kriteret e veçanta të kualifikimit për projektuesin është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë në stafin e tij të paktën 25 punonjës për 3 muajt e fundit të deklaruar në listë pagesë. Procesverbali i argumentimit të kritereve pohon se"numri është përllogaritur bazuar në shërbime", por nuk e publikon këtë llogaritje si pjesë të dokumentacionit të tenderit. Sipas nenit 27 pika 3 të VKM 285/2021, "*kufizimi i konkurrencës duhet të justifikohet me argumente konkrete dhe të verifikueshme, jo vetëm me referencë ligjore"*. Nga ana e NJP duhet të ishte mirë argumentuar dhe llogaritur në bazë të projekteve të ngjashme, grafikut të punimeve numri i vendosur i 25 punonjësve.
- Në pikën 2.3.2 tek Kriteret e veçanta të kualifikimit për ndërtimin është kërkuar Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: NS-18 A (Punime Topogjeodezike).
Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se: Kategoria NS-18A (Punime Topogjeodezike) kërkon "zbatim rilevimesh topografike speciale me mjete dhe organizim të veçantë" — për shkallën e këtij projekti vend parkimi, kjo kategori tejkalon nevojat reale të piketimeve dhe rilevimeve rutinë të parashikuara.
- Në pikën 2.3.8 tek Kriteret e veçanta të kualifikimit për ndërtimin është kërkuar Operatori ekonomik ofertues duhet të këtë si staf mbështetës: 1.Inxhinier Gjeoteknik me: Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit. Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se vendosja e një inxhinieri gjeoteknik është më tepër i nevojshëm gjatë fazës së projektimit në hartimin e studimit gjeoteknik. Gjithashtu kërkesa që të jetë staf i brendshëm me kontratë pune dhe list pagesë 3 mujore përbën një kërkesë që e kufizon shkallën e konkurrencës pasi ky shërbim mund të realizohet legjitimisht nëpërmjet laboratorëve, specialistëve ose ekspertëve të kontraktuar dhe jo domosdoshmërisht të jetë staf i brendshëm i OE.
- Në pikën 2.3.10. është kërkuar që për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë të paktën 30 personave, të cilët duhet të figurojnë në lis pagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajit e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se argumentimi i AK-së i referohet ekzistencës së analizave teknike dhe grafikut të punimeve, por as analiza as grafiku nuk janë bashkëlidhur si dokumentacion mbështetës të procesverbalit apo të DST-së. Sipas nenit 27 pika 3 të VKM 285/2021, kriteri duhet të jetë i verifikueshëm. Numri 30 persona të punësuar, i deklaruar pa prova mbështetëse dhe pa një sqarim argumentues, nuk i plotëson kushtet e transparencës. Gjithashtu, stafi minimal i kërkuar specifik (inxhinierë + specialistë) dhe numri shtesë i 30 punonjësve të paspecifikuar shton barrën e kualifikimit të pajustifikuar.
- Në pikën 2.3.12 është vendosur një listë më mjete dhe pajisje e cila duhet të deklarohet nga OE sipas formularit përmbledhës të vetë deklarimit (shtojca 8). Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se grafiku i punimeve dhe analizat teknike nuk janë bashkëlidhur me

procesverbalin, duke mos lejuar verifikimin e sasive si për shembull në lidhje me kriterin e domosdoshmërisë të 5 ekskavatorëve me zinxhirë njëkohësisht.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. R.H.

Vlerësimi i Ofertave

Me Urdhër nr. 10, datë 15.01.2025, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur KVO i cili përbëhet nga: S.K. (Kryetar), G.S. (Anëtar) dhe G.G. (Anëtar). Vlerësim i ofertave ka kaluar në disa faza:

Faza I — Hapja e ofertave më datë 09.01.2025 ku: Kanë marrë pjesë 2 OE.

Në datën 16.01.2025 sipas shkresës me nr. 1851/14 KVO i kërkon titullarit të AK të kryhet rivlerësimi i procedurës për shkak se njëri prej anëtarëve të KVO gjatë procesit të vlerësimit të procedurës së prokurimit nuk ka marrë në konsideratë se kemi të bëjmë më një bashkim të operatorëve ekonomik ku OE "N.S." sh.p.k kishte hyrë si bashkim operatorësh (me "A.M." sh.p.k dhe" I.D.A." sh.p.k).

Po në të njëjtën datë titullari i AK ka lëshuar urdhrin nr. 4 datë 16.01.2025 me shkresë më nr. 1851/15 ku urdhëron të vijoj procesi i rivlerësimit.

Faza II —Referuar korrespondencës me APP dhe Urdhrit të parë të rivlerësimit: Në datën 29.01.2025 APP sqaroi se referuar manualit nr. 1 datë 24.12.2021 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomik dhe dorëzimin e ofertave në SPE" citohet se: "*Nuk mund të bëhet asnjë ndryshim i dokumenteve të bashkëlidhura apo dorëzim i ofertave nga ana e operatorëve ekonomik, dhe ka një mospërputhje midis formularit të njoftimit të fituesit të anëtarëve të KVO në SPE me shpalljen tek dritarja "Fituesi/Bashkim Operatorësh" në SPE"*. Në datën 03.02.2025 përgjegjësi i NJP komunikon përsëri duke kërkuar rekomandim për vijueshmërinë e procedurës. APP sqaroi më datë 06.02.2025 se NJP duhet të argumentojë të dhënat në dritaren "Përshkrimi" në SPE.

Faza III — Autoriteti Kontraktor pa asnjë rekomandim të APP i shkruan OE "N.S." sh.p.k nëpërmjet komunikimeve me email nga data 13.01.2025-17.02.2025 duke i kërkuar konfirmim nëse e merr përsipër realizimin e kësaj procedure prokurimi si operator i vetëm sipas DST-ve pika 2.3. Më pas OE "N.S." sh.p.k konfirmon referuar komunikimeve më datë 14.02.2025 dhe 17.02.2025 se marrëveshja me kompanitë e tjera ka qenë ekskluzivisht vetëm për pjesën e projektimit. Titullari i AK lëshon Urdhrin me nr. 04/2 datë 17.02.2025 për një rivlerësim të dytë të procedurës. Në datën 17.02.2025 KVO ka përgatitur procesverbalin për vlerësimin e tenderit, ku KVO ka vlerësuar që OE "N.S." sh.p.k plotëson kushtet për të vijuar këtë procedurë si operator i vetëm.

Faza IV — Në datën 25.02.2025 është hartuar "Raporti Përmbledhës për zhvillimin e tenderit" dhe në datën 26.02.2025 është shpallur Vendim nr. 05 për miratimin e raportit përmbledhës dhe shpalljen e fituesit të prokurimit OE "N.S." sh.p.k. Më pas titullari i AK lidh kontratën me OE "N.S." sh.p.k në datën 09.06.2025 për vlerën 14,758,448 lekë pa TVSH, me afat realizimi punimesh 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Gjatë kontrollit të fazave të mësipërme nga ana e GA u konstatua:

Mospërputhje midis dokumentacionit të kualifikimit dhe deklarimit si operator i vetëm, kjo përbën shkelje të nenit 80, pika 1 të ligjit 162/2020 dhe DST-ve pika 2.16. OE "N.S." sh.p.k kishte ngarkuar si pjesë e dokumentacionit të kualifikimit në SPE një marrëveshje bashkëpunimi midis 3 shoqërive për realizimin e fazës së projektimit. Prania e kësaj marrëveshjeje tregon qartë mbështetje tek palët e treta, në kundërshtim të hapur me pikën 2.16 të DST-së (ku shënjohet: Mbështetja "JO"). Duke qenë se kontrata është e tipit "çelësa në dorë" dhe projektimi është detyrim integral i saj (jo shërbim i jashtëm), KVO duhej ta kishte

s'kualifikuar OE "N.S." sh.p.k, pasi ky OE ka hyrë në tender si bashkim operatorësh, në kundërshtim me përcaktimet e DST-së (pjesa ku shënjohet x tek "JO", në pikën 2.16).

- Ndryshim i paligjshëm i statusit juridik të OE pas mbylljes së afatit, pa bazë ligjore dhe pa rekomandim të APP përbën shkelje të nenit 92, pika 3 dhe nenit 38 të ligjit 162/2020. Asnjëherë APP nuk tha se OE "N.S." sh.p.k mund të vijojë si operator i vetëm: sqarimet e APP kishin të bënin ekskluzivisht me procedurën teknike të publikimit të njoftimit të fituesit në SPE, jo me ndryshimin e statusit juridik të OE. Lejimi i konvertimit të statusit nga BOE në OE pas mbylljes së afatit të prokurimit cenon parimin e barazisë dhe trajtimit jo diskriminues të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Klasifikimi i OE-ve sipas vlerësimit të KVO-së:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar / S'kualifikuar
1	"N.S." sh.p.k NIPT: L.....0 Adresa: Lagjja "Selam Musai", Rr. Dule Dalani, Nr. 14/324, Tepelenë	14,758,448	**Kualifikuar:** Operatori ka plotësuar të gjitha kriteret e DST-ve, ka konkurruar si operator i vetëm dhe ka marrë përsipër realizimin e të gjitha punimeve si dhe projektimin, sipas kontratës çelësa në dorë.
2	"P." sh.p.k NIPT: L.....A	SKA (ofertë e pa dorëzuar)	**S'kualifikuar:** Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentacionin e tenderit dhe ofertën ekonomike në sistemin elektronik të prokurimit (SPE). Vlera e ofertës rezulton SKA.

<u>Nga dokumentacioni fizik i dosjes së prokurimit dhe SPE konstatohet se:</u>

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
****1**	**OE "N.S." sh.p.k** NIPT: L.....0 Lagjja "Selam Musai", Rr. Dule Dalani, Nr. 14/324, Tepelenë	14,758,448 lekë pa TVSH *(17,416,968 lekë me TVSH)*	**1.** Nga kontrolli i formularit të vetë deklarimit, u konstatua se i njëjti person (z. L.H.) është deklaruar njëkohësisht si punonjës elektrik dhe si punonjës karpentier, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik, i cili ndalon angazhimin e të njëjtin person për dy funksione të ndryshme brenda të njëjtin ofertues. Konkretisht: **Punonjës Elektrik —** Kontrata e punës e depozituar për z. L.H. tregon profesionin "hidraulik" dhe jo "elektrik", siç kërkohet nga DST-ja. Dokumenti i paraqitur si dëshmi kualifikimi është një vërtetim IQT (Inspektorati i Qendrës Teknike), i cili ka karakter të sigurimit teknik të pajisjeve dhe nuk përbën dëshmi profesionale. **Punonjës Karpentier —** Për këtë pozicion nuk është depozituar kontratë pune që të vërtetojë marrëdhënien e punësimit. Dokumentacioni i paraqitur si dëshmi kualifikimi është vetëm certifikata e profesionit karpentier, pa dokumentin e punësimit shoqërues. **Dhe për punonjësin Teknik Hidraulik —** Shoqëria ka deklaruar z. H.H. për këtë pozicion. Nuk është depozituar kontratë pune për profesionin e teknikut hidraulik dhe nuk ka paraqitur asnjë dëshmi kualifikimi apo certifikatë profesionale. Dokumenti i vetëm i paraqitur është një vërtetim IQT, i cili nuk vërteton kualifikim profesional. **2.** Sipas formularit të vetë deklarimit, shoqëria ka deklaruar për pozicionet e manovratorit dhe shoferit punonjësit e mëposhtëm: z. V.B. (manovrator), z. N.C. (shofer) dhe z. F.H. (shofer). Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar pranë KVO-së, u konstatua se për asnjërin nga personat e sipërcituar nuk është depozituar kontratë pune. Mungesa e kontratave të punës për të tre personat e deklaruar përbën shkelje të hapur dhe të dokumentuar të kushteve të kualifikimit të parashikuara në pikën 8 të DST-së. **3.** Nga analiza e formularit të vetë deklarimit, u konstatua se personat e mëposhtëm janë deklaruar njëkohësisht për funksione të shumta dhe të ndryshme: Z. F.H. është deklaruar njëkohësisht për funksionet: Arkitekt, Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Ekspert Zjarrfikës dhe Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave. Znj. G.B. është deklaruar njëkohësisht si Inxhiniere Mjedisi dhe Drejtuese Teknike Mjedisi, dhe njëkohësisht si Menaxhere Energjie (certifikatë e lëshuar nga Agjencia për Efiçensës e Energjisë), Vlerësuese e Ndikimit në Mjedis, Audituese Mjedisore dhe eksperte e mbrojtjes dhe administrimit të dëmtimit në mjedis. Akumulimi i funksioneve të shumta dhe të ndryshme mbi të njëjtët

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
			persona bie ndesh me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe nuk vërteton disponimin e stafit mbështetës sipas kërkesave të pikës 2.3.8 të DST-së. **4.** Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar pranë KVO-së, u konstatuan parregullsi në dokumentacionin e mjeteve të mëposhtme (pika 2.3.12 e DST-së): **Autobot uji (AAMP):** Mungon certifikata e transportit. Polica e sigurimit ka skaduar më datë 04.10.2024, ndërkohë që procedura e prokurimit u zhvillua më 09.01.2025. Mjeti nuk plotëson kushtin e vlefshmërisë së sigurimit gjatë periudhës së ekzekutimit. Dokumentacioni i dorëzuar pranë KVO-së për mjetet e sipërcituara nuk është i plotë dhe i rregullt sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2.3.12 të DST-së. Mangësitë e konstatuara nuk lejojnë vlerësimin pozitiv të disponueshmërinë ligjore të mjeteve nga ana e operatorit ofertues.

Kualifikimi i operatorit ekonomik N.S. sh.p.k në kundërshtim me kërkesat e DST-së përbën shkelje të nenit 80, pika 1 dhe nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020.KVO ka shpallur fitues dhe ka rekomanduar lidhjen e kontratës me OE "N.S." sh.p.k, pavarësisht se nga verifikimi i dokumentacionit rezulton qartësisht mos përmbushja e kritereve të veçanta të kualifikimit të parashikuara në pikat 2.2.3, 2.3.10, 7, 8, 2.3.8 dhe 2.3.12 të DST-së. Sipas nenit 80, pika 1, autoriteti kontraktor është i detyruar të verifikojë që oferta përmbush të gjitha kushtet para dhënies së kontratës. Ky detyrim nuk është respektuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, z. S.K, z. G.S. dhe z. G.G.

Konkluzion:
Sa më sipër rezulton se: NJP dhe KVO kanë vepruar me shkelje të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, si vijon: pika 1, "*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të këtë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura"*, neni 92 pika 3, *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji".*

10-Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë.*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi"".		
1.Urdhër Prokurimi: Nr. 88/4, datë 03.07.2023	**2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Nr. 88/4, datë 03.07.2023 1. J.K. – (Person Përgjegjës/Jurist) 2. M.S. (Inxhinier Gjeodet) 3. S.Ç. (Inxhinier Hidroteknik)	**3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 88/4, datë 03.07.2023 1. S.K. – (Kryetar) 2. G.S. – (Anëtar) 3. R.K. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapur" me çelësa në dorë		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 108,776,265 lekë pa TVSH	**6.Oferta fituese:** BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k me ofertë 107,997,000 lekë pa TVSH, lidhje kontrate datë 04.09.2023, me afat realizimi 7 muaj kalendarike.	**7.Diferenca me fondin limit:** - 779,265 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: REF-76161-07-27-2023 Hapje: 16.08.2023 ora 09:00	**9.Burimi Financimit:** Ministria e Arsimit dhe Sportit – buxheti i shtetit 2023, fondi i vënë në dispozicion për projektin (mall).	**10.Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës: 4 OE/BOE **b)** S'kualifikuar: 3 OE/BOE **c)** Kualifikuar: 1 BOE

11.Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13.Përgjigje Ankesës nga KPP**: Nuk ka
14. Lidhja e Kontratës: Kontratë pune civile (çelësa në dorë) me Vendim Nr. 38, datë 04.09.2023; afat 7 muaj kalendarike.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH):** 129,178,400 lekë me TVSH	

Hartimi i projektit dhe fondit limit

Hartimi i projekt idesë është kryer sipas përcaktimeve të kontratës së dhurimit me nr. 2764 prot, datë 14.11.2022 me objekt "Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë nga OE "N.S." sh.p.k. Referuar shkresës me nr. 1993/1 prot, datë 24.03.2023 është bërë shpallja e thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2023-2024. Me shkresën me nr. 778 prot, datë 06.04.2023 Bashkia Tepelenë ka aplikuar për bashkëfinancim. Me shkresën nr. 3124/5 prot, datë 09.06.2023 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë dërguar çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për projektet me cikël financimi 2023-2024. Financimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit do të jetë në shumën 130,531,518 lekë dhe do të shtrihet në periudhën buxhetore 2023-2024.

Me urdhër të Titullarit të Institucionit me nr. 88, datë 29.06.2023 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga 1. J.K. (P. Përgjegjës për prokurim Juriste), 2. M.S. (Inxhinier Gjeodet). 3. S.Ç. (Inxhinier Ndërtimi) në procedurën e hapur "*Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë* me fond limit 108,776,265 lekë pa TVSH. Sipas urdhrit të Titullarit të Institucionit me nr. 96/1 datë 17.07.2023 përcaktohet ndarja e detyrave për anëtaret e njësisë së prokurimit. Referuar këtij urdhri inxhinieri në njësinë e Prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:

a) *hartimin e specifikimeve teknike;*
b) *përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme;*
c) *hartimin e kritereve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;*
d) *hartimin e kritereve të vlerësimit, nëse është rasti;*
e) *përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si psh: grafiku i lëvrimit).*
f) *llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.*
g) *përgatitjen e dokumenteve ekonomiko-financiare të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre.*

Nga kontrolli i dokumenteve të vëna në dispozicion u konstatua se nuk ka gjurmë dokumentare mbi përllogaritjen e fondit limit; nuk ka një dokument justifikues ku të përcaktohet qartë vlera e fondit limit, dhe si është arritur në këtë vlerë, pasi në dosjen ligjore u gjet një preventiv bosh, pa çmime dhe pa zëra pune, pa volume si dhe pa vlerë të kapitujve të punimeve që do të kryhen, në kundërshtim me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve*". Në dosje ka vetëm një procesverbal ku është përcaktuar llogaritja e vlerës së projektimit por nuk ka një procesverbal për përllogaritjen e vlerës së fondit limit. Pra përllogaritja e fondit limit nuk dokumentohet se si është hartuar, kjo në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet" dhe *neni 13, pika 4.*

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S. dhe z. S.Ç.

Hartimi i kritereve

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, autoriteti kontraktor (Njësia e Prokurimit), me nr. 1187/11 prot., me datë 25.07.2023 ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Me shkresën nr. 1187/12 prot, datë 27.07.2023 të Titullarit të Institucionit është kryer miratimi i llojit të procedurës dhe dokumentacionin e kërkuar për kryerjen e prokurimit për objektin "Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë. Me shkresën nr. 1187/13 prot, datë 27.07.2023 është hartuar njoftimi shkurtuar i kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërpërmendur konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere me problematika të ndryshme si dhe kritere të paqarta. Për shkak të këtyre kritereve dhe ndryshimeve të vazhdueshme në to; procedura e prokurimit ka pësuar 2 pezullime dhe rifillime sipas shkresave të mëposhtme:

- Me anë të shkresave nr. 1187/14 prot, datë 03.08.2023 dhe shkresës me nr. 1187/15 prot, datë 03.08.2023 dhe është njoftuar për ndryshimin e dokumenteve të tenderit.
- Me shkresën nr. 1187/16 prot, datë 03.08.2023 është lëshuar nga ana e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor një urdhër për pezullimin e procedurës së prokurimit për objektin e mësipërm. Pas disa komunikimeve me anë të emailit me APP, nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kryer disa ndryshime në lidhje me kriteret e kualifikimit.
- Me shkresën nr. 1187/18 prot, datë 04.08.2023 është lëshuar nga ana e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor një urdhër për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit për objektin e mësipërm.
- Me shkresën nr. 1187/17 prot, datë 14.08.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kryer disa ndryshime në lidhje me kriteret e kualifikimit ku është publikuar shtojca në DST pa ndryshuar afatin e dorëzimit të ofertave.

Ishte	**Bëhet**
1.Në pikën 2.2 të kritereve të veçanta për kualifikim, AK ka kërkuar: "Licenca profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë: Kat. 1 c -Plane te detajuara vendore Kat. 2. PROJEKTUES ARKITEKT b-2) Objekte arsimore; c- Projektim interierë; d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe te gjelbra, lulishte e parqe. Kat.3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. b) 1. Objekte civile -industriale - turistike mbi 5 kale -2. objekte me skelet metali c) Projektim: 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Belon-arme-metalike -2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri le ulel; Kat.4. PROJEKTUES INSTALATOR a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;	Kat. 2. PROJEKTUES ARKITEKT b-2) Objekte arsimore; c- Projektim interierë; d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe te gjelbra, lulishte e parqe. Kat.3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. c) Projektim: 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Belon-arme-metalike Kat.4. PROJEKTUES INSTALATOR a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare; b) Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjisë termike nga burime te rinovueshme c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit; h) Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.); j) Projektim te rrjeteve te telefonisë, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e

b) Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjisë termike nga burime te rinovueshme c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit; h) Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.); j) Projektim te rrjeteve te telefonisë, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit te zjarrit, etj, për objektet civile dhe industriale. Kat.5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi. Kat.8. PROJEKTUES GJEODET a) Rilevime inxhinierike b) Rilevime inxhinierike kadastrale c) Sistemet GIS d) Bazamente gjeodezike e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik Kat.9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate. b) Studim/Vlerësim gjeologjik-inxhinierike i truallit për objekte civile ekonomike mbi 5 kate Kat.10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm. Kat.12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.	alarmit, sistemet e detektimit te zjarrit, etj, për objektet civile dhe industriale. Kat.5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi. Kat.8. PROJEKTUES GJEODET a) Rilevime inxhinierike b) Rilevime inxhinierike kadastrale c) Sistemet GIS d) Bazamente gjeodezike Kat.9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

Ishte	**Bëhet**
4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë si staf mbështetës ku të figurojnë 3 muajt e fundit ne listë pagesa, si më poshtë: - 3 Arkitektë; - 2 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist; ku njeri të jetë Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjencia për Efiçensës e Energjisë për te kryer auditime ne Ndërtesa - 1 Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf - 1 Inxhinier Hidroteknik; - 2 Ekspert Zjarrfikës; - 2 Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh. - 2 punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". - 2 punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.	4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë si staf mbështetës ku të figurojnë 3 muajt e fundit ne listë pagesa, si më poshtë: - 2 Arkitektë; - 2 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist; ku njeri të jetë Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjencia për Efiçensës e Energjisë për te kryer auditime ne Ndërtesa - 1 Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf - 1 Inxhinier Hidroteknik; - 2 Ekspert Zjarrfikës; - 2 Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh. - 1 punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". - 2 punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Ishte	Bëhet
Në pikën 2.3.2/a, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ne bazë te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: (a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit: · N.P.–1 A Punime gërmimi në tokë; · N.P.–2 B Ndërtime civile e industriale; · N.P.–3 D Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash; · N.P.–4 A Punime në rrugë, etj.; · N.P.–12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit. (b) Për punimet speciale të ndërtimit: (1) N.S.–1 A Punime për prishjen e ndërtimeve; (2) N.S.–2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre; (3) N.S–4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtues; (4) N.S.–12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit; (5) N.S.–13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; (6) N.S.–14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV; (7) N.S.–18 A Punime topogjeodezike".	Në pikën 2.3.2/a, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ne bazë te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: (a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit: · N.P.–1 A Punime gërmimi në tokë; · N.P.–2 B Ndërtime civile e industriale; ·N.P.–3 D Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash; (b) Për punimet speciale të ndërtimit: (1) N.S.–1 A Punime për prishjen e ndërtimeve; (2) N.S.–2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre; (3) N.S.–4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtues; (4) N.S.–12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit; (5) N.S.–13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; (6) N.S.–14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV; (7) N.S.–18 A Punime topogjeodezike".

Ishte	Bëhet
Në pikën 2.7 të kapacitetit: "Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe te paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si me poshtë: a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë; b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë se mjedisit; c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë; d) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë; e) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit të Integruar	Në pikën 2.7 të kapacitetit: "Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe te paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si me poshtë: a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë; b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë se mjedisit; c) ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë; d) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë; e) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit të Integruar (3) N.S.–4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtues; (4) N.S.–12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit; (5) N.S.–13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; (6) N.S.–14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV; (7) N.S.–18 A Punime topogjeodezike".

Ishte	Bëhet
Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të deklarojë (sipas shtojcës 8 të DST) se ka të punësuar minimalisht 3 (tre)	Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të deklarojë (sipas shtojcës 8 të DST) se ka të punësuar minimalisht 3 (tre) (manovratore) dhe 4 (katër) shofera, për

(manovratore) dhe 4 (katër) shofera, për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik, duhet të paraqes kontratat e punës të (vlefshme), Dëshmi e Aftësisë Profesionale D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. Për stafin e mësipërm subjekti duhet të paraqesë këto dokumente: - Listë pagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve". - Kontrate pune të vlefshme gjatë periudhës se ekzekutimit të kontratës. Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetë deklarimit sipas shtojcës nr. 8.	periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik, duhet të paraqes kontratat e punës të (vlefshme), Dëshmi e Aftësisë Profesionale D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. Për stafin e mësipërm subjekti duhet të paraqesë këto dokumente: - Listë pagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve". - Kontrate pune të vlefshme gjatë periudhës se ekzekutimit të kontratës. - drejtuesit e mjeteve në lis pagesat e shoqërisë, mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit. Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetë deklarimit sipas shtojcës nr. 8.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kritere të paargumentuara dhe të pambështetura teknikisht, konkretisht:

Referuar procesverbalit të argumentimit të kritereve nr. 1187/11 datë 25.07.2023, përcaktohet se procedura e prokurimit do të jetë me "Çelësa në dorë" (projektim + zbatim njëkohësisht), nga ana e NJP nuk sqarohet se për çfarë arsye është përzgjedhur kjo lloj procedure, cili ishte shkaku që nuk u nda më vete me dy procedura prokurimi pjesa e "Projektimit" dhe pjesa tjetër e "Zbatimit" të punimeve. Zgjedhja e llojit të kontratës "çelësa në dorë" e paargumentuar përbën shkelje të nenit 77, pika 1 dhe nenit 78, pika 2 të ligjit nr. 162/2020. Përzgjedhja e kësaj tipi procedure ngushton artificialisht konkurrencën duke e kufizuar grupin e operatorëve ekonomikë të mundshëm vetëm tek ata që disponojnë njëkohësisht kapacitete si për projektim ashtu edhe për zbatim punimesh. Sipas nenit 78, pika 2, çdo specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, duke mos kufizuar konkurrencën pa justifikim të nevojshëm.

- Në pikën 3 të DST-së për kriteret e veçanta të kualifikimit në Projektim është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të këtë si drejtues teknik në Licencën e shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në list pagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar: 1 Inxhinier Gjeolog.

Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se: Kontrata me "Çelësa në dorë" (projektim + zbatim) justifikon nevojën për profilet kryesore inxhinierike, pasi OE duhet të realizojë të gjithë ciklin e projektimit nga studimi fillestar deri te dorëzimi i projektit ekzekutiv. Por prania e një inxhinieri Gjeolog është e domosdoshme gjatë fazës së studimit gjeologjik-inxhinierike dhe shërbimi i tij nuk kërkon praninë e gjeologut si drejtues teknik i brendshëm gjatë gjithë ciklit dhe të zbatimit.

- Në pikën 4 për kriteret e veçanta të kualifikimit në Projektim është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë si staf mbështetës ku të figurojnë 3 muajt e fundit në listë pagesa, si më poshtë:

-2 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist; ku njëri të jetë auditues energjetik i certifikuar nga Agjencia për Efiçensës e Energjisë për të kryer auditime në ndërtesa.

-2 punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se: në procesverbalin e hartimit të kritereve nuk shpjegohet nevojshmëria se përse duhen 2 specialist të brendshëm për VNM dhe jo 1, ose dhe nëpërmjet kontratës shërbim. Gjithashtu edhe përcaktimi i nevojshmërisë së një Inxh. Ndërtimi Strukturist i cili duhet të jetë Auditues energjetik i Certifikuar nga AEE: pra

një profil me dy certifikime specifike njëkohësisht, ky kriter është për një numër shumë i kufizuar profesionistësh, duke ngushtuar konkurrencën.

- Në pikën 6 për kriteret e veçanta të kualifikimit në "Projektim" është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë në stafin e tij të paktën 25 punonjës për 3 muajt e fundit të deklaruar. Tek procesverbali i argumentimit të kritereve nuk argumentohet me anë të një llogaritje si pjesë të dokumentacionit të tenderit. Sipas nenit 27 pika 3 të VKM 285/2021, "*kufizimi i konkurrencës duhet të justifikohet me argumente konkrete dhe të verifikueshme, jo vetëm me referencë ligjore"*. Nga ana e NJP duhet të ishte mirë argumentuar dhe llogaritur në bazë të projekteve të ngjashme, grafikut të punimeve numri i kërkuar i 25 punonjësve, veprim i tillë kufizon konkurrencën.

- Në pikën 2.3.6 për kriteret e veçanta të kualifikimit në fazën e zbatimit Operatori Ekonomik ofertues duhet të këtë si staf mbështetës si më poshtë:
- 2 Arkitektë;
- 1 Inxhinier Gjeoteknik
- 1 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjencia për Efiçensës e Energjisë për të kryer auditime në Ndërtesa;
- 2 punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*.
- 2 punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për VNM.
- 1 punonjës i pajisur me certifikatë për përgjegjës dhe administrimin e mbrojtjes në mjedis.

Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se: në procesverbalin e hartimit të kritereve nuk shpjegohet nevojshmëria se përse duhen njëkohësisht 2 specialist të arkitekt, 2 punonjës të pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe 2 punonjës të pajisur me certifikatën për VNM, duke qenë se kërkohen edhe 2 projektuesa që në fazë projektimit të kenë certifikatë për VNM. Gjithashtu edhe përcaktimi i nevojshmërisë së një Inxh. Ndërtimi Strukturist i cili duhet të jetë njëkohësisht dhe Auditues Energjetik kufizon konkurrencën.

Në lidhje me kriterin e 1 Inxhinieri Gjeoteknik si staf i brendshëm zbatimi: kontrata me "çelësa në dorë" justifikon nevojën për studimin gjeoteknik si pjesë e projektimit, por ky studim kryhet në fazën e projektimit, jo gjatë zbatimit, pra është i panevojshëm në këtë fazë.

- Në pikën 2.3.11 për kriteret e veçanta të kualifikimit në fazën e zbatimit Operatori/ët ekonomik, të vetë deklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetë deklarimit (shtojca 8), për mjetet dhe pajisjet. Sipas kontrollit të kriterit të mësipërm konstatohet se: në procesverbalin e hartimit të kritereve lista e makinerive është e gjatë (rreth 30 zëra, duke përfshirë 1800m² skela dhe 1000m² armaturë/betoforma) dhe nëse i referohemi procesverbalit të argumentimit të kritereve thuhet se si bazë justifikuese janë marrë analizat teknike dhe grafiku i punimeve. Megjithatë, grafiku i punimeve dhe analizat teknike mbështetëse, nuk janë bashkëlidhur me dokumentet publike të tenderit. Sipas nenit 27(3) të VKM 285/2021, kriteret duhet të jenë të verifikueshme.

- Në lidhje me numrin e të punësuarve sipas pikës 2.3.8 për kriteret e veçanta të kualifikimit në fazën e zbatimit OE pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë të paktën 70 (shtatëdhjetë) punonjës për muajt mars-prill-maj 2023, nga këta sipas llogaritjes së numrit të punonjësve 53 janë personel punëtor dhe 17 staf teknik (inxhiniere + mjek etj) drejtues teknik. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve përcaktohet se: *"Numri*

i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës, afatit të realizimit të kontratës, grafikut të punimeve [...] janë hartuar analizat teknike, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale." Justifikohen 53 punëtorë + 17 staf teknik = 70 punonjës. Baza ligjore: neni 77(4) LPP, neni 39(6/ç)(6/d) VKM 285. Por llogaritja e të punësuarve duhet të ishte mbështetur mbi volume e punimeve të cilat në këtë fazë nuk ishin të përcaktuara pasi sipas tipit të procedurës me "Celësa në dorë" projekti i zbatimit nuk është detajuar dhe volumet nuk janë ende të njohura. Pra edhe pse nga ana e NJP është bërë një tentativë për llogaritjen e numrit të punonjësve kjo nuk është e mbështetur dhe është shumë evasive, pra një numër i tillë punonjësish nuk argumentohet dhe përbën kriter i cili ngushtëson konkurrencën.

Për problematikat e konstatuara në dosjen e prokurimit ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP, znj. J.K., z. M.S dhe z. S.Ç.

<u>Vlerësimi i Ofertave</u>

Me Udhërin me Nr. 88/4, datë 03.07.2023, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur KVO i cili përbëhet nga: S.K. – (Kryetar), G.S. – (Anëtar), R.K. – (Anëtar). Vlerësim i ofertave ka kaluar në disa faza:

Me anë të procesverbalit me nr. 1187/19 prot, datë 16.08.2023, KVO ka mbajtur procesverbalin e hapjes dhe shpallje të tenderit. Janë paraqitur 4 operatorë/bashkime operatorësh: (1) Person Fizik "E.Ç.", (2) BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k, (3) OE "B." sh.p.k, (4) OE "F.C." sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1757/1 prot, datë 29.08.2023 është lëshuar nga ana e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor një urdhër për fillim të pezullimin e procedurës së prokurimit për objektin e mësipërm.
- Me shkresën nr. 1757/2 prot, datë 29.08.2023 është lëshuar nga ana e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor një urdhër për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit për objektin e mësipërm, ky pezullim është kërkuar nga personi përgjegjës në NJP, për të përzgjedhur saktë operatorët që bëjnë pjesë në BOE si dhe % të ndarjes së punimeve të secilës palë.
- Me shkresën nr. 1187/20 me datë 07.09.2023, KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës. Me Vendim Nr. 38, datë 04.09.2023 të Titullarit është shpallur fitues dhe lidhur kontrata me BOE fitues. Titullari i AK ka lidhur kontratën me BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k për vlerën 107,997,000 lekë pa TVSH dhe 129,178,400 lekë me TVSH, me afat realizimi 7 muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

Gjatë kontrollit të fazave të mësipërme nga ana e GA u konstatua se: OE "A.M." sh.p.k figuron në dokumentacionin e depozituar në SPE, por nuk trajtohet roli i sajë nga KVO dhe nuk përfshihet në kontratë përbën shkelje të nenit 80, pika 1 dhe nenit 92, pika 3 të ligjit 162/2020. Nga sistemi elektronik i prokurimit SPE rezulton qartësisht se ndër dokumentet e dorëzuara nga BOE figuron dokumentacion në emër të shoqërisë OE "A.M." sh.p.k konkretisht Kontrata e Shërbimit datë 16.08.2023 për realizimin e fazës së projektimit. Prania e këtij dokumenti në SPE do të thotë se OE "A.M." sh.p.k ka marrë pjesë de facto në procedurë si palë me kapacitete të deklaruara. Megjithatë: (a) KVO nuk ka mbajtur asnjë qëndrim mbi statusin e "A.M." sh.p.k-së në procedurë, as si anëtare bashkimi, as si nënkontraktues, as si shoqëri e mbështetjes; (b) OE "A.M." sh.p.k nuk figuron fare në Raportin Përmbledhës, në Vendimin e Titullarit, as në kontratën e lidhur; (c) KVO kualifikoi BOE-n si të plotësuese të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit për Projektuesin, pa sqaruar me cilën bazë ligjore pranohet kapaciteti projektues i BOE-s kur projektuesi i vetëm "A.M." sh.p.k nuk është anëtar i bashkimit dhe nuk figuron si nënkontraktues sipas DST-ve. Sipas nenit 80, pika 1, AK duhet të verifikojë nëse oferta përmbush të gjitha kushtet para dhënies së kontratës. Sipas nenit 92, pika 3, oferta vlerësohet

e vlefshme vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e dokumenteve të tenderit. Mos adresimi i rolit të "A.M." sh.p.k dhe mos përcaktimi i statusit të saj juridik në procedurë përbëjnë shkelje thelbësore të këtyre neneve.

Klasifikimi i OE-ve sipas vlerësimit të KVO-së:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar / S'kualifikuar + Arsyet
1	Person Fizik "E.Ç." NIPT: M.....1	S'ka ofertë ekonomike	**S'kualifikuar:** Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. KVO shpall ofertën e pavlefshme pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
2	BOE "N.S." sh.p.k NIPT: L.....0 (74%) "Sh." sh.p.k NIPT: K..... N (26%) *Përfaqësuese: "N.S. " sh.p.k*	107,997,000 *(129,178,400 me TVSH)*	**Kualifikuar – FITUES:** Oferta plotëson të gjitha kriteret e DST-ve. Pikë grumbulluara sipas kritereve të vlerësimit: Çmimi: Pk1 = 107,997,000 × 50 / 107,997,000 = 50 pikë; Grafiku i punimeve: Pk2 = 7 × 20 / 7 = 20 pikë; Pk5 = 2 × 5/2 = 5 pikë. Total pikë: 96.8. Afati kohor 7 muaj kalendarike. KVO verifikoi ofertën për gabime aritmetike sipas VKM 285/2021 dhe konstatoi se nuk kishte gabime. Shpallur fitues paraprak me datë 29.08.2023.
3	OE "B." sh.p.k NIPT: L.....0	108,697,000 *(129,956,400 me TVSH)*	**S'kualifikuar:** 1. Nuk ka paraqitur asnjë dokument për projektimin e kontratës dhe asnjë marrëveshje apo kontratë shërbimi për të përmbushur projektimin (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit për Projektuesin). 2. Nuk ka paraqitur dokument që vërteton shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore (pika 2.2.3). 3. Nuk ka dorëzuar Shtojcën 6 – Grafiku i realizimit të punimeve. 4. Nuk plotëson pikën 2.3.4 – nuk deklaroi 2 Arkitektë dhe 1 Mjedis i pajisur me certifikatë Efiçensës së Energjie. 5. Nuk disponon licencën III.2.B (grumbullim, transport, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve) (pika 2.3.5). 6. Nuk ka deklaruar stafin mbështetës sipas pikës 2.3.6. 7. Ka deklaruar vetëm 32 punonjës – nën kufirin e kërkuar prej minimalisht 53 (pika 2.3.8). 8. Nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori për pajisjet e tenderit (pika 2.3.10). 9. Nuk ka paraqitur dokumentat e nevojshme për vlerësimin me pikëzim: Organizimi i kompanisë/Stafit, Propozimet për uljet e ndikimit mjedisor e social, garancinë e objektit etj.
4	OE "F.C." sh.p.k NIPT: M.....0	111,309,867 *(133,571,840 me TVSH)*	**S'kualifikuar:** 1. Oferta tejkalon fondin limit të procedurës (108,776,265 lekë pa TVSH). KVO shpall ofertën e pavlefshme. 2. Nuk ka përputhje të preventivit të hedhur nga OE me ate të hedhur nga AK. 3. Mungon afati kohor i kryerjes. 4. Mungon dokumentacioni teknik-ligjor: Grafiku i punimeve, Organizimi i kompanisë/Stafit, Propozimet për uljet e ndikimit mjedisor e social, garancia e objektit etj. *Nga përllogaritja nëse kishte oferta anomalisht të ulta rezultoi se 'jo' nuk kishte të tilla.*

Nga dokumentacioni fizik i dosjes së prokurimit dhe SPE konstatohet se:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
1	BOE "N.S." sh.p.k NIPT: L.....0 (74%) "Sh." sh.p.k NIPT: K.....N (26%) *Përfaqësuese: "N.S." sh.p.k*	107,997,000 *(129,178,400 me TVSH)*	**1.** Sipas kërkesave të pikës 2.3.1 të DST-ve, për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e marrjes në dorëzim (të përhershme). Nga kontrolli i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k rezulton se për kontratën/at referuese të punëve të ngjashme është paraqitur Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim dhe jo Certifikata e marrjes në dorëzim e përhershme (përfundimtare). Rrjedhimisht, KVO duhej ta kishte trajtuar këtë kontratë referuese si të pakompletuar dhe nuk duhej ta kishte llogaritur në vlerësimin e kapacitetit teknik të BOE-së. **2.** Sipas kërkesave të DST-ve për kriteret e kualifikimit në fushën e projektimit, operatori ekonomik kryesues i BOE, "N.S." sh.p.k, nuk disponon kategorinë e licencës B-2 Kat. II të projektimit të kërkuar. Mungesa e kësaj kategorie licencimi përbën një nga arsyet kryesore për të cilat N.S. ka strukturuar marrëveshjen e bashkëpunimit me "A.M." sh.p.k në fushën e projektimit, së bashku me plotësimin e stafit teknik të projektimit. Megjithatë, pavarësisht rolit të "A.M." sh.p.k në mbulimin e këtij boshllëku licencor dhe të stafit, "A.M." sh.p.k nuk është bërë anëtar formal i BOE. Kjo ngre dyshime të ligjshme mbi transparencën e strukturimit të ofertës, pasi kapacitetet e një subjekti të jashtëm janë

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
			përdorur për plotësimin e kritereve të kualifikimit pa qenë ky subjekt i identifikueshëm dhe i kontrollueshëm si palë formale e BOE, në kundërshtim me parimin e transparencës dhe konkurrencës efektive të garantuar nga neni 2 i Ligjit Nr. 162/2020. **3.** Nga kontrolli krahasimor i formularëve të vetë deklarimit (Shtojca 8) të të dy anëtarëve përsa I përket Projektimit konstatohet se të njëjtit punonjës janë deklaruar njëkohësisht për plotësimin e kritereve të shumta dhe të ndryshme të kualifikimit teknik, konkretisht: - Z. F.H. (N.S.) — deklaruar si Arkitekt dhe njëkohësisht si Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë; - Znj. G.B. (N.S.) — deklaruar si Inxhiniere Mjedisi dhe njëkohësisht si Menaxhere Energjie, Vlerësuese e Ndikimit në Mjedis, Audituese Mjedisore dhe eksperte e mbrojtjes nga dëmtimi mjedisor; - Znj. N.M. (A.M.) — deklaruar si Inxhiniere Ndërtimi/Strukturiste dhe njëkohësisht si Përgjegjëse për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, Eksperte Zjarrfikëse dhe Vlerësuese e Ndikimit në Mjedis. Ky kumulim është në kundërshtim me kërkesat e DST-ve, të cilat parashikojnë profile të ndara pikërisht për të garantuar disponueshmërinë dhe kapacitet të plotë për secilin funksion gjatë ekzekutimit të kontratës. Pranimi i këtij kumulimi nga KVO ka krijuar avantazh artificial për BOE-në, duke i lejuar plotësimin e numrit të kërkuar të profileve me burime njerëzore reale më të pakta, në shkelje të parimit të konkurrencës së ndershme sipas nenit 2 dhe të detyrimit të vlerësimit të kujdesshëm sipas nenit 80, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020. **4.** Nga kontrolli i formularëve të vetë deklarimit (Shtojca 8) të BOE-së së ndërtimit "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k, konstatohet se i njëjti punonjës është deklaruar njëkohësisht për plotësimin e kritereve të ndryshme të kualifikimit të parashikuara në pikat 2.3.4 dhe 2.3.5 të DST-ve, konkretisht: Tek "N.S." sh.p.k: - Z. F.H. — deklaruar si Arkitekt sipas pikës 2.3.4 (stafi inxhinierike) dhe njëkohësisht si punonjës për Montim/Riparim Kaldaje sipas pikës 2.3.5 (stafi me profesione); - Z. H.H. — deklaruar si Ekspert Zjarrfikës sipas pikës 2.3.4 dhe njëkohësisht si Hidraulik sipas pikës 2.3.5; Përveç sa më sipër, nga dokumentacioni justifikues i paraqitur rezulton se Z. H.H nuk disponon titullin/certifikatën "Ekspert në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit" të lëshuar nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH), që është institucioni i vetëm publik kompetent për lëshimin e kësaj certifikatë sipas legjislacionit në fuqi. Certifikata e paraqitur është lëshuar nga një ent privat si certifikim i zakonshëm profesional, i cili nuk ka të njëjtën vlerë ligjore dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalent i titullit zyrtar të lëshuar nga PMNZSH. Rrjedhimisht, Z. H.H nuk plotëson këtë kriter kualifikimi dhe KVO duhej ta kishte trajtuar këtë deklarim si të pamjaftueshëm dhe s kualifikues, në zbatim të nenit 80, pika 1 dhe nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020. - Z. J.H. — deklaruar si Murator dhe njëkohësisht si Manovrator sipas pikës 2.3.5; - Z. F.B. — deklaruar si Pllakashtrues dhe njëkohësisht si Shofer sipas pikës 2.3.5. Tek "Sh." sh.p.k: - Znj. V.T. — deklaruar si Inxhiniere Ndërtimi sipas pikës 2.3.4 dhe njëkohësisht si Përgjegjëse për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, rol i cili sipas natyrës së tij kërkon disponueshmërinë dhe vëmendje të plotë e të pavarur; - Znj. V.S. — deklaruar si Inxhiniere Elektrike sipas pikës 2.3.4 dhe njëkohësisht si Përgjegjëse për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë. Deklarimi i të njëjtit punonjës për plotësimin e dy kritereve të ndryshme e të pavarura të kualifikimit është në kundërshtim me kërkesat e pikave 2.3.4 dhe 2.3.5 të DST-ve, të cilat parashikojnë profile dhe funksione të ndara me qëllim garantimin e kapacitetit real të zbatimit. Kjo praktikë ka lejuar BOE-në të plotësojë numrin e kërkuar të punonjësve me burime njerëzore reale dukshëm më të pakta, duke krijuar pamjen e plotësimit të kritereve pa pasur kapacitetin faktik të nevojshëm. KVO duhej të kishte kryer verifikim krahasimor të listave të punonjësve brenda çdo formulari vetë deklarimi, në zbatim të nenit 80, pika 1 dhe nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020. **5.** Gjatë verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe të dokumentacionit fizik të dorëzuar pranë KVO-së, u konstatua se vërtetimi i paraqitur nga operatori ekonomik N.S. sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve ndaj energjisë elektrike është lëshuar më datën 23.08.2023. Duke qenë se procedura e prokurimit është mbyllur më datën 16.08.2023, vërtetimi i sipërcituar ka datë të mëvonshme se data e mbylljes së procedurës. Rrjedhimisht, ky dokument nuk mund të këtë qenë pjesë e ofertës së dorëzuar brenda afatit ligjor të tenderimit. Kjo rrethanë tregon se operatori ekonomik N.S. sh.p.k ka deklaruar disponimin e këtij dokumenti në formularin e vetë deklarimit, ndonëse dokumenti nuk ekzistonte në datën e mbylljes së ofertave. Formulari i vetë deklarimit i paraqitur nga shoqëria rezulton të jetë i pasaktë dhe jo i vërtetë, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021. **6.Autorizimet** Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "N.S." sh.p.k u konstatua se:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSH	Mungesat e dokumentacionit në dosje:
			Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim nga shoqëria "D." sh.a. (në cilësinë e distributorit), e cila në dokumentin e saj deklaron se është "distributor kryesor i "T.S." në Shqipëri për të gjitha llojet e parketeve dhe laminateve të prodhuara nga kjo kompani. Megjithatë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin mbështetës (kontratë ose autorizim) që vërteton lidhjen juridike ndërmjet prodhuesit "T.S" (B.P, Serbi) dhe distributorit "D." sh.a, siç përcaktohet shprehimisht në pikën 2.3.10 të Dokumenteve të Tenderit. Në mungesë të këtij dokumentacioni, nuk është e mundur të verifikohet nëse shoqëria "D." sh.a gëzon të drejtën e autorizuar për të përfaqësuar dhe autorizuar palë të treta në emër të prodhuesit "T.S"për këtë procedurë prokurimi. Kjo përbën mosplotësim të kërkesës së pikës 2.3.10 të Dokumenteve të Tenderit.

Kualifikimi i operatorit ekonomik të BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k në kundërshtim me kërkesat e DST-së përbën shkelje të nenit 80, pika 1 dhe nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020.KVO ka shpallur fitues dhe ka rekomanduar lidhjen e kontratës me BOE "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k, pavarësisht se nga verifikimi i dokumentacionit rezulton qartësisht mos përmbushja e kritereve të veçanta të kualifikimit të parashikuara në pikat 2.2.3, 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5, 8, 2.3.10 dhe 2.3.10 të DST-së. Sipas nenit 80, pika 1, autoriteti kontraktor është i detyruar të verifikojë që oferta të përmbushi të gjitha kushtet para dhënies së kontratës. Ky detyrim nuk është respektuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, z. S.K, z. G.S. dhe z. R.K.

Konkluzion:
Sa më sipër rezulton se: NJP dhe KVO kanë vepruar me shkelje të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, si vijon: pika 1, "*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të këtë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura"*, neni 92 pika 3, *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji".*
(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.2.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike për subjektin Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-30.12.2025, rezulton se:
Referuar raportit të auditimit të kaluar *"Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë"* për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 të KLSH, si dhe objekte të marra në dorëzim në atë periudhë, kanë ngelur pa audituar nga grupi i kaluar si më poshtë:

Nr.	Objekti i Zbatuar	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Op. Ekonomik	Audituesi/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi i fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë"	Open Local	195,833,333	193,889,182	B.O.E "2." sh.p.k dhe "G."	Përzgjedhur për auditim

2	"Ndërtim i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë		29,082,068	28,914,365.7	"2." sh.p.k	Përzgjedhur për auditim
3	Furnizim dhe vendosje matsash uji në pallatet me kolonë të brendshme, qyteti Tepelenë	Open Local	12,769,562	12,244,051	N.S. sh.p.k	Nuk është përzgjedhur për shkak të vlerës
4	Sistemim asfaltim rrugë në qytet dhe rruga veriore Dragot		12,233,833	10,325,179	N. sh.p.k	Nuk është përzgjedhur për shkak të vlerës
	Vlera totale e objekteve		**249,918,796**	**245,372,778**		

Referuar regjistrit të realizimit të kontratave të punimeve gjatë vitit 2023 është realizuar 1 kontratë zbatimi punimesh me fond limit 108,776,265 dhe vlerë kontrate 107,997,000 lekë pa TVSH si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Op. Ekonomik	Audituesi/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	"Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi "	Open Local	108,776,265	107,997,000	B.O.E "N.S.& "Sh." sh.p.k	Përzgjedhur për auditim

Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2024 janë realizuar 3 kontrata prokurimi me fond limit 28,828,092 lekë pa TVSH si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl. Kontratës	Op. Ekonomik	Audituesi/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	"Rikonstruksion i godinës së Njësisë Qendër Tepelenë"	Open simple	8,750,000	6,900,645	OE "A.C." sh.p.k	Punimet janë ende në proces.
2	Projekt zbatimi objekti: Ndërtimi i vend parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mirëpritje dhe Historia në Divanin e Pashait)"	Open Local	15,869,299	14,758,448	"N.S." sh.p.k	Nuk ka filluar ende zbatimi i punimeve
3	"Rikonstruksion i lerave në Bashkinë Tepelenë"	Open simple	4,208,793	4,200,000	"E." sh.p.k	Nuk është përzgjedhur për shkak të vlerës
	Vlera totale e objekteve		**28,828,092**	**25,859,093**		

Sa më sipër nga kontratat e mundshme për tu audituar me vlerë totale të kontratave **360,270.4 mijë lekë pa TVSH,** janë përzgjedhur për tu audituar **3 kontrata** zbatimi punimesh me vlerë totale **330,800.5 mijë lekë pa TVSH**, ose **92%** e vlerës totale të kontratave të mundshme për tu audituar.

Në mënyrë të detajuar situata e çdo kontrate paraqitet si vijon:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi", Bashkia Tepelenë*** rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 1187/23 prot, datë 20.09.2023, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit B.O.E "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k sipas licencave respektive NZ.7..4/10 dhe NZ.3..0/24. Vlera e kontratës është 129,178,400 lekë me TVSH. Për këtë objekt është lëshuar një leje rikonstruksioni me nr. BT-LNI070223, më datë 07.12.2023.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 2019/10 prot, datë 11.12.2023, midis AK Bashkia Tepelenë dhe Mbikëqyrësit B.O.E "A.M." sh.p.k & "I.D.A." sh.p.k, sipas licencave respektive për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.2..6/2 dhe MK.1..6/7. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 473/1 prot, datë 19.03.2025, midis AK Bashkia

Tepelenë dhe Kolaudatorit OE "R." sh.p.k, me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1..6/12. Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike OT dërguar me shkresën nr. 119/2, datë 23.02.2022 të Institutit të Ndërtimit; referuar konkluzionit të OT sqarohet se projekti ka nevojë për disa plotësime. AK nuk ka vazhduar korrespondencën me projektuesin për të kryer të gjitha plotësimet e nevojshme të projektit, punimet kanë vazhduar zbatimin e këtij projekti pa marrë parasysh konkluzionet në Oponencën Teknike. Këto mosplotësime të nevojshme në projekt i dëshmon dhe fakti që më vonë është kryer rishikimi i projektit fillestar për të plotësuar këtë projekt me detaje teknike dhe ndryshime të nevojshme për zbatimin e tijë.
- Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor vënë në dispozicion rezultoi se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 12.12.2023. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 12.12.2023. Afati i kontratës është parashikuar 7 muaj. Për këtë objekt punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale, pasi nuk është punar gjatë muajit janar për shkak të reshjeve atmosferike dhe temperaturave të ulta. Për këto arsye është kryer një amendament i kontratës me zgjatje të afatit me 3.5 muaj nga afati fillestar i kontratës referuar amendamentit të lidhur mes palëve me nr. 388/3 prot, datë 12.07.2024. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 25.10.2024 brenda afateve kontraktuale dhe amendamentit të sajë.
- Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar. Në dosjen tekniko-ligjore materialet e përdorura në objekt nuk janë të shoqëruar të gjitha me certifikata cilësie, skeda teknike dhe deklarata konformiteti, gjithashtu mungojnë testimet dhe provat laboratorike: si testimi i sistemit antizjarr, testimi i linjave elektrike dhe hidraulike nënpresion, testimi i sistemit të kondicionimit, procesverbali i tokëzimit etj. -Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:
- Në lidhje me zërat e punës me nr. analizë *"2.273/5- Veshje shkallëve të brendshme me pllaka mermeri t = 3cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 19.25 m², dhe zërin *"2.273/5-FV mermere pragje dritare t=3cm"*raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 80.90 m² dhe në vlerën totale 595,734 lekë pa TVSH sqarojmë se: Gjatë kontrollit në terren u konstatua se mermerët ishin vendosur me lartësi 2cm pra më të vegjël sesa përcaktimi i zërit në preventiv. Rrjedhimisht nëse bëjmë raportin 2cm/3cm=67% dhe nëse këtë përqindje e aplikojmë tek çmimi i këtyre zërave pra: 67%*5,948.42 lekë/m²=3,965.6 lekë/m², dhe këtë çmim të ri e aplikojmë tek sasitë e mësipërme (19.25m²+80.90m²)x3,965.6 lekë/m²=397,156 lekë. Për rrjedhim rezultuan diferenca në vlerën 595,734 lekë-397,156 lekë=**198,578 lekë pa TVSH, vlerë e cila konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"2.324/b-Plintuse grez importi, h=10 cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 845.52ml, sqarojmë se: Gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuset ishin vendosur me lartësi 8cm pra më të vegjël sesa përcaktimi i zërit në preventiv 10cm. Rrjedhimisht nëse bëjmë raportin 8cm/10cm=80% dhe nëse këtë përqindje e aplikojmë tek çmimi i këtij zëri pra: 80%*387.8 lekë/ml=310 lekë/ml, dhe këtë çmim të ri e aplikojmë tek sasia e mësipërme (845.52x310 lekë/ml=262,314.1 lekë pa TVSH. Për rrjedhim rezultuan diferenca në vlerën (327,893-262,314.1)=**65,579 lekë pa TVSH, vlerë e cila konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"2.206-Kasete shkarkimi me llamarinë xingat"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 11 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ulluqet ishin vendosur vertikal dhe horizontal gjatë perimetrit të çatisë, pra nuk ishin vendosur kaseta shkarkimi me llamarinë xingat. Për rrjedhim vlera e tyre prej **17,185 lekë pa TVSH, do të konsiderohet dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë*"An-Veshje fasade me polisterol jeshil t=7cm + rrjetë + suva"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 647 m², sqarojmë se: Gjatë inspektimit në terren rezultuan diferenca midis volumeve të deklaruara dhe atyre faktike në masën 26 m² më pak se sasia e raportuar. Këto diferenca rezultuan si pasojë e futjes në llogaritje të një objekti ekzistues ngjitur me njërën nga fasadat e shkollës. Për rrjedhim vlera e tyre prej **104,000 lekë pa TVSH, do të konsiderohet dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"An-F.V Rrethim me rrjetë metalike në formë rombi me fije çeliku 2.9mm e galvanizuar dhe e plastifikuar h=6m (për rrethimin e fushës anesor+mbyllje sipër)"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 542m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se një pjesë e rrjetës në 2m lartësi ishte kryer me rrethim me rrjetë metalike në formë rombi dhe një pjesë tjetër në 2m lartësi ishte kryer me rrjetë najloni. Duke analizuar dhe librezat e masave për këtë zë pune rezultuan diferenca në sasi prej 136 m², sasi e cila përbën vlerën **176,800 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërat e punës:
*Zërin "An-35-V. Pajisje e brendshme VRF FULL DC INVERTER, Modeli Mural, 18000 BTU/h, Kapaciteti termik - Ftohje - 5.6k Ẇ / Ngrohje - 6.3 kẆ, Fuqia elektrike Pmax-32 Ẇ, 1F~230V~50Hz, Sasia e ajrit: 690/840 m³/h, Dim - 320*998*238 mm, Pesha-15 kg, Niveli Zhurmes 35/41 db(A), Tubacionet - ϕ 6.35 / 12.7 mm, Kondensa ϕ 16 mm I kompletuar me të gjithë elemente e nevojshëm për montim, si dhe të gjithë aksesoret e nevojshëm. Perfshi termostatin mural me ekran display 4"* dhe zërin *"An-36-V. Pajisje e brendshme VRF FULL DC INVERTER, Modeli Mural, 24000 BTU/h, Kapaciteti termik - Ftohje - 7.1kẆ / Ngrohje - 8 kẆ, Fuqia elektrike Pmax-60 Ẇ, 1F~230V~50Hz, Sasia e ajrit: 730/1100 m³/h, Dim - 320*998*238 mm, Pesha-15 kg, Niveli Zhurmes 35/48 db(A), Tubacionet - ϕ 9.52/15.88 mm, Kondensa ϕ 16 mm I kompletuar me të gjithë elemente e nevojshëm për montim, si dhe të gjithë aksesoret e nevojshëm. Perfshi termostatin mural me ekran display 4";* sqarojmë se*:* Gjatë kontrollit në terren u konstatua se 8 njësi të brendshme kondicionimi ose (4 copë + 4 copë) pajisje të brendshme inverter për zërat e mësipërm kishin probleme me vendosjen e tyre pasi kishin rrjedhje uji. Kjo do të thotë që montimi i tyre nuk është kryer në mënyrë korrekte, rrjedhimisht vlera e montimit të tyre (26,000+26,000 lekë)=**52,000 lekë pa TVSH do të konsiderohet si punime të kryera jo sipas kushteve teknike dhe rrjedhimisht vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"An-11-Ndriçues led 60*60, 20Ẇat tualete dhe klase"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 286 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ndriçuesit ishin vendosur me përmasa më të vogla (25x25)cm. Pasi kryejmë llogaritjet midis raportit të përmasave të ndriçuesve 25cmx25cm/60cmx60cm=17%, dhe këtë % e aplikojmë tek çmimi i ndriçuesve, atëherë ky çmim kalon nga 3,000 lekë/copë në 520.83 lekë/copë; rrjedhimisht do të këtë një diferencë e cila llogaritet në vlerën **709,042 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"An-30- Central Për Sinjalizim Alarm Zjarri Intiligjent për 8X30 Sensore Aktive Komplet"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1 copë gjatë kontrollit në terren u konstatua se në dhomën teknike të IT, nuk ishte vendosur centrali i sinjalizimit të zjarrit i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën **145,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"An-57-4TB Video Server Storage"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1 copë gjatë kontrollit në terren u konstatua se nuk ishte vendosur në dhomë teknike të IT, "video server storage", i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën **45,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërat e punës: *"An-52- Kamera colour Type 1 IP fix P jashtëm komplet"* të raportuara në sasinë 4 copë dhe *zërin "An-53- Kamera IP Dome te Type 3 UẆDR"* të raportuar

në sasinë 6 copë gjatë kontrollit në terren u konstatua se edhe pse kamerat ishin montuar ato nuk ishin vënë në punë pra nuk ishin funksionale, rrjedhimisht vlera totale e tyre **254,000 lekë pa TVSH do të konsiderohet si punime joefektive dhe joeficiente pra në kundërshtim të parimit të 3E.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tepelenë në vlerën 1,513,183 lekë pa TVSH si dhe disa punime të tjera të kryera por të konsideruar si punime joefektive, joeficiente në kundërshtim të parimit të 3E në vlerën 254,000 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve B.O.E "A.M." sh.p.k & "I.D.A." sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk kanë zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar* dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".*

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë, Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran", Bashkia Tepelenë*** rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 3360/13 prot, datë 26.04.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit B.O.E "2." sh.p.k & "G." sh.p.k. Vlera e kontratës është 232,667,018.40 lekë me TVSH.
- Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 556/9 prot, datë 10.09.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Mbikëqyrësit OE "I." sh.p.k, sipas licencës për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2..6/2.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 809/2 prot, datë 20.07.2023, midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kolaudatorit Ing. F.S., me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3.4. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 08.08.2024, ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është mbajtur në datë 23.04.2024 për nënobjektin nr. 1 *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë"* dhe në datë 23.04.2024 për nënobjektin nr. 2 *"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran".* Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vihet re se në këtë kontratë të lidhur mes palëve mungon afati i kolaudimit të objektit; kjo gjë ka sjellë vonesa në hartimin e plotë të aktit të kolaudimit, pasi është kryer fillimisht një kolaudim i pjesshëm i nënobjektit nr. 1 dhe më pas kolaudimi përfundimtar i të dy objekteve. Vonesa në kolaudimin e objektit sjellë si pasojë mosvënien në kohë dhe në funksion të objektit si dhe rrjedhimisht amortizimin e tij. Gjithashtu caktimi Ing. F.S. si kolaudator pa proces prokurimi publik konsiderohet si veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 3, pika 2, sipas të cilës *"Autoritetet dhe Entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën"*.
Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me shkresën nr. 589/3, datë 24.09.2020 të Institutit të Ndërtimit për nënobjektin nr. 1*"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë"* dhe me shkresën nr. 588/3, datë 24.09.2020 për nënobjektin nr. 2 "*Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran".*
- Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA rezultoi se:
Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 13.09.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 13.09.2021. Për këtë kontratë punimet

nuk kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale pasi janë kryer disa pezullime të përkohshme të punimeve.
- Në nënobjektin nr. 1 *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë"* konstatohet se në datë 04.03.2022 është bërë një kërkesë për pezullimin të përkohshëm të punimeve pasi nuk lejohet prishja e depos së vjetër ekzistuese të fshatit për arsye të furnizimit me ujë gjatë periudhës së ndërtimit të depos së re duke mos lejuar zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve. Për këto arsye është mbajtur një procesverbal midis palëve Kontraktor, Mbikëqyrës, AK. Në datë 15.03.2022 është bërë kërkesë për rifillim punimesh në nënobjektin nr. 1"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë" pasi palët dakortësuan mbi pozicionimi e ri të depos së re. Për këto arsye është mbajtur një procesverbal për rifillimin e punimeve midis palëve Kontraktor, Mbikqyrës, AK.
- Në nënobjektin nr. 2 *"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"* kanë ndodhur disa pezullime dhe rifillime punimesh, me shkresën me datë 15.10.2021 është bërë një kërkesë për pezullim punimesh nga kontraktori pasi banorët e fshatit Mezhgoran kanë penguar punimet e realizimit të linjës së furnizimit me ujë të ujësjellësit si dhe për shkak të moszbardhjes së lejes së ndërtimit. Me shkresën me nr 121 prot, në datë 18.01.2022 është bërë një kërkesë tjetër për pezullim punimesh pasi kontraktori ka hasur pengesë nga banorët e zonës të cilët nuk lejojnë vazhdimin normal të punimeve me pretendimet se linja e dërgimit kalon në prona private. Në datë 08.02.2023 është kryer një njoftim për rifillimin e punimeve në objekt. Në datë 20.02.2023 është kryer një tjetër pezullim punimesh për shkak të rezistencës së banorëve të fshatit Mezhgoran të cilët kanë penguar punimet si dhe për shkak të marrjes së lejes nga Agjencia e Mjedisit për kalimin e tubacionit të dërgimit në urën e Mezhgoranit. Në datë 22.02.2024 është kryer njoftimi për rifillimin e punimeve në objekt.
- Në lidhje me nënobjektin nr. 2 *"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"* në projektin e rishikuar mungojnë të dhënat teknike të volumeve gërmim/mbushje për çdo prerje tërthore të linjës së dërgimit gjithashtu vija e tokës dhe vija e gërmimit në prerjet tërthore janë në të njëjtat kuota etj. Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, në dosje u gjetën testimet laboratorike vetëm për betonet, hekurin dhe stabilizantin, mungojnë testimet dhe provat nënpresion për linjat e ujësjellësit edhe pse aktualisht ai nuk është vënë në punë, gjithashtu mungojnë testet e rërës, çakëllit, skedat teknike të materialeve tubat e çelikut etj. Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar.
- Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* dhe udhëzimet nr. 1 datë 16.06.2011, dhe nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar*, pasi ato nuk janë të sqaruara analitikisht, përmbajnë gabime dhe nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.
Përfundimi i punimeve për nënobjekti nr. 1 është kryer në datë 30.04.2022 dhe për nënobjektin nr. 2 më datë 08.08.2024.
- Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:
Në lidhje me nënobjektin nr. 1"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë,*
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Ndërtimi i kaptazhit të burimit" me nr. analizë *"Anal R–1-Transport materiale ndërtim, dheu me auto deri 15 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 133.86 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi nuk është kryer zbritja e volumeve të mbushjes 19.m³ nga volumi total i gërmimeve 133.86 m³. Rrjedhimisht kjo sasi 19.41m³ përbën vlerën **13,300 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Punime Ndërtimi " për ndërtimin e depos së re 200 m³" me nr. analizë *"Anal. R.2-Transport betoni me autobetonjere 35 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 138.74 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjet e këtij zëri pune janë përfshirë në mënyrë të gabuar sasia e zërit *"2.136/1Mure b/a për rezervuare rrethore h ~ 4m, C16/20, t = 21 ~ 30 cm"* 66.94 m³ zë i cili e ka të përfshirë në çmim transportin e betonit. **Rrjedhimisht vlera e këtyre punimeve 267,760 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Punime Ndërtimi " për ndërtimin e depos së re 200 m³" me nr. analizë *"Anal_R – 21-Suva me sika"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 285.19 m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë nuk ishte kryer në gjithë muret e depos në sasinë 46.33 m². Rrjedhimisht kjo sasi llogaritet në **vlerën 160,308.03 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Në lidhje me nënobjektin nr. 2"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"* u konstatuan disa mbivendosje zërash në lidhje me punimet për hapjen e trasesë së aksesit për linjën e dërgimit me zërat e punës për realizimin e seksionit tërthorë të linjës së dërgimit.
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Linja e Dërgimit" me nr. analizë *"3.89/a-Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 3,950 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjen e këtij zëri është përfshirë në mënyrë të gabuar sasia prej (395x0.6x0.6)= 142.1 m³. Kjo pasi në librezat e masave është cilësuar rrugë e re për ndërtimin e linjës së ujësjellësit (km 4+100-km 4+495), por kjo sasi është e mbivendosur me sasinë e gërmimeve për hapjen e trasesë së linjës së ujësjellësit. Pra vlera e këtyre punimeve **56,840 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Linja e Dërgimit" me nr. analizë *"Anal_R – 1-Transport materiale ndërtim, dheu me auto deri 15 km".* Si rrjedhim i llogaritjeve të mësipërme në sasinë totale të transportit 8,375 m³ pasi kryejmë zbritjen e volumeve të gërmimit 142.13m³, kjo sasi duhet të zbritet edhe në llogaritjet e volumeve të transportit në vlerën (142.2 m³x 700 lekë/m³)= **99,491 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Linja e Dërgimit" me nr. analizë "*3.352-Mbushje ngjeshje gurë kave"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1,950 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjen e këtij zëri është përfshirë në mënyrë të gabuar sasia prej (395x0.6x0.4)= 94.8 m³. Kjo pasi në librezat e masave është cilësuar rrugë e re për ndërtimin e linjës së ujësjellësit (km 4+100-km 4+495), por kjo sasi është e mbivendosur me sasinë e mbushjeve të seksionit tërthor të linjës. Rrjedhimisht vlera e këtyre punimeve **170,640 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Linja e Dërgimit" me nr. analizë "*2.15-Mbushje ngjeshje me material te gërmuar"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 85 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjen e këtij zëri nuk sqarohet se për çfarë është përdorur dhe ku është përdorur kjo sasi mbushje në cilat progresiva të linjës së dërgimit. Rrjedhimisht vlera e këtyre punimeve **51,000 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin"Linja e Dërgimit" me nr. analizë *"Anal_R – 1-Transport materiale ndërtim, dheu me auto deri 15 km"* Si rrjedhim i llogaritjeve të mësipërme në sasinë totale të transportit 8,375 m³ pasi kryejmë zbritjen e volumeve të mbushjeve (94.8+85=179.8)m³, kjo sasi duhet të zbritet edhe në llogaritjet e volumeve të transportit në

vlerën (179.8 m³x 700 lekë/m³)= **125,860 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Punime Ndërtimi në Depo 50 m³" me nr. analizë *"Anal_R – 2-Transport betoni me autobetonjere 35.0 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 65m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjet e këtij zëri pune janë përfshirë në mënyrë të gabuar sasitë e zërave *"2.262/3-Shtrese betoni M.150 te ndryshme", "2.133/1-Mur beton arme M.250", "2.133/1-Beton M.250 themel + dysheme", "2.122/1a-Soleta b/a C20/25"* zëra të cilët e kanë të përfshirë në çmim transportin e betonit. **Rrjedhimisht vlera e këtyre punimeve 259,920 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin "Punime rrugë për hyrjen në kaptazh³" me nr. analizë *"Anal_R – 2-Transport betoni me autobetonjere 35.0 km"*raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 448m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjet e këtij zëri pune nuk është kryer zbritja nga volumi gërmimeve i sasisë së mbushjeve zëri *"2.19-Mbushje ngjeshje me material te gërmuar"* në sasinë 88m³, vlera e këtij volumi në transport llogaritet **61,600 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës në kapitullin"Linja e Dërgimit" me nr. analizë *"2.130/1a-Beton M-200 për mbështetëse te tubacionit te Çelikut"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 16.6m³, gjatë kontrollit të dosjes teknike dokumentacionit fotografik nuk rezulton të jetë kryer si proces pune. Gjithashtu për shkak të thellësisë së gërmimit të raportuar për instalimin e tubacionit të dërgimit 1.55m dhe diametrit të tubit 57mm, këto betone për mbështetjen e tubacionit të çelikut janë të panevojshme pasi nuk krijohen presione të atilla që të mund të zhvendosin këtë tubacion. **Rrjedhimisht vlera e këtyre punimeve 190,900 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me nënobjektin e dytë *"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"* sqarojmë se gjatë zbatimit të punimeve Kontraktori ka hasur vështirësi në realizimin e marrjes së ujit nga burimi në fshatin Mezhgoran ku ka ndodhur dhe përballje dhe kundërshti me banorët e zonës. Për këtë shkak është kryer rishikim i projektit fillestar dhe ndryshim në projektin e zbatimit duke kryer vetëm linjën kryesore nga burimi tek Depo 50m³ si dhe linjën për tek Stacioni i pompimit. Mosrealizimi i marrjes së ujit aktualisht ka sjellë si pasojë mosvënien në funksion të gjithë veprës duke e lënë ndërtimin e kaptazhit dhe linjave shpërndarëse për një "Fazë të Dytë". Aktualisht ky ujësjellës nuk është funksional. Vlera e punimeve për këtë nënobjekt mund të konsiderohet si vlerë e shpërdoruar në kundërshtim të parimeve ekonomike 3E: shpenzim pa ekonomicitet, pa efektivitet, pa efikasitet në vlerën totale prej **63,989,574.84 lekë pa TVSH.**
- Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tepelenë në vlerën **1,457,619 lekë pa TVSH;** nga të cilat për nënobjektin nr. 1 *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë"* **441,368.24 lekë pa TVSH** dhe për nënobjektin nr. 2 "*Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"* **1,016,251 lekë pa TVSH,** për këtë nënobjekt nr. 2 vlera e tij mund të konsiderohet si vlerë e shpërdoruar në kundërshtim të parimeve të 3E, ekonomicitet, efektivitet, efikasitet në **vlerën 63,989,574.84 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "I." sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Ndërtimi i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë"*** ku rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 207/6 prot, datë 14.04.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit OE "2." sh.p.k. Vlera e kontratës është 33,879,243.24 lekë me TVSH.
Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 207/4 prot, datë 18.03.2021, midis AK Bashkia Tepelenë dhe Mbikëqyrësit Mbikëqyrësit B.O.E "G.C." sh.p.k & "A." sh.p.k, sipas licencave respektive për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.2..8/17 dhe MK.2..2/8. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 1433/1 prot, datë 04.09.2023, midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kolaudatorit inxhinier F.S me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3..4. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 04.09.2023 ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është mbajtur në datë 03.05.2024. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vihet re se në këtë kontratë të lidhur mes palëve mungon afati i kolaudimit të objektit; kjo gjë ka sjellë vonesa në hartimin e plotë të aktit të kolaudimit, pasi në objekt është kryer fillimisht një kolaudim i pjesshëm dhe më pas kolaudimi përfundimtar. Vonesa në kolaudimin e objektit sjellë si pasojë mosvënien në kohë dhe në funksion të objektit dhe rrjedhimisht amortizimin e tijë. Gjithashtu caktimi i inxhinier F.S si kolaudator pa proces prokurimi konsiderohet si veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 3, pika 2, sipas të cilës "*Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën*"
Dorëzimi i sheshit të ndërtimit është kryer më datë 19.11.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 19.11.2021 por janë protokolluar me anë të shkresës me nr. 2245 prot, datë 19.12.2021 pra një muaj më vonë. Për këtë kontratë punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale pasi janë kryer dy pezullime të përkohshëm të punimeve, konkretisht: Me anë të shkresës me nr. 100 prot, datë 17.01.2022 është bërë një kërkesë për pezullim punimesh për shkak të temperaturave shumë të ulëta në terren dhe kushteve të vështira atmosferike duke ndikuar në lëvizjen e mjeteve dhe makinerive si dhe rreziku i dëmtimeve në linjat e tubacioneve. Me anë të shkresës me nr. 506 prot, datë 04.03.2022 është kryer njoftimi i rifillimit të punimeve në objekt. Pezullimi tjetër ka ndodhur me anë të shkresës me nr. 772 prot, datë 18.04.2022, ku është kryer një pezullim i përkohshëm i punimeve pasi kërkohet të lirohet sheshi në zonën ku do të kryheshin punimet për realizimin e kaptazhit nr. 1, stacionit të pompimit dhe depos grumbulluese pasi nuk lejohet hyrja në objekt si për shkat të pretendimeve mbi pronë private. Me anë të shkresës me datë 11.09.2023 është kryer njoftimi i rifillimit të punimeve në objekt. Megjithatë për periudhën në të cilën punimet e mësipërme kanë qenë të pezulluara dalja përtej afateve kontraktuale nuk është materializuar me anë të akti juridik siç është amendamenti i kontratës nga ana e Bashkisë Tepelenë dhe Kontraktorit të punimeve. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer në datë 23.10.2023.
Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike për objektin e mësipërm, kundërshtim të Ligjit Nr. 3/2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6,* si dhe VKM nr. 9/2024 *"Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste".*
Në lidhje me objektin e mësipërm në datën 17.02.2022 është dërguar për miratim urdhër ndryshimi me shkresën me nr. 1924 prot, datë 20.09.2023 dhe shoqëruar me një relacion mbi ndryshimet e propozuara si dhe është mbajtur një procesverbal për miratimin e volumeve që hiqen dhe shtohen. Për këto ndryshime është mbajtur procesverbal midis palëve titullari AK,

Kontraktorit dhe Mbikqyrësit të punimeve, por projekti i ripunuar dhe projekti sipas urdhër ndryshimit nuk janë të firmosur nga titullari AK, Kontraktorit dhe Mbikqyrësit. Në dosjen teknike janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, gjithashtu janë kryer testimet, teste betonit dhe provat nën ngarkesë të linjave. Mungojnë analizat bakterologjike të cilësisë së ujit.

-Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:

- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"2.195-Hidroizolim me bitum"* në kapitullin *Vepra E Marrjes (Kaptazhet) r*aportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 264.54m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer. Vlera e tij prej **211,632 lekë pa TVSH, do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"2.197Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama"* në kapitullin Puseta grumbulluese, raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 169.20m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer. Vlera e tij prej **126,130 lekë pa TVSH, do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë *"An-EL-022-Analizator klori i portativ i shoqëruar me kampionet"* ne kapitullin F - Makineri Dhe Pajisje + Paisjet e Sigurimit Teknik, raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se rrethimi nuk ishte kryer me tel me gjemba. Vlera e tij prej **250,656 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërat e punës në kapitujt "*Pajisje elektrike + 3. Pajisje mbrojtëse kundra klorit"* raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën totale (75,274+50,752)lekë pa TVSH, gjatë kontrollit në terren u konstatua se këto zëra nuk ishin kryer. Vlera totale e tyre prej **126,026 lekë pa TVSH, do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tepelenë në vlerën 714,444 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve B.O.E "G.C." sh.p.k &"A." sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit",* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".*

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.3 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2.3.1. Auditim mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

2.3.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni në sistemin *"e-lejet"*;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Tepelenë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT) nr. 52, datë 24.12.2024, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Për periudhën 01.01.2023 deri në miratimin e PPV, lejet e ndërtimit janë miratuar në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Vendimit nr. 1, datë 30.07.2015 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore"*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 5, datë 09.12.2014 *"Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hartimi i hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban"*, i ndryshuar.
Auditimi konsiston në këto fusha:
- Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi, zbatimi i treguesve parametrikë;
- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
- Dhënia e certifikatës së përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023 - 31.12.2025:

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Tepelenë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2025**, ka pasur **176** aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, sipas tipologjive të lejeve të aplikuara:

Tabela nr. 42: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	21	8	13
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	14	4	10
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	6	3	3
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m^2	3	0	3
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	1	1	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	3	2	1
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	62	43	19
Leje rind, rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndrysh. funk.	0	0	0
Certifikatë përdorimi	4	3	1
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	1	1
Leje për ndryshim funksioni	13	8	5
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	12	7	5
Njoftim fillim punimesh	18	8	10
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	6	3	3
Leje infrastrukturë	11	6	5

Burimi: *DPKZHT, Bashkia Tepelenë* ***Përpunoi:*** *Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPKZHT) e Bashkisë Tepelenë, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në tabelën nr. 42 si mëposhtme:

Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2

Nr.	Objekti	Nr. vendimi	Data	Zhvilluesi
1	Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural	AR-LNM110123/3	13.01.2023	"A.R." sh.p.k
	Adresa: *Fshati Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, Bashkia Tepelenë*			
2	Strukturë akomodimi agroturistike 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë	RDR-LNM160424/3	16.05.2024	"D.R.R." sh.p.k
	Adresa: *Fshati Hormovë, Nj. Adm. Qendër Tepelenë*			
3	Resort Agroturistik, Peshtan	Z-LNM010421/5	22.10.2024	"Z." sh.p.k
	Adresa: *Fshati Peshtan, Nj. Adm. Qendër Tepelenë*			
4	Shtesë anësore 2 kat e objektit ekzistues hotel dhe shërbime 3 kat	EM-LN270225/4	25.04.2025	E.M
	Adresa: *Pasuria nr. 8/144, ZK 3574, Nj. Adm. Tepelenë*			

Certifikata përdorimi				
Nr.	**Objekti**	**Nr. vendimi**	**Data**	**Zhvilluesi**
5	Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural	AR-CP211223/4	04.04.2024	"A.R." sh.p.k
	Adresa: *Fshati Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, pasuria nr. 1/7, ZK nr. 3177*			
6	Rikonstruksion dhe shtesë kati	AM-CP190623/5	24.07.2023	A.M.
	Adresa: *Rruga "Bilbilenjtë", Tepelenë*			
7	Ngritje një kat shtesë banese	LÇ-CP130325/4	20.03.2025	L.Ç
	Adresa: *Nj. Adm. Tepelenë, pasuria nr. 6/63, ZK nr. 3574*			

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, janë konstatuar problematikat si më poshtë:

Shënim: Numrat rendor të rasteve të mëposhtme, përputhen me numrat rendor në tabelën e mësipërme:

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit, është konstatuar se në të gjitha rastet (shtatë raste), dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. AR-LNM110123/3, datë 13.01.2023, për objektin ***"Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural"***, me adresë në fshatin Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, me zhvillues "A.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: **i.** Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e elementëve arkitektonik dhe konstruktivë të strukturës për objektet "Shtëpiza" dhe "Kotec"; **ii.** Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë: Skemat elektrike të bokseve të matjeve; Instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; Detajet e montimit të sistemit rrufe-prites; Detajet e instalimeve elektrike; **iii.** Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit elektrik; **iv.** Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit të mbrojtjes nga zjarri; **v.** Mungon projekti i auditimit të efiçencës së energjisë, ose së paku deklaratë nga audituesi i licencuar i efiçencës së energjisë, ku të shprehet se kjo tipologji është e përjashtuar nga detyrimi i hartimit të këtij projekti; **vi.** Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, për objektin ***"Strukturë akomodimi agroturistike 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë"***, me adresë në fshatin Hormovë, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "D.R.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: **i.** Mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesve, vërtetim i NIPT-it); **ii.** Mungon licenca individuale profesionale e hartuesit të projektit të mbrojtjes nga zjarri; **iii.** Projekti

hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungon lidhja me rrjetin e qytetit, si për furnizimin me ujë, ashtu dhe për shkarkimin e ujërave të ndotura; **iv.** Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë: Skemat elektrike të bokseve të matjeve; Instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; Detajet e montimit të sistemit rrufe-prites; Detajet e instalimeve elektrike; **v.** Policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit elektrik është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (16.04.2024). Vlefshmëria e policës është për periudhën 01.09.2022 – 31.08.2023; **vi.** Policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit të efiçencës së energjisë është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (16.04.2024). Vlefshmëria e policës është për periudhën 15.07.2022 – 14.07.2023; **vii.** Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me adresë në fshatin Peshtan, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: **i.** Dokumentet e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Shtatë nga njëmbëdhjetë (23; 34; 27; 24; 25; 26/1; 26/2) nga pasuritë që marrin pjesë në zhvillim nuk gëzojnë dokumentacionin përfundimtar të pronësisë, por janë të pajisura me: "Certifikatë për vërtetim titulli "Në përdorim" apo "Certifikatë regjistrimi "Përdorimi". Në dy raste (23; 25; 34), dokumentet e pronësisë nuk janë të rifreskuar përgjatë tre muajve të fundit; **ii.** Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë dy prej fasadave teknike të objektit "Kantinë"; **iii.** Projekti mekanik i ngrohje / ftohje / ventilimit, projekti i mbrojtjes nga zjarri, projekti hidrosanitar dhe projekti elektrik nuk janë të plotë, pasi mungojnë pjesët respektive të këtyre projekteve për objektin "Kantinë"; **iv.** Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungon lidhja me rrjetin e qytetit për furnizimin me ujë; **v.** Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë: instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; detajet e montimit të sistemit rrufe-prites; detajet e instalimeve elektrike; për objektin "Hoteli i vogël"; **vi.** Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit elektrik është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (12.10.2024). Vlefshmëria e policës është për periudhën 28.08.2023 – 27.08.2024. Gjithashtu, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efiçencës së energjisë është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (24.06.2020 – 23.06.2021); **vii.** Vendimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i përket objekteve të miratuar në lejen e parë të ndërtimit, pasi është miratuar me Vendim nr. 33, datë 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM. Duke qenë se zhvilluesi ka kërkuar ndryshimin e projektit, DPKZHT Bashkia Tepelenë do të duhej të kishte kërkuar marrjen e miratimit nga AKM për objektin e ri të propozuar; **viii.** Raporti i auditimit të efiçencës së energjisë i përket objekteve të miratuar në lejen e parë të ndërtimit. Zhvilluesi / projektuesi / aplikanti nuk kanë paraqitur një raport të ri për këto objekte, referuar ndryshimeve që janë kërkuar; **ix.** Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. EM-LN270225/4, datë 25.04.2025, për objektin ***"Shtesë anësore 2 kat e objektit ekzistues hotel dhe shërbime 3 kat"***, me adresë në pasurinë nr. 8/144, ZK 3574, Nj. Adm. Tepelenë, me zhvillues "E.M." P. F., me problematika si më poshtë vijon: **i.** Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon plani i piketimit të strukturës dhe plani i organizimit të punimeve; **ii.** Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë: instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; detajet e montimit të sistemit rrufe-prites; detajet e instalimeve elektrike; skema elektrike e boksit të matjeve; **iii.**

Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

5. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AR-CP211223/4, datë 04.04.2024, për objektin ***"Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural"***, me adresë në fshatin Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, me zhvillues "A.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: **i.** Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 71 ditësh pune; **ii.** Mungon procesverbali nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, i cili vërteton se objekti është marrë në dorëzim; **iii.** Mungon planvendosja e miratuar; **iv.** Fotot e ngarkuara paraqesin vetëm objektet e drurit në funksion të hotelerisë / akomodimit, ndërkohë që nuk ka asnjë evidencë për ndërtimin e objektit me funksion "Bar & Restorant", "Kotec" apo serrë; **v.** Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve; **vi.** Dy prej akteve të kontrollit janë mbajtur në mungesë të përfaqësuesve të pushtetit vendor. Aktet e kontrollit *"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"* dhe *"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese (akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit)"* detyrimisht duhet të verifikohen dhe konfirmohen nga autoriteti vendor. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk provohet se këto akte janë verifikuar dhe kontrolluar nga autoriteti vendor.

6. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AM-CP190623/5, datë 24.07.2023, për objektin ***"Rikonstruksion dhe shtesë kati"***, me adresë në rrugën "Bilbilenjtë", Tepelenë, me zhvillues "A.M." P. F., me problematika si më poshtë vijon: **i.** Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtimet e objektit; **ii.** Mungon projekti as-built.

7. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. LÇ-CP130325/4, datë 20.03.2025, për objektin ***"Ngritje një kat shtesë banese"***, me adresë në Nj. Adm. Tepelenë, pasuria nr. 6/63, ZK nr. 3574, me zhvillues "L.Ç." P. F., me problematika si më poshtë vijon: **i.** Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtimet e objektit; **ii.** Mungon projekti as-built; **iii.** Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, bashkë me licencat.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:
- Ligjin nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, neni 39, pika 5; neni 44, pika 2;
- Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 *"Për noterinë"*, i ndryshuar, neni 54;
- VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii), iv), v); neni 27; neni 27/1, pika 3; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), f), g), j), k), l);
- VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi"*;
- Ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, Shtojca II.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. T.P.,** me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë, aktualisht i larguar (*për rastet 1, 2, 3, 5, 6*);
- **Z. L.B.,** me funksion drejtor i DPKZHT, aktualisht i larguar (*për rastet 1 - 7*);
- **Znj. J.K.,** me funksion juriste pranë DPKZHT (*për rastet 1 - 7*).

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në asnjë nga katër aplikimet e miratuara, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Ky mendim është kërkuar gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. Ky veprim nuk është në përputhje me dispozitat nënligjore të sipërcituara, pasi gjatë aplikimit për pajisje me leje zhvillimi nuk është i detyrueshëm hartimi / ngarkimi në sistem i të gjithë projektit ndërtimor (por vetëm i projekt – idesë arkitektonike). Si rrjedhim, autoritete si Policia e Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit, Drejtoria Rajonale e Ujësjellës – Kanalizimeve, Operatori për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike apo Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk mund të shprehen dot mbi përputhshmërinë e projektit, apo mbi sigurimin e infrastrukturës kryesore në parcelë. Gjithësesi, edhe pse në këto kushte, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim mendim-marrjen gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. AR-LNM110123/3, datë 13.01.2023, për objektin ***"Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural"***, me adresë në fshatin Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, me zhvillues "A.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:
- DPKZHT është mjaftuar me miratimin në heshtje nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, edhe pse informacioni që mundëson kjo drejtori nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive;
- Nuk është respektuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila, nëpërmjet shkresës me nr. 2376 prot, datë 06.06.2022, shprehet se: *"KKT në mbledhjen e datës 22.02.2017, ka marrë Vendimin Nr. 11* ***"Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e PPV",*** *ku përcaktohet se pas pikës 3 shtohet pika 3/1: Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohet të japin leje ndërtimi, edhe nëse strukturat ndodhen jashtë zonave të urbanizuara dhe statusi aktual i pronës nuk është "truall", me kusht që konvertimi në resurs tokë "truall", të kryhet para miratimit të lejes së ndërtimit, sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, vetëm për disa nga rastet përjashtimore të parashikuara në pikën 2 të këtij Vendimi:* ***... e. strukturave të agroturizmit, sipas gërmës "h"***. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se resursi i kësaj parcele nuk është konvertuar nga "Arë" në "Truall".

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, për objektin ***"Strukturë akomodimi agroturistike 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë"***, me adresë në fshatin Hormovë, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "D.R.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit është shprehur se duhet të merret mendimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe mendimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, duke qenë se projekti ndodhet në kufi të zonës së mbrojtur të lumit Vjosa (Park Kombëtar, shpallur me Vendimin nr. 155, datë 13.03.2023 të Këshillit të Ministrave), si dhe të merret mendimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, nisur nga fakti që aksesi bëhet nga rruga Tepelenë – Gjirokastër. DPKZHT ka kërkuar mendimin e MTM, AKZM dhe ARRSH vetëm gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. MTM nuk ka kthyer përgjigje, duke e

miratuar kërkesën në heshtje. AKZM ka dhënë dakordësinë. ARRSH nuk e ka miratuar kërkesën, duke e shprehur se: "ARRSH nuk jep miratimin pasi subjekti duhet të aplikojë në sistemin *e-albania* për Hyrje – Dalje nga aksi rrugor". Si përfundim, DPKZHT nuk ka respektuar mendimin e AZHT, duke qenë se ka pasur mundësinë për të kërkuar mendimin e këtyre autoriteteve në aplikimin për pajisje me leje ndërtimi, si dhe nuk ka respektuar mendimin e ARRSH, duke vijuar me miratimin e lejes së ndërtimit.
- Agjencia e Efiçencës së Energjisë, në kthim – përgjigjen e parë (në lejen e zhvillimit) është shprehur: "Agjencia për Efiçencën e Energjisë ju informon se për fazën e aplikimit për leje zhvillimi, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 124/2015 *"Për Efiçencën e Energjisë"* dhe Ligjit nr. 116/2016 *"Për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa"*. Duke qenë se në aplikimin për pajisje me leje zhvillimi nuk ka një projekt për efiçencën e energjisë (pasi nuk kërkohet në këtë fazë), kërkesa e mendimit të AEE nuk ka vlerë, pasi kjo e fundit nuk ka një projekt mbi të cilin të shprehet. Gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi nuk është kërkuar mendimi i AEE;
- OSHEE, PMNZSH dhe UK kanë miratuar në heshtje për të njëjtat arsye si më lart. DPKZHT duhet të kishte kërkuar mendim – marrjen e këtyre autoriteteve gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi.

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me adresë në fshatin Peshtan, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk është kërkuar mendimi i Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), për të marrë prej sa konfirmimin se projektuesi i ka reflektuar ndryshimet / rekomandimet e sugjeruara nga ky autoritet në oponencën teknike. Gjithashtu, nuk janë reflektuar sugjerimet e UPT në lidhje me konstruksionin e objekteve, si: *"Nuk jepen detaje të zonave me disnivele të pllakës së themelit. Të paraqitet ky detaj; Rekomandohet të jepen detaje apo shënime për largimin e ujit gjatë hapjes së gropës së themeleve; sidomos pranë objekteve të tjerë fqinjë apo rrugëve kufitare"*;
- Agjencia e Efiçencës së Energjisë, në kthim – përgjigjen e parë (në lejen e zhvillimit) është shprehur: "Agjencia për Efiçencën e Energjisë ju informon se për fazën e aplikimit për leje zhvillimi, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 124/2015 *"Për Efiçencën e Energjisë"* dhe Ligjit nr. 116/2016 *"Për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa"*. Duke qenë se në aplikimin për pajisje me leje zhvillimi nuk ka një projekt për efiçencën e energjisë (pasi nuk kërkohet në këtë fazë), kërkesa e mendimit të AEE nuk ka vlerë, pasi kjo e fundit nuk ka një projekt mbi të cilin të shprehet. Gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi nuk është kërkuar mendimi i AEE.

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. EM-LN270225/4, datë 25.04.2025, për objektin ***"Shtesë anësore 2 kat e objektit ekzistues hotel dhe shërbime 3 kat"***, me adresë në pasurinë nr. 8/144, ZK 3574, Nj. Adm. Tepelenë, me zhvillues "E.M." P.F., me problematika si më poshtë vijon:
- DPKZHT është mjaftuar me miratimin në heshtje nga DV ASHK Tepelenë, edhe pse në dispozitat ligjore citohet se informacioni që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e kërkesës aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. T.P., me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë, aktualisht i larguar (*për rastet 1- 3)*;
- Z. L.B., me funksion drejtor i DPKZHT, aktualisht i larguar (*për rastet 1 - 4*);

- Znj. J.K., me funksion juriste pranë DPKZHT (*për rastet 1 - 4*).

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për katin përdhe me përdorim shërbim dhe distancat nga kufiri i pronës. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, për objektin ***"Strukturë akomodimi agroturistike 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë"***, me adresë në fshatin Hormovë, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "D.R.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë minimale të lejuar të katit me funksion "shërbim". Lartësia faktike e katit 0 (dysheme - dysheme) është 3.4 metra. Lartësia minimale e lejuar, sipas përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 3, nënpika c) është 4 metra.
- Objekti i miratuar nuk respekton distancat nga kufiri i pronës. Referuar nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: *"Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në PPV... për distancat objekt-kufi pronë, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m"*. Duke qenë se nuk kemi të bëjmë me asnjë prej rasteve përjashtimore të cituar në këtë nën, atëherë distancat që objekti do të duhej të respektonte nga kufiri i pronës është 3 metra. Distancat faktike variojnë nga 0 metra – 0.8 metra. Në këtë aplikim është ngarkuar një akt – marrëveshje midis Bashkisë Tepelenë (përfaqësuar nga Kryetari, z. T.P.) dhe z. N.S. (pronar i parcelës në zhvillim), nr. 928 prot, datë 02.05.2023, ku Bashkia Tepelenë pranon distancat e propozuara nga zhvilluesi. Ky dokument është në mospërputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pasi vendim-marrja për mosrespektimin e distancave urbane nuk është në tagrin e Bashkisë Tepelenë.

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me adresë në fshatin Peshtan, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë minimale të lejuar të katit me funksion "shërbim". Lartësia faktike e katit 0 (dysheme - dysheme) është 3.7 metra. Lartësia minimale e lejuar, sipas përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 3, nënpika c) është 4 metra.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. T.P., me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë, aktualisht i larguar (*për rastet 2, 3)*;
- Z. L.B., me funksion drejtor i DPKZHT, aktualisht i larguar (*për rastet 2, 3*);
- Znj. J.K., me funksion juriste pranë DPKZHT (*për rastet 2, 3*).

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, në tre raste janë konstatuar problematika në lidhje me zhvillimin e objekteve në përputhje me projektet e miratuara. Në një rast zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me adresë në fshatin Peshtan, Nj. Adm. Qendër Tepelenë, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:

Zhvilluesi ka reflektuar ndryshimin e projektit përpara marrjes së miratimit nga Bashkia Tepelenë. Leja (e dytë) e ndërtimit është miratuar në datë 22.10.2024. Nëse i referohemi fotografimit satelitor të datës 09.07.2024, konstatohet se zhvillimi i objektit "Hoteli i madh" është kryer sipas projektit të ri dhe jo sipas projektit të vjetër.




Fig. 1: *Projekti i parë i miratuar 02.12.2020*



Fig. 2: *Fotografimi satelitor 09.07.2024*





Fig. 3: *Projekti i dytë i miratuar 22.10.2024*

Nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë nuk janë kryer inspektime, ose këto konstatime nuk janë reflektuar në procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, pika 1 dhe 2.

5. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AR-CP211223/4, datë 04.04.2024, për objektin ***"Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural"***, me adresë në fshatin Rexhinë, Nj. Adm. Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, me zhvillues "A.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: Objekti i zbatuar ka ndryshime nga objekti i miratuar. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, si dhe nga inspektimi në terren, konstatohet se ka ndryshime nga projekti i miratuar. Këto ndryshime kanë të bëjnë me realizimin e një kati pjesërisht nëntokë, i pozicionuar nënobjektin e miratuar me funksion "Bar & Restorant". Gjithashtu, është ndërtuar një strukturë në pjesën jugore të objektit me funksion "Bar & Restorant", e cila nuk ka qenë e parashikuar në lejen e ndërtimit të miratuar.





Gjithashtu, nuk është ndërtuar "Serra" dhe "Koteci". Nga ana e IMTV nuk janë marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe evidentimin e këtij konstatimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, pika 1, 2, 3. Si rrjedhim, IMTV nuk ka marrë masa për mbikëqyrësin, kolaudatorin dhe zbatuesin e punimeve, veprimet e të cilëve janë në kundërshtim me nenin 7, 8, 12 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, si dhe janë të dënueshme sipas nenit 15, pika 1, 2, 3, 4, 5 të këtij ligji, si dhe nenit 52 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika gj), si dhe pika 5. Vlen të theksohet se zhvilluesi ka aplikuar në sistemin elektronik të lejeve për t'u pajisur me leje ndërtimi për shtesën nënobjektin ekzistues, me aplikimin nr. AN230220260127, edhe pse ndërtimi që kërkohet të miratohet, faktikisht është ndërtuar. Ky aplikim është ende në fazë shqyrtimi (deri në ditën e hartimit të këtij akt-konstatimi).

6. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AM-CP190623/5, datë 24.07.2023, për objektin ***"Rikonstruksion dhe shtesë kati"***, me adresë në rrugën "Bilbilenjtë", Tepelenë, me zhvillues "A.M." P. F., me problematika si më poshtë vijon:
Zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Referuar lejes së ndërtimit dhe ndryshimeve të mëvonshme të kërkuara nga zhvilluesi dhe të miratuara nga Bashkia Tepelenë, afati për përfundimin e punimeve ka qenë data 07.10.2022. Referuar deklaratës së përputhshmërisë së subjektit ndërtues ("I." sh.p.k), data e përfundimit të punimeve ka qenë 21.02.2023, pra me një diferencë kohore më shumë se katër muaj. Në dokumentacionin në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar ndonjë dokument që të vërtetojë kryerjen e inspektimeve nga ana e IMTV / nxjerrjen e vendimit për dënim me masë administrative gjobë / pagesën e kësaj mase administrative. Nga IMTV nuk janë kryer inspektime me qëllim verifikimin e vlefshmërisë së afatit të lejes së ndërtimit. Shkelja e afatit të përfundimit të punimeve është kundërvajtje administrative, e dënueshme sipas nenit 52 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika dh).

7. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. LÇ-CP130325/4, datë 20.03.2025, për objektin ***"Ngritje një kat shtesë banese"***, me adresë në Nj. Adm. Tepelenë, pasuria nr. 6/63, ZK nr. 3574, me zhvillues "L.Ç.", "P. F.", me problematika si më poshtë vijon:
Objekti i ndërtuar ka ndryshime nga objekti i miratuar. Në njërën prej fasadave të objektit, ku ka qenë e parashikuar ndërtimi i një verande të hapur, nga ana e zhvilluesit dhe ndërtuesit, kjo verandë është mbyllur, duke krijuar një ambient të ri me funksion banim. Gjithashtu, në katin me çati, është shtuar një dritare e cila nuk ka qenë e parashikuar në projektin e miratuar.





Në dokumentacionin në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar ndonjë dokument që të vërtetojë kryerjen e inspektimeve nga ana e IMTV / nxjerrjen e vendimit për dënim me masë administrative gjobë / pagesën e kësaj mase administrative. Nga IMTV nuk janë kryer inspektime me qëllim verifikimin e zbatimit të projektit të miratuar. Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit është kundërvajtje administrative, e dënueshme sipas nenit 52 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me mangësitë në kryerjen e inspektimeve në territor, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. D.M.,** në funksionin e kryeinspektorit të IMTV, për rastin 7;
- **Z. G.M.,** në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023-30.11.2024), për rastet 3,5, 6;
- **Z. E.L.,** në funksionin e inspektorit të IMTV, për rastet 3, 5, 6, 7.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, në një rast është konstatuar se leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të Planit të Detajuar Vendor të miratuar. Kjo parregullsi është konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit miratuar me Vendim nr. EM-LN270225/4, datë 25.04.2025, për objektin ***"Shtesë anësore 2 kat e objektit ekzistues hotel dhe shërbime 3 kat"***, me adresë në pasurinë nr. 8/144, ZK 3574, Nj. Adm. Tepelenë, me zhvillues "E.M.", "P. F." Objekti i miratuar ndodhet në njësisë strukturore TP_UB_IE3_340/8. Për këtë njësi strukturore, në PPV, është parashikuar hartimi i PDV-së. Miratimi i lejeve të zhvillimit / ndërtimit në njësi strukturore për të cilat është parashikuar hartimi i PDV-ve, por nuk është miratuar ende, është i ndaluar, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në Vendimin nr. 4 i KKT, datë 28.07.2020 *"Për përcaktimin e llojit të punimeve për të cilat hartimi i PDV nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm t'i paraprijë lejes për zhvillim, ndërtim, apo deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve"*. Tipologjia e objektit të miratuar (njësi shërbimi) nuk është e parashikuar në rastet përjashtimore. Si përfundim, leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të PDV-së.
Për gjetjen e konstatuar në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit në mungesë të Planit të Detajuar Vendor të miratuar, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Znj. J.K.,** me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë (e komanduar);
- **Z. L.B.,** me funksion drejtor i DPKZHT (aktualisht i larguar).

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit në Bashkinë Tepelenë, u konstatua se në të gjitha rastet dokumentacioni teknik dhe ligjor rezulton i paplotë dhe në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Mangësitë kryesore lidhen me mangësitë e projekteve arkitektonike, elektrike, hidrosanitare dhe të mbrojtjes nga zjarri, mungesën e studimeve gjeologo / sizmiko - inxhinierike, si dhe mungesën ose pavlefshmërinë e licencave, deklaratave dhe policave të sigurimit profesional të projektuesve dhe audituesve. Gjithashtu, në shumicën e rasteve mungonte kontrata e sigurimit me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit, ndërsa u evidentuan edhe mangësi në dokumentacionin e pronësisë, dokumentet mjedisore dhe raportet e efiçencës së energjisë. Në procedurat për pajisjen me certifikatë përdorimi u konstatuan vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, mungesa të dokumenteve teknike dhe administrative, si projektet "as-built", procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe kontratat me mbikëqyrësit apo shoqëritë ndërtuese, si dhe raste kur aktet e kontrollit nuk provohet se janë verifikuar nga autoriteti vendor.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Tepelenë, u konstatua se në asnjë nga rastet e audituara DPKZHT nuk ka kërkuar në mënyrën dhe fazën e duhur mendimin e autoriteteve përgjegjëse. Mendimet e institucioneve janë kërkuar gjatë fazës së lejes së zhvillimit, kur dokumentacioni teknik nuk është i plotë, duke e bërë të pamundur një vlerësim të plotë mbi përputhshmërinë e projekteve dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme. Nga auditimi rezultoi se nuk janë respektuar rekomandime dhe kërkesa të institucioneve si Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia e Efiçencës së Energjisë dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, ndërsa në të gjitha rastet DPKZHT është mjaftuar me miratime në heshtje DV ASHK.

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për katin përdhe me përdorim shërbim dhe distancat nga kufiri i pronës.
4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, në tre raste janë konstatuar problematika në lidhje me zhvillimin e objekteve në përputhje me projektet e miratuara. Në një rast, zhvilluesi ka reflektuar ndryshimin e projektit përpara marrjes së miratimit nga Bashkia Tepelenë. Në një rast, objekti i zbatuar ka ndryshime nga objekti i miratuar, pasi është ndërtuar një kat më shumë (nëntokë). Në një rast, në njërën prej fasadave të objektit, ku ka qenë e parashikuar ndërtimi i një verande të hapur, nga ana e zhvilluesit dhe ndërtuesit, kjo verandë është mbyllur, duke krijuar një ambient të ri me funksion banim. Gjithashtu, në katin me çati, është shtuar një dritare e cila nuk ka qenë e parashikuar në projektin e miratuar. Në një rast zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar.
5. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, në një rast është konstatuar se leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të Planit të Detajuar Vendor të miratuar. Objekti i miratuar ndodhet në njësisë strukturore TP_UB_IE3_340/8. Për këtë njësi strukturore, në PPV, është parashikuar hartimi i PDV-së. Miratimi i lejeve të zhvillimit / ndërtimit në njësi strukturore për të cilat është parashikuar hartimi i PDV-ve, por nuk është miratuar ende, është i ndaluar.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.4 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e inspektoratit mbrojtjes së territorit të njësisë vendore (IMTV).

2.4.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
2.4.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV. Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të paarkëtuara nga IMTV.
2.4.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
2. Vendimet e masave administrative (gjobave);
3. Vendimet e pezullimeve të punimeve;
4. Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
5. Planet mujore, tremujore dhe/ose vjetore të punës;
6. Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
7. Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
8. Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*;

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"*;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".*

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV, Bashkia Tepelenë nuk disponon asnjë automjet për nevoja të inspektimit ditor. Gjithashtu, nuk disponon mjet për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve Bashkia ka bashkëpunuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, konstatohet se:

2.4.1. Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë për vitin 2023 dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**,** në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, rezulton se: është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendimin nr. 07, datë 27.01.2023, me nr. 232 prot, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë. IMTV ka pasur në përbërjen e saj maksimalisht 2 (dy) punonjës [1 (një) kryeinspektor dhe 1 (një) inspektor]. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Autoritetet e qeverisjes vendore sigurojnë që për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, të kenë profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë pune në fushat përkatëse. Numri minimal i profesionistëve që duhet të sigurojë çdo njësi e qeverisjes vendore përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të numrit të popullsisë së njësisë së qeverisjes vendore, dhe është në çdo rast jo më i vogël se ***6 profesionistë***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. T.P., në funksionin e Kryetarit të Bashkisë (aktualisht i larguar).

Në vijim është paraqitur struktura e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, për të gjithë periudhën nën auditim, duke përfshirë strukturën e datës 01.01.2023, largimet, rekrutimet, si dhe arsimimin e secilit punonjës:

Tabela nr. 43: *Struktura e IMTV, Bashkia Tepelenë, 01.01.2023 – 31.12.2025*

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimimi	Data e emërimit	Data e largimit
1	G.M.	Kryeinspektor	Ing. ndërtimi	01.01.2023	30.11.2024
2	D.M.	Kryeinspektor	Ing. gjeodet	01.12.2024	Vazhdon
3	E.L.	Inspektor	Akademia ushtarake	01.01.2023	Vazhdon

Burimi: *Bashkia Tepelenë*

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Tepelenë është punësuar një punonjës (E.L.) që nuk plotëson kriteret arsimore të përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. T.P., në funksionin e Kryetarit të Bashkisë (aktualisht i larguar).

2.4.2 Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

2.4.2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tremujore dhe/ose vjetore të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë. Nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë nuk është vendosur asnjë dokumentacion në dispozicion mbi hartimin e këtyre planeve. Gjithashtu, nga auditimi i aktivitetit të IMTV është konstatuar se mungon bashkëpunimi me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Në aktivitetin e IMTV është përfshirë kryerja e inspektimeve në subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Tepelenë.
Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. G.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.12.2024 – në vijim).

2.4.2.2 Mbi raportimin periodik:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë nuk është vendosur asnjë dokumentacion në dispozicion mbi hartimin e këtyre raportimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. G.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.12.2024 – në vijim).

2.4.3 Mbi auditimin e procedurave të mbajtura nga IMTV:

Gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2025 nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë janë mbajtur 13 (trembëdhjetë) procedura (6 procedura për vitin 2023; 2 procedura për vitin 2024; 5 procedura për vitin 2025). Në vijim janë paraqitur këto procedura, si dhe problematikat e konstatuara për secilën prej tyre:

1	**Kundërvajtësi**	"G." sh.p.k		
	Shkelja e konstatuar	Nuk evidentohet asnjë shkelje		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000039	14.02.2023	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		-	-	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	-	**Paguar**	-	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "G." sh.p.k nuk janë konstatuar problematika apo devijime nga projekti i miratuar apo dispozitat ligjore.

- Ky inspektim është kryer nga vetëm një inspektor, kur dispozitat ligjore përcaktojnë qartësisht se: *"Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje **jo më pak se dy inspektorë**, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore"*. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika 1.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. G.M.,** në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);
- **Z. E.L.,** në funksionin e inspektorit të IMTV.

2	**Kundërvajtësi**	"T." sh.p.k		
	Shkelja e konstatuar	Gjatë kontrollit në objektin "Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Mamaj, Tepelenë", është konstatuar se ka përfunduar afati i lejes, si dhe janë konstatuar ndryshime në projekt		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000040	12.07.2023	
Vendimi i pezullimit		0000002	06.07.2023 (45 ditë)	
Vendimi i gjobës		0000037	13.07.2023	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	400,000 lekë	**Paguar**	Po	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	Jo	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "T." sh.p.k është konstatuar se ka përfunduar afati i lejes, si dhe janë konstatuar ndryshime në projekt. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve me afat 45 ditor, si dhe vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 400,000 lekë (100,000 lekë për përfundimin e afatit të lejes + 300,000 lekë për ndryshimet në projekt). Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Kundërvajtja e konstatuar (ndryshimet në projektin e miratuar) nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nuk është kryer një inspektim i dytë me qëllim verifikimin e marrjes së lejeve të nevojshme nga kundërvajtësi, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika 8, nënpika b);
- Gjendja e konstatuar nuk është përshkruar e plotë në aktet zyrtare të mbajtura nga IMTV, pasi nuk ka informacion të detajuar në lidhje me ndryshimet në projektin e miratuar. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika 5. Si rrjedhim, grupi i auditimit nuk mund të shprehet:
- nëse mos-nxjerrja e vendimit të prishjes është legjitime ose jo;
- nëse do të duhej të ishte kryer kallëzim penal (për kundërvajtësin) ose jo;
- nëse vlera e masës administrative është llogaritur e saktë ose jo.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. G.M.,** në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);
- **Z. E.L.,** në funksionin e inspektorit të IMTV.

3	**Kundërvajtësi**	K.S.		
	Shkelja e konstatuar	Ndërtim pa leje (bazament betoni), mosdeklarim i punimeve që përjashtohen nga leja; bazament betoni me përmasa 11 × 6 = 66 m²		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000041	23.10.2023	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000038	24.10.2023	
Vendimi i prishjes		0000001	24.10.2023	
Gjoba	50,000 lekë	**Paguar**	Jo	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "K.S." "P.F." është konstatuar një bazament betoni i ndërtuar pa leje, me përmasa 11 ml * 6 ml = 66 m^2, me trashësi 13 cm. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 50,000 lekë. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:

- Kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes. Në kushtet kur IMTV nuk disponon mjete për ekzekutimin e këtyre vendimeve, ajo duhet të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera, siç janë NSHP apo IKMT. Këto kërkesa nuk janë kryer ose nuk është dokumentuar kryerja e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2;
- Vlera e masës administrative nuk është llogaritur e saktë. Sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Ndërtimi i një bazamenti betoni është punim që kërkon pajisjen me leje ndërtimi. Si i tillë, gjoba për këtë kundërvajtje duhet të bazohet në vlerën e investimit (por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi), dhe jo në dispozitat ligjore të nenit 52, pika 1, nënpika d). Vlera e saktë e gjobës do të duhej të bazohej në manualet e ndërtimit, ku vlera e bazamentit të betonit C 16/20 është 14,114.35 lekë/m^3, si rrjedhim: 11 m * 6 m * 0.13 * 14,114.35 lekë/m^3 = ***121,101 lekë***. Vlera e gjobës së llogaritur nga kryeinspektori është ***71,101 lekë*** më e vogël se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës. Kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. G.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);

- Z. E.L., në funksionin e inspektorit të IMTV.

4	**Kundërvajtësi**	S.G		
	Shkelja e konstatuar	Nuk evidentohet asnjë shkelje		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000042	15.11.2023	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		-	-	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	-	**Paguar**	-	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "S.G." "P.F." nuk janë konstatuar problematika apo devijime nga projekti i miratuar apo dispozitat ligjore.

5	**Kundërvajtësi**	"2." sh.p.k		
	Shkelja e konstatuar	Nuk është kryer njoftimi për fillimin e punimeve në mënyrë elektronike, por fizikisht		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000043	27.12.2023	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000039	27.12.2023	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	300,000 lekë	**Paguar**	Po	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "2." sh.p.k nuk janë konstatuar problematika apo devijime nga projekti i miratuar apo dispozitat ligjore.

6	**Kundërvajtësi**	A.Q		
	Shkelja e konstatuar	Nuk është kryer njoftimi për fillimin e punimeve në mënyrë elektronike, por fizikisht		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000044	27.12.2023	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000040	27.12.2023	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	300,000 lekë	**Paguar**	Jo	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "A.Q.", "P.F." është konstatuar se subjekti nuk ka aplikuar nëpërmjet sistemit *e-lejet* për t'u pajisur me konfirmim për fillimin e punimeve, por e ka dërguar nëpërmjet postës. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 50,000 lekë. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës. Kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. G.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024).

7	**Kundërvajtësi**	T.K		
	Shkelja e konstatuar	Nga kontrolli i ushtruar në terren u konstatua se shtetasi T.K ka ndërtuar një objekt me mure me tulla, xokol dhe shtresa me beton, kolona betoni, me përmasa 10 ml × 8.7 ml × 2.7 ml		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000045	20.11.2024	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000041	26.11.2024	
Vendimi i prishjes		0000002	26.11.2024	
Gjoba	3,500,000 lekë	**Paguar**	Jo	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	Po	
Inspektorët	G.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "T.K.", "P.F." është konstatuar se subjekti ka ndërtuar një objekt me mure me tulla, xokol dhe shtresa me beton, kolona betoni, me përmasa 10 ml * 8.7 ml * 2.7 ml. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 3,500,000 lekë, si dhe vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës. Kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 % për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes. Në kushtet kur IMTV nuk disponon mjete për ekzekutimin e këtyre vendimeve, ajo duhet të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera, siç janë NSHP apo IKMT. Këto kërkesa nuk janë kryer ose nuk është dokumentuar kryerja e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. G.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.01.2023 - 30.11.2024);
- Z. E.L., në funksionin e inspektorit të IMTV.

8	**Kundërvajtësi**	A.C.		
	Shkelja e konstatuar	Objekt me mur tulle dhe guri, xokol dhe shtresa betoni, kolona betoni, me përmasa 13.5 ml × 11.5 ml × 3.2 ml (lartësi)		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000046	06.12.2024	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000042	10.12.2024	
Vendimi i prishjes		0000003	10.12.2024	
Gjoba	5,433,750 lekë	**Paguar**	Jo	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "A.C.", " P.F." është konstatuar se subjekti ka ndërtuar një objekt me mur tulle dhe guri, xokol dhe shtresa betoni, kolona betoni, me përmasa 13.5 ml * 11.5 ml * 3.2 ml. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 5,433,750 lekë, si dhe

vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës. Kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 % për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes. Në kushtet kur IMTV nuk disponon mjete për ekzekutimin e këtyre vendimeve, ajo duhet të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera, siç janë NSHP apo IKMT. Këto kërkesa nuk janë kryer ose nuk është dokumentuar kryerja e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk është nisur indicia e veprës penale drejt organeve ligjzbatuese. Në respektim të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.11.2024 – në vijim);
- Z. E.L., në funksionin e inspektorit të IMTV.

9	**Kundërvajtësi**	E.Z.		
	Shkelja e konstatuar	Shkelje e afatit të përfundimit të punimeve		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000047	17.02.2025	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000043	17.12.2024	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	100,000 lekë	**Paguar**	Po	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit " E.Z.", "P.F." është konstatuar se subjekti ka shkelur afatin e përfundimit të punimeve. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 100,000 lekë. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Nga ana e kryeinspektorit nuk është vendimi për pezullimin e punimeve. Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të

ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.11.2024 – në vijim).

10	**Kundërvajtësi**	M.S.		
	Shkelja e konstatuar	Objekt me mure tulle dhe guri, xokol dhe shtresa betoni, me përmasa 7.5 ml × 4.5 ml × 2.8 ml		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000048	28.03.2025	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		0000044	28.03.2025	
Vendimi i prishjes		0000004	08.04.2025	
Gjoba	1,185,250 lekë	**Paguar**	Jo	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "M.S.", "P.F." është konstatuar se subjekti ka ndërtuar pa leje objekt me mure tulle dhe guri, xokol dhe shtresa betoni, me përmasa 7.5 ml * 4.5 ml * 2.8 ml. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi i dënimit me masë administrative gjobë në vlerën 100,000 lekë, si dhe vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës. Kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë,* ***deri në një muaj****. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk është nisur indicia e veprës penale drejt organeve ligjzbatuese. Në respektim të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes. Në kushtet kur IMTV nuk disponon mjete për ekzekutimin e këtyre vendimeve, ajo duhet të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera, siç janë NSHP apo IKMT. Këto kërkesa nuk janë kryer ose nuk është dokumentuar kryerja e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.11.2024 – në vijim);

- Z. E.L., në funksionin e inspektorit të IMTV.

11	**Kundërvajtësi**	M.S		
	Shkelja e konstatuar	Objekt me mure tulle dhe guri, xokol dhe shtresa betoni me përmasa 7.5 ml * 4.5 ml * 2.8 ml		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000049	28.03.2025	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		-	-	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	-	**Paguar**	-	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Ky konstatim është i njëjtë me konstatimin e mësipërm (për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtën kundërvajtje). Për këtë arsye, nuk do të trajtohet së dyti.

12	**Kundërvajtësi**	G.S.		
	Shkelja e konstatuar	Ndërtim pa leje i ndërtuar para viteve 1990		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000050	16.07.2025	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		-	-	
Vendimi i prishjes		0000005	24.07.2025	
Gjoba	-	**Paguar**	-	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M *(Kryeinspektor)*; E.L *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "G.S.", "P.F." është konstatuar se subjekti ka ndërtuar objekt pa leje para viteve 1990. Për këtë arsye, nga kryeinspektori është nxjerrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, është konstatuar se:
- Kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), ku përcaktohet inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë;
- Nga ana e kryeinspektorit nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes. Në kushtet kur IMTV nuk disponon mjete për ekzekutimin e këtyre vendimeve, ajo duhet të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera, siç janë NSHP apo IKMT. Këto kërkesa nuk janë kryer ose nuk është dokumentuar kryerja e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. D.M., në funksionin e kryeinspektorit të IMTV (01.11.2024 – në vijim);
- Z. E.L., në funksionin e inspektorit të IMTV.

13	**Kundërvajtësi**	K.D.		
	Shkelja e konstatuar	Nuk evidentohet asnjë shkelje		
		Nr. serie	**Datë**	
PVKK		0000051	22.12.2025	
Vendimi i pezullimit		-	-	
Vendimi i gjobës		-	-	
Vendimi i prishjes		-	-	
Gjoba	-	**Paguar**	-	
Faktuar me foto	Jo	**Kallëzim penal**	-	
Inspektorët	D.M. *(Kryeinspektor)*; E.L. *(Inspektor)*			

Në përfundim të kryerjes së inspektimit nga IMTV pranë subjektit "K.D.","P.F." nuk janë konstatuar problematika apo devijime nga projekti i miratuar apo dispozitat ligjore.

Konkluzion mbi auditimin e aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tepelenë gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2025 ka mbajtur 13 procedura. Në 3 (tre) raste (rastet nr. 1, 4, 13), nga ana e IMTV, nuk janë konstatuar problematika. Në 2 (dy) raste (rastet nr. 5 dhe 13), nuk janë konstatuar problematika në lidhje me kryerjen e inspektimit. Nga auditimi i këtyre procedurave është konstatuar se: **i.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 11), procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes është mbajtur dy herë (për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtën kundërvajtje); **ii.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 1), inspektimi është kryer nga 1 (një) inspektor, kur dispozitat ligjore parashikojnë që inspektimet kryhen minimalisht nga 2 (dy) inspektorë; **iii.** Në 6 (gjashtë) raste (rastet nr. 2, 3, 7, 8, 10, 12), kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi; **iv.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 2), nuk është kryer një inspektim i dytë me qëllim verifikimin e marrjes së lejeve të nevojshme nga kundërvajtësi, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve; **v.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 2), gjendja e konstatuar nuk është përshkruar e plotë në aktet zyrtare të mbajtura nga IMTV, pasi nuk ka informacion të detajuar në lidhje me ndryshimet në projektin e miratuar. Si rrjedhim, grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse mos-nxjerrja e vendimit të prishjes është legjitime ose jo, nëse do të duhej të ishte kryer kallëzim penal (për kundërvajtësin) ose jo, apo nëse vlera e masës administrative është llogaritur e saktë ose jo; **vi.** Në 5 (pesë) raste (rastet nr. 3, 7, 8, 10, 12), nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit të prishjes (nuk i janë drejtuar IKMT / NSHP për asistencë); **vii.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 3), vlera e masës administrative nuk është llogaritur e saktë. Vlera e gjobës së llogaritur nga kryeinspektori është ***71,101 lekë më e vogël*** se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit; **viii.** Në 5 (pesë) raste (rastet nr. 3, 6, 7, 8, 10), nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës së gjobës (kryeinspektori nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv të gjobës); **ix.** Në 2 (dy) raste (rastet nr. 8 dhe 10), nuk është nisur indicia e veprës penale drejt organeve ligjzbatuese; **x.** Në 1 (një) rast (rasti nr. 9), nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM.
2.5.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
2.5.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.
1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Tepelenë paraqiten, sipas VKM-ve:

- **Për Bashkinë Tepelenë** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM nr. 6, datë 06.01.2011 *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"*, sipas lidhjes nr. 1 me 181 fletë, përfundon me numër rendor 1367 dhe përmban 1112 prona të transferuara;
- **Për Komunën Qendër Tepelenë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë me VKM nr. 843, datë 06.12.20211 *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qendër, Qarku Gjirokastër"*, lista e inventarit përmban 159 fletë, përfundon me numrin rendor 1111 dhe përmban 577 prona;
- **Për ish-Komunën Kurvelesh** është miratuar lista përfundimtare e pronave me VKM nr. 386, datë 25.05.2011 *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Kurvelesh, Qarku Gjirokastër"*, lista e inventarit përmban 82 fletë, përfundon me numrin rendor 554 dhe përmban 262 prona;
- **Për ish-Komunën Lopëz** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM nr. 380, datë 08.04.2009 *"Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lopëz të Qarkut të Gjirokastrës"*, sipas lidhjes nr. 1, që përfundon me numër rendor 475 dhe përmban 357 prona.

Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Tepelen duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimi i të metave dhe humbjeve, vlerësimi monetar, si dhe krijimi i regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerës së blerjes, vlerës së shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, bëhet regjistrimi i tyre në regjistrat publik të pronës dhe në kontabilitet, duke vijuar me përditësimin periodik, sa herë që ka ndryshime në statusin juridik / fizik / monetar të saj.
Nga auditimi rezulton se referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Tepelenë zotëron në total 2308 asete, nga të cilat për 1951 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga lista e aseteve të transferuara, rezulton se Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ish Zyrën Vendore të Registrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tepelenë vetëm asete të llojit kullota, ara, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekt mbi truall.
Për periudhën objekt auditimi, situata sa i takon regjistrimit dhe certifikimit të aseteve të transferuara për Bashkinë Tepelenë, pasqyrohet në tabelën nr. 1, në kapitullin "Anekse" të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Referuar procesit të regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë, rezulton se nga 2996 asete në tërësi, Bashkia Tepelenë ka regjistruar dhe pajisur me certifikatë 216 asete me sipërfaqe 1,010.3 ha tokë të llojit pyje, kullota, truall, ose 7.3% të aseteve me vlerë kontabël të paraqitur edhe në bilanc.
(Pasuritë për të cilat është aplikuar regjistrimi i tyre, por ende të pa pajisura me certifikatë pronësie, pasqyrohet në tabelën nr. 2 në kapitullin "Anekse" të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për asetet e mbetura, nuk është kryer një inventarizim periodik, duke mos pasur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj.
Nuk administrohet informacion për pasuritë e llojit truall, sa sipërfaqe janë transferuar për Bashkinë Tepelenë, gjendja fizike e tyre, si dhe më pas regjistrimin e tyre pranë DV ASHK Tepelenë. Ndërkohë, sa i takon aseteve të llojeve kullota / pyje, transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive"*, i ndryshuar, rezulton se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete sipas shtojcës nr. 28, me numër rendor 1-688 si vijon:

Resursi	**Sipërfaqe**
Pyje	8,950 ha
Kullotë	19,989 ha
Toka joproduktive	401 ha
Gjithsej	**29,340 ha**

Nga sipërfaqet e mësipërme rezulton se janë regjistruar në DV ASHK Tepelenë rreth 29,000 ha.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*; nenin 6 të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *"Për pronat e paluajtshme të shtetit"*, i ndryshuar; nenin 62 të Ligjit nr. 111/2018 *"Për Kadastrën"*; VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, pika 26, 27, 30 dhe 74.

Qiradhënia e aseteve:
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka pasur në fuqi 131 kontrata[3] për dhënien me qira të këtyre sipërfaqeve, nga të cilat:
- për periudhën deri më 31.12.2023 rezultojnë 27 subjekte debitor për vlerën ***2,010,330 lekë***, nga të cilat vetëm në vitin 2023 janë krijuar gjithsej ***384,194 lekë***;
- për periudhën deri më datë 31.12.2024, rezultojnë 29 subjekte debitor për vlerën ***1,501,688 lekë***, nga të cilat vetëm në vitin 2024 janë krijuar ***1,111,484 lekë***;
- për vitin periudhën deri më datë 31.12.2025, rezultojnë 58 subjekte debitor për vlerën ***5,896,164*** **lekë**, nga të cilat vetëm në vitin 2025 janë krijuar ***4,941,409 lekë.***
(Lista e subjekteve pasqyrohet në tabelën nr. 4, kapitulli "Anekse" të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vlerën e detyrimit të palikuiduar për secilin subjekt, nuk është përllogaritur kamatëvonesa. Konkretisht, sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, duke pasur në konsideratë që pagesa kryhet në çdo vit në datën e lidhjes, si dhe duke aplikuar normën minimale të penalitetit (0.5% për çdo ditë vonesë), konstatohet se për detyrime qiraje, vlera e penalitetit që nuk është përllogaritur nga Bashkia Tepelenë është:
- për vitin 2023 vlera e penalitetit për 16 subjekte është ***255,629 lekë***;
- për vitin 2024 vlera e penalitetit për 33 subjekte është ***1,396,176 lekë***;
- për vitin 2025 vlera e penalitetit për 55 subjekte është ***5,711,962 lekë***.
(Përllogaritjet e penalitetit pasqyrohen në tabelën nr. 5, kapitulli "Anekse" të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

[3] Lista e subjekteve, pasqyrohet në tabelën nr. 3 në kapitullin "Anekse" të Raportit të Auditimit.

Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masat e nevojshme për të regjistruar në DV ASHK Tepelenë kontratat e qiradhënies me afat mbi 9 vjet, në kundërshtim me nenin 196 dhe 197 të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 *"Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. T.P., me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë (aktualisht i larguar);
- Z. G.S., me funksion Drejtor i Zhvillimit Rural;
- Z. M.S., me funksion përgjegjës në Sektorin për Zhvillimin Rural;
- Z. A.A., me funksion përgjegjës në Sektorin për Zhvillimin Rural.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.6.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.6.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
2.6.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
2.6.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
- Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2025;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Tepelenë, për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e inventarizimit etj, për vitin ushtrimor 2025;

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2025 Bashkia Tepelenë ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen vetëm aparati i Bashkisë Tepelenë sepse Bashkia Tepelenë nuk ka njësi shpenzuese të tjera. Bashkia Tepelenë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër si dhe nuk ka pasur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:
☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Tepelenë për vitin 2025 janë të nënshkruara nga z. G.S. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. S.K. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Elbasan në datë 28.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte bankë (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimet, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

<u>Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:</u>

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Tepelenë në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=2,922,283,879 lekë.

- Aktivet	3,208,455,067 lekë
- Detyrimet	286,171,188 lekë
- Aktivet Neto	2,922,283,879 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **343,503,966 lekë** dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 56,244,656 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 22,432,159 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 264,827,151 lekë;

Fondi i Konsoliduar:
Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës '*Teprica*".

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	3,693,770	2,745,782,461	Çelje
Amortizim i vitit	73,235,032	434,003,122	Investime + Dhurime
		(8,291,249)	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	76,928,802	3,171,494,334	Shuma
Shuma		**3,094,565,532**	

Burimi: Bashkia Tepelenë
Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar për vlerën 2,887,383,260 lekë.
Sipas tabelës së mësipërme e përllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" vlera e raportuar në bilanc është nënvlerësuar për vlerën 207,182,272 lekë.

Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
531	Mjete Monetare në arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	56,244,656	24,870,072	31,374,584
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-	-
	Totali	**56,244,656**	**24,870,072**	**31,374,384**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 56,244,656 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 34,900,619 lekë gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 21,344,037 lekë.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 56,24,656 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" 466 "Mjete në ruajtje.
Fondet e papërdorura për vitin 2025 janë si më poshtë:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 31,870,586 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura 3,030,033 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues":
Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës "*Gjendje inventari qarkullues*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	4,508,992	11,257,111	(6,748,119)

32	Inventar i imët	17,923,167	19,466,297	(1,543,130)
33	Prodhim në proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje të pambërritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve	-	-	-
	Totali	**22,432,159**	**30,723,408**	**(8,291,249)**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Tepelenë në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 22,432,159 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 4,508,992 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët " në vlerën 17,923,167 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-8,291,249 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën -8,291,249 lekë
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 4,508,992 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës lëvizjet e llogarisë 312 "Materiale":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	11,257,111
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	54,324,863
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	61,072,982
Gjendja në 31.12.2025	**4,508,992**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 17,923,167 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës, lëvizjet e llogarisë 327 "Inventar i imët":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	19,466,297
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	196,862
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	1,739,992
Gjendja në 31.12.2025	**17,923,167**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Inventarizimi i aktiveve:
Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 152 datë 02.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të imët të materialeve".* Sipas urdhrit të mësipërm inventari i aktiveve do të zhvillohet deri në 31.12.2025.
Komisioni i mësipërm nuk ka kryer procesin e inventarizimit në kundërshtim me urdhrin nr. 152, datë 02.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të*

imët të materialeve", dhe Urdhrin nr. 30 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* pika 85 shkronja a, b, c.

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme "&"Të tjera aktive afatshkurtra":

Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të arkëtueshme*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**264,827,151**	**166,318,952**	**98,508,199**
411	Klientë e llogari te ngjashme	-	-	-
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	1,254,774	1,254,774	-
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	188,221,991	172,996,870	(15,885,121)
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	75,350,386	33,157,848	42,192,538
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	-	-	(41,090,540)
	Totali	-	-	
	Të tjera aktive afatshkurtra	**0**	**37,028,214**	**(37,028,214)**
409	Furnitore(Debitore), parapagime pagesa të pjesshme	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	37,028,214	(37,028,214)
	Totali	**264,827,151**	**166,318,952**	**98,508,199**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 172,996,870 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 188,221,991 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje neto me vlerë 15,225,121 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Nga analiza e llogarisë 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** paraqiten detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF8: Detajet e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2024	Shtesa viti 2025	Pakësim viti 2025	Detyrim datë 31.12.2025
Detyrime Biznesi	24,069,618	6,661,537	3,557,002	27,174,153
Agjent Tatimor (Ujësjellësi)	18,868,344	7,279,127	9,705,170	16,442,301
Kontratat	1,501,688	6,602,844	1,511,269	6,593,263
Toka bujqësore	11,604,351	1,767,867	1,452,327	11,919,891
Detyrime subjektet e hidrokarbureve	2,900,000	-	900,000	2,000,000
Detyrime në pamundësi arkëtimi	24,718,646	-	-	24,718,646
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	2,051,979	13,599	92,385	1,972,743
Gjoba IMTV	2,290,000	10,118,750	-	12,408,750
Detyrimet e lëna nga KLSH	84,992,244	-	-	84,992,244
Shuma	**172,996,870**	**32,443,724**	**17,218,603**	**188,221,991**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:

- Detyrimet progresive të kontabilizuara për gjobat e IMTV janë në vlerën 12,408,750 lekë. Këto detyrime janë kontabilizuar në këtë llogari sipas shkresave me nr. 18/12, datë 19.12.2024 dhe me shkresën nr. 935, datë 26.05.2025 të cilat janë përcjell nga sektori i IMTV.
- Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për abonentë familjarët dhe biznes në datën 31.12.2025 janë kontabilizuar në vlerën 88,848,254 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Vendore në fund të vitit 2025 ka paraqitur informacion në Drejtorinë e Financës për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2025 me shkresën nr. 328, datë 10.02.2026.
- Detyrime të cilat janë konsideruar me pamundësi arkëtimi janë me detyrime më datë krijimi 2008-2018 lista përbëhet nga 665 subjekte.
- Detyrimet për kontratat vlera e detyrimit 6,593,263 lekë i përket 86 subjekteve.
- Detyrimet për autorizimet e karburanteve me vlerë detyrimi 2,000,000 lekë i përket 3 subjekteve.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 41,068,507 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 41,068,507 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.
Pasqyra PF9: Detajet e nënrubrikës "*Të tjera operacione me shtetin*".

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Llogari 401-408	8,896,122	0
Paga personeli llog 42	12,689,201	12,549,167
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	892,242	928,469
Sigurime shoqërore llog.435	3,731,265	3,610,071
Sigurime shëndetësore llog.436	510,803	498,845
Kreditor të ndryshëm llog.467	48,630,753	52,599,510
Totali	**75,350,386**	**70,186,062**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 *"Studime dhe Kërkime"*, dhe paraqiten me kosto historike 3,352,003 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 352,003 lekë, shtesa gjatë vitit 2025 në vlerën 3,000,000 lekë, amortizim i vitit 2025 në vlerën 325,003 lekë dhe vlerë neto në vlerën 3,000,000 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* gjatë vitit 2025 janë kontabilizuar në këtë llogari 2 projekte me vlerë 3,000,000 lekë. Për këto projekte procedurat e prokurimit janë kryer gjatë vitit 2024.

Pasqyra PF10: Lista e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202

Nr	Emri I Projektit	Viti i regjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabël neto
1	Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetje urbane nga vend depozitimi ilegal	2025	1,852,003	352,003	1,500,000
2	Hartim plane mbarështimi	2025	1,500,000	0	1,500,000
Shuma			**3,352,003**	**352,003**	**3,000,000**

Burimi: Bashkia Teplenë

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 2,861,494,101 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,507,419,781 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 31,312,774_ lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 28,275,206 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 59,587,980 lekë Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 431,003,122 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 3,693,770 lekë.
Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	302,847,617	-	-	-	302,847,617
211	Pyje, Kullota, Plantacione	1,149,952,273	20,922,391	-	-	1,170,874,664
212	Ndërtime e Konstruksione	284,012,047	138,799,972	21,140,6012	-	401,671,418
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	746,849,236	259,279,619	50,306,443-	-	955,822,413
214	Instalime dhe pajisje	6,695,331	861,600	377,847		7,179,084
215	Mjete Transporti	4,574,937	10,326,000	745,047		14,155,890
218	Inventar Ekonomik	12,488,339	813,540	665,094	3,693,770	8,943,015
	Shuma	**2,507,419,781**	**431,003,122**	**73,235,032**	**3,693,770**	**2,861,494,101**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 210 ***"Toka, troje terrene"*** është paraqitur në bilanc në vlerën 302,847,617 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2025 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 302,847,617 lekë.
Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
Nga auditimi i llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

Llogaria 211 ***"Pyje, Kullota, Plantacione"*** është paraqitur në bilanc në vlerën 1,149,952,273 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 20,922,391 lekë nga 2 (dy) pasuri të cilat janë certifikuar gjatë vitit 2025.
Në fund të vitit 2025 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 1,170,874,664 lekë.
Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
Nga auditimi i llogarisë 211 *"Pyje, Kullota, Plantacione"* ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

Pasqyra PF12: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 211:

Nr Llog	Emërtimi	Viti	Lloji i aktivit	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2025
211	Kullotë 58/30	2025	Kullotë	3,845,971	3,845,971
211	Kullotë 358/3	2025	Kullotë	17,076,420	17,076,420
Total				**20,922,391**	**20,922,391**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 212 ***" Ndërtesa dhe Konstruksione"***. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 401,671,418 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 441,488,581 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 14,311,634 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 7,352,815 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 117,135,523 lekë Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 21,140,601 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Pasqyra PF13: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione":

Nr. Llog	Emërtimi	Marrja në dorëzim	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
212	Rikonstruksion Njësia Administrative Qendër	Nuk është marrë	2,941,518		
212	Të tjera ndërtimore (Përmirësim i banesave për komunitetet e pafavorizuara)	Nuk është marrë në dorëzim	7,870,116		
212	Ujësjellësi Ali Pashë Tepelena	2025	7,352,815		
212	Rikonstruksion shkolla "Avni. Rustemi"	2025	120,635,523		
Total			**138,799,972**	**21,140,601**	**117,659,371**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Konstatim: Nga informacioni nga tabela e mësipërme kemi 2 projekte që nuk janë marrë në dorëzim dhe janë kontabilizuar në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* në vlerën 10,811,634 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* këto projekte duhet të kontabilizohen në llogarinë 231 *"Investime për aktivet afatgjata"* deri në momentin e marrjes në dorëzim të investimit.
Projekti *Rikonstruksion shkolla "Avni. Rustemi"* është marrë në dorëzim gjatë vitit 2025, për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 129,596,400 lekë dhe është kontabilizuar me vlerën 120,635,523 lekë. Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerën e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer plotësisht detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit.

Pasqyra PF14: Projektet gjatë viteve 2023-2025:

Nr.	Procedura te realizuara (Emërtimi)	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Burimi i financimit	Financimi sipas viteve	Likuidimi sipas viteve	Likuidimi deri në 31.12.2025	Sa është pa likuiduar financim i ardhshëm	Sa pa likuiduar për mungesë burimesh financimi
1	Rikonstruksion i godinës dhe oborrit të shkollës 9-vjeçare "A.Rustemi" (është likuiduar nga fondet e buxhetit.	108,776,265	107,997,000	Vendimi KB nr. 88, datë 30.11.2023 dhe shkresa M.Arsimit	2023=55,476,000 2024=60,660,000 2025=4,500,000 2026=8,960,400 Totali=129,596,400	2023=55,476,000 2024=60,660,000 2025=4,500,000	120,636,000	8,960,400	8,960,400
2	Rikonstuksion godina Njësia Administrative Qendër	8,750,000	6,900,645	Vendimi KB nr. 88, datë 30.11.2023	2024=3,000,000 2025=5,280,774	2024=1,000,000 2025=1,942,000	2,942,000	5,338,774	0
3	Përmirësimi I banesave sociale për familjet e pafavorizuara (M.ekonomisë)	17,455,701	15,197,648	Buxheti shtetit dhe buxheti pavarur me VKB nr. 6, datë 30.1.2025	2025=8,378,736 2026=8,378,736 2026=4,198,368 nga Bashkia Totali=20,955,840	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*:

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 955,822,413 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore paraqitet në shumën 1,087,371,367 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi pasur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 5,000,000 lekë. lëvizje brenda aktiveve në vlerën 254,279,619 lekë Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 50,306,443 lekë.

Pasqyra PF15: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore":

Nr Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Marrja në dorëzim	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Rikonstruskion rruga Kryeqëzim Tafil Buzi - Bilbilenjte	1,500,000	Para vitit 2020		
2	Rikonstruskion rrugë fshati Mamaj	2,000,000	2023		
3	Rikonstruksion Lera	1,500,000	2024		
4	Rikonstruksion Ujësjellësi Nivicë-Peshtan	221,371,560	2024		
5	Rikonstruksion Ujësjellësi fshati Salari	32,908,059	2024		
Total		**259,279,619**		**50,306,443**	**208,973,176**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Konstatim: Nga informacioni nga tabela e mësipërme projektet e mësipërme janë marrë në dorëzim përpara vitit 2025 dhe duhet të kontabilizoheshin në këtë llogarinë në vitin në të cilin janë marrë në dorëzim dhe me vlerën e plotë të projektit.

Nga auditimi u konstatua se projekti "*Rikonstruksion Ujësjellësi Nivicë-Peshtan" është kontabilizuar për vlerën 221,371,560 lekë ndërkohë që vlera e kontratës me TVSH është 232,667,018 lekë dhe projekti "Rikonstruksion Ujësjellësi fshati Salari" është kontabilizuar për vlerën 32,908,059 lekë ndërkohë që vlera e kontratës me TVSH është 34,697,238 lekë*

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*

Pasqyra PF16: Projektet gjatë viteve 2023-2025:

Nr.	Procedura te realizuara (Emërtimi)	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Burimi i financimit	Financimi sipas viteve	Likuidimi sipas viteve	Likuidimi deri në 31.12.2025	Sa është pa likuiduar financim i ardhshëm	Sa pa likuiduar për mungesë burimesh financimi
1	F.V matësa në kollonë në banesat Tepelenë	12,769,562	12,244,051		2023=14,693,000	2023=14,693,000	14,693,000	0	0
2	Drejtimi i punimeve "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndëtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë"	2,893,111	2,891,444	Buxheti shtetit, Ministria Infrastrukturës dhe Energjitikes shkresa nr. 232, date28/01/2021	2021=694,347 2022=347,173 2023=347,173 Vitet e tjera =2,083,040 Totali=3,469,733	2021=694,347 2022=340,000 2023=0 2024=2,336,000	3,370,347	99,386	Financimi sipas viteve
3	Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndëtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë" (ka mbetur vetëm 15 mil)	195,833,333	193,889,182	Buxheti Shtetit, Ministria e infrastrukturës dhe energjisë, shkresa nr. 376, datë 12/02/2021	2021=67,000,000 2022=20,000,000 2023=0 2024=145,667,000 Totali=232,667,000	2021=67,000,000 2022=20.000.000 2023=0 2024=130.481.000	217,481,000	15,186,000	Finacim Në pritje të financimit

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria kontabël 214 ***"Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune".*** Kjo llogari përfaqëson makineri pajisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 7,179,084 lekë.
Bashkia gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 861,600 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2025 janë në vlerën 0 lekë.
Pasqyra PF17: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë *214 "Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune":*

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	861,600	-	-	-
Total		**861,600**	**-**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF18: Detajet e nënrubrikës "*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*".

Teprica në fillim				**Shtesa**		**Pakësimet**		**Teprica Ne fund**		
Njësitë Shpenzuese	**K.Historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**	**K.historike**	**Amortizim**	**K.Historike**	**Amortizim**	**K.historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**
Bashkia	13,627,747	6,932,416	6,695,331	861,600	377,847	0	0	14,489,347	7,310,263	7,179,084

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 215 ***"Mjete transporti".*** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Tepelenë.
Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të në datën 31.12.2025, Bashkia disponon 15 mjete me kosto historike 33,476,789 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 19,320,899 lekë dhe me vlerë neto kontabël 14,155,890 lekë.
Bashkia gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit me vlerë 10,326,000 lekë.

Pasqyra PF19: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 215 "Mjete Transporti":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	10,326,000	-	-	-
Total		**10,326,000**	**-**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF20: Mjetet e kontabilizuara gjatë 2025:

Nr	**Drejtoria**	**Emërtimi**	**Viti i regjistrimit**	**Kosto Historike**
1	Drejtoria e shërbimeve	Volsëëagen	2025	2,206,800
2	Drejtoria e shërbimeve	Fuoristrade pick-up me karroceri 4x4	2025	1,620,000
3	Drejtoria e shërbimeve	Kamion vetëshkarkues me vinç borëpastruese	2025	4,200,000
4	Drejtoria e shërbimeve	Fadrome	2025	2,299,200
Totali				**10,326,000**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar dokumentacionit të audituar gjatë vitit 2025 janë kryer 2 procedura auditimi për blerje mjetesh.
1-Blerje mjete transporti për nevoja të Drejtorisë së Shërbimeve Publike me vlerë kontratë 3,938,452 lekë.
2-Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese me vlerë kontratë 14,982,000 lekë.

Sa më sipër Bashkia Tepelenë ka marrë në dorëzim 4 mjete me vlerë 10,326,000 lekë të cilat i ka kontabilizuar në llogarinë 215 "Mjete Transporti" për këto mjete janë lidhur kontratat gjatë vitit 2025 me vlerë 18,920,452 lekë.
Kontabilizmi në këtë llogari për 4 mjete është regjistruar me vlerën e faturave të likuiduara dhe jo sipas vlerës së kontratës.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",*

Pasqyra PF21: Detajet e nënrubrikës "*Mjete Transporti*".

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
23,150,789	18,575,852	4,574,937	10,326,000	745,047	-	-	33,476,789	19,320,899	14,155,890

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Lista e mjeteve në posedim të Bashkisë Tepelenë është pasqyruar **në aneksin nr. 2/3/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria kontabël 218 *"Inventar ekonomik".* Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Tepelenë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 8,943,015 lekë. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 218 *"Inventari ekonomik"* është pakësuar me vlerën 3,545,324 lekë.
Pasqyra PF22: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 218 "Inventar ekonomik":

			Pa pagesë		
Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Jashtë sistemit	Brenda sistemit	Lëvizje brenda aktiveve
1	Bashkia	813,540	-	-	-
Total		**813,540**	**-**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF23: Detajet e nënrubrikës "*Inventar ekonomik*".

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
41,400,094	28,911,755	12,488,339	813,540	665,094	3,693,770	-	38,519,864	29,576,849	8,943,015

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 *"Amortizimi i "AAGJM & AAJM":* Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 625,653,719 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej 73,235,032 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.
Në aneksin nr 2/3/2 në anekset e raportit përfundimtar të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ.
Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Tepelenë janë si më poshtë:
- Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- Inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) 20 %
- Për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- Për mjetet e transportit 20%
- Për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare:

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund 2025 në vlerën 457,000 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2025 është paraqitur në vlerën 457,000 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.
- Bashkia Tepelenë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 4.57 % të aksioneve të "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sh.a me NUIS "M..... L" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve".

Numri i aksioneve është 4,570 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 457,000 lekë.

Vlerat e "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sh.a sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten në aktivet afatgjata financiare të bilancit kontabël 2025, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta"

Investimet për Aktive Afatgjata Jomateriale dhe Materiale:

Gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*"në datën 31.12.2025 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*".

Pasqyra PF 26: Investimet sipas kontratave të lidhura të cilat janë në proces punimesh.

Nr Llog	Emërtimi	Vlera e kontratës	Vlera e likuiduar	Vlera e mbetur
212	Rikonstruksion Njësia Administrative Qendër	8,280,774	2,941,518	5,339,256
212	Të tjera ndërtimore (Përmirësim i banesave për komunitetet e pafavorizuara)	18,237,177	7,870,116	10,367,061
Total		**26,517,951**	**10,811,634**	**15,706,317**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Sa më sipër llogaria 231 "Investime" është nënvlerësuar për vlerën 10,811,634 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Tepelenë më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj, si më poshtë:

Pasqyra PF27: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të pagueshme*".

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	8,896,122	0
42	Detyrime ndaj personelit	12,689,201	12,549,167
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	892,242	928,469
435	Sigurime shoqërore	3,731,265	3,610,071
436	Sigurime shëndetësore	510,803	498,845
467	Kreditor të ndryshëm	48,630,753	52,599,510
4341	Operacione me shtetin (detyrime)		133,161,104

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 401-408 ***"Furnitorë e llogari të lidhura me to"***, në fund të vitit 2025 është në vlerën 8,896,122 lekë, paraqet gjendjen e faturave të palikuiduara nga Bashkia Tepelenë më 31.12.2025. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si me poshtë:

Pasqyra PF28: Detajet e nënrubrikës "*Furnitorë e llogari të lidhura me to".*

Nr	Objekti I faturës	Data dhe numri	Gjendja 31.12.2025
1	Hartim plani mbarshtrimit	nr. 46, datë 01.12.2025	2,310,440
2	Blerje ushqime për Cerdhen, Kopshtin	nr. 1145 datë 12.12.2025	127,187
3	Blerje materiale	nr. 12 datë 13.12.2025	580,000
4	Blerje mallrash	nr. 487 datë 15.12.2025	270,000
5	Blerje mallrash	nr. 20 datë 18.12.2025	99,900
6	Blerje vaj motori	nr. 214 datë 22.12.2025	118,800
7	Blerje pako ushqimore	nr. 788 datë 29.12.2025	591,600
8	Blerje materiale	nr. 168 datë 31.12.2025	504,000
9	Blerje karburanti	nr. 15676 datë 02.12.2025	422,156
10	Blerje karburanti	nr. 15676 datë 02.12.2025	664,416
11	Blerje mallrash	nr. 30 datë 14.12.2025	406,919
12	Blerje karburanti	nr. 15891 datë 17.12.2025	319,200
13	Blerje karburanti	nr. 15891 datë 26.12.2025	321,528
14	Mirëmbajtje	nr. 1169 datë 29.12.2025	1,079,988
15	Mirëmbajtje	nr. 1138 datë 10.12.2025	1,079,988
	Totali		**8,896,122**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Llogaria 42, ***"Detyrime ndaj personelit"***, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Tepelenë, paraqitet në vlerën 12,689,201 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2025 në shumën 12,689,201 lekë.

Llogaria 431, ***"Detyrime ndaj shteti për tatim taksa"***, paraqitet në vlerën 892,242 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne janar 2025.

Llogaria 435, ***"Sigurime shoqërore"*** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,731,265 lekë.

Llogaria 436, ***"Sigurime shoqërore"*** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 510,803 lekë.

Llogaria 466 ***"Kreditore për mjete nën ruajtje"***, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Tepelenë, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 21,344,037 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Në aneksin nr 2/3/3 në anekset e raportit përfundimtar të auditimit është paraqitur informacioni analitik për llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".

Llogaria 467 ***"Kreditore te ndryshëm",*** është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2025 për vlerën **48,630,753** lekë, kjo llogari përbëhet si mëposhtë:
- Fatura të muaj dhjetor të cilat nuk ju ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 2,479,336 lekë dhe përbëhen nga 8 fatura tatimore dhe fatura të palikuiduara për të cilat ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 46,151,417 lekë dhe përbëhen nga 149 fatura tatimore detyrim i prapambetur pasqyruar ne llogarinë **467 "Kreditorë të ndryshëm** '

Pasqyra PF29: Detajet llogarisë "*Kreditorë të ndryshëm".*

Nr	Objekti I faturës	Data	Numri I faturës	Gjendja datë 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Gjendja 31.12.2025
1	Sherbim interneti	04.12.2025	18	0	36,000	0	36,000
2	Shpenzime uji	31.12.2025	12	0	550,752	0	550,752
3	Keshillteret	31.12.2025	12	0	336,000	0	336,000
4	Kryetaret e fshatrave	31.12.2025	12	0	288,000	0	288,000
5	Qira objekti	31.12.2025	12	0	552,000	0	552,000
6	Kreditore QKF	31.12.2025	12	0	195,840	0	195,840
7	FSHU	31.12.2025	12	0	468,794	0	468,794
8	Sherbim postar	31.12.2025	12	0	51,950	0	51,950
Totali				**0**	**2,479,336**	**0**	**2,479,336**

Burimi: Bashkia Tepelenë

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 482,187,280 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 29,411,897 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 7,868,529 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 18,656,785 lekë.
Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 20,715,416 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 2,818,642 lekë, e cila përfshin, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 11,227,209 lekë, e cila përfshin etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 447,286,661 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 185,109,408 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 185,109,408 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 29,246,845 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 24,985,602 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 114,209,376 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 121,088,877 lekë.

- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 101,901,973 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2025 totali i te ardhurave ne vlerë është 482,187,280 lekë dhe totali shpenzimeve është 447,286,661 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 34,900,619 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".

Në aneksin nr. 2/3/4 në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqitet analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 *"Pasqyra e performancën financiare"* të PF të vitit 2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. S.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.6.2. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit mbi MFK, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Pyetësori i vetëvlerësimit;
- Deklarata dhe raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik;
- Plani i veprimit për ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Krijimi dhe funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik;
- Trajnimet e stafit;
- Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
- Harta e proceseve të punës;
- Raportet e Monitorimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:
- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK;
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e sektorit publik është thelbësor për sigurimin e mirëmenaxhimit financiar, që mundëson realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente. Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, proces i cili realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, performuar dhe raportuar nga nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme si dhe nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm e të jashtëm.
Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë

menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: "Mjedisi i Kontrollit", "Menaxhimi i Riskut", "Aktivitetet e Kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi" si dhe "Monitorimi", sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me auditimin e zbatimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga Bashkia Tepelenë përgjatë vitit 2025, rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Parimi 1: ***"Angazhimin për integritet dhe vlerat etike"***
- Për vitin 2025 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me Urdhër nr. 08, datë 27.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë;
- Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2025 mbi njohjen e rregullores së brendshme dhe kodit të etikës;
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Tepelenë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme, në të cilat kryhen aktivitet Bashkia Tepelenë;
- Nuk ka procedurë të miratuar për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe marrjen e masave korrigjuese;
- Nuk dokumentohet nëse përgjatë vitit 2025 ka pasur raste të raportimit të korrupsionit për të vlerësuar linjën e raportimit dhe masat e ndërmarra nga njësia përgjegjëse për sinjalizimin;
- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj;
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në zyrën e integruar me një ndalesë), duke i'u adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 20 të Rregullores së Brendshme.

Parimi 2: ***"Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"***
- Për vitin 2025 nuk administrohet plani i veprimit për kontrollin e brendshëm. Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm;
- Bashkia Tepelenë zotëron aksione pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a, duke pasur kompetenca mbikëqyrëse, nëpërmjet anëtarit të saj në Këshillin Mbikëqyrës. Për këtë mungojnë raportimet drejtuar Bashkisë Tepelenë, mbi aktivitetin e ujësjellës-kanalizime;
- Për vitin 2025, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitur pranë nivelit drejtues dhe këshillit bashkiak. Si rezultat i këtij procesi, raportimi fokusohet në ecurinë e veprimtarisë dhe performancës financiare të institucionit dhe më pak në drejtim të raportimit të arritjeve apo problematikave në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Veç sa më sipër, nuk dokumentohet raportimi nga çdo strukturë e bashkisë;
- Gjithashtu në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Tepelenë, përcaktohet afat për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.

Parimi 3: ***"Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"***

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar (Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Organizative ka ndryshuar duke kaluar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse; Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ka në përbërje dy sektorë, si Sektori i Tatim – Taksave dhe Sektori i Financës, ndërkohë sipas rregullores së brendshme ka në përbërje Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Sektorin e Menaxhimit Financiar etj);
- Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen qartë detyrat e inspektorëve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5-vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"*, i ndryshuar;
- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit;
- Nuk administrohet raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores së brendshme me strukturën organike.

Parimi 4: *"Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave"*

- Në Bashkinë Tepelenë nuk janë hartuar "Hartat e proceseve të punës";
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA;
- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si përgjegjës i sektorit të financës;
- Në Bashkinë Tepelenë nuk është caktuar Koordinatori i Riskut.

Parimi 5: ***"Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"***

Grupi i Menaxhimit Strategjik është krijuar me Urdhrin nr. 02 datë 10.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Tepelenë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik;
- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi;
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij;
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut":

Parimi 6: ***"Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre"***

- Nga Bashkia Tepelenë përcaktohen objektiva sasiorë (vlerë monetare) në hartimin e PBA-ve dhe buxhetet vjetore, dokumente të cilat publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë;

- Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i plan-veprime vjetore operacionale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar, përjashtuar Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

Parimi 7: ***"Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave"***
- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut. Nuk administrohet dokument mbi funksionimin e grupit të menaxhimit të riskut përgjatë vitit 2025;
- Dokumentohet hartimi dhe miratimi i strategjisë së menaxhimit të riskut, me dokumentin nr. 56/2 prot, datë 10.01.2023;
- Nuk ka urdhër të titullarit të institucionit, ku çdo strukturë e Bashkisë Tepelenë të identifikojë risqet, për hartimin e regjistrit të riskut, masat për eliminimin e efektit të tyre, si dhe nuk dokumentohet përditësimi i tij minimalisht 2 herë në vit;
- Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorat e drejtorive përkatëse të institucionit;
- Në Bashkinë Tepelenë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Tatim - Taksave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryhen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Parimi 8: ***"Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime"***
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk nuk janë përcaktuar procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit. Nuk administrohen evidenca të monitorimit të riskut tek/nga menaxherët, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, e cila përbën risk për veprimtarinë e bashkisë.

Parimi 9: ***"Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm"***
- Bashkia Tepelenë nuk ka marrë masa për të bërë ndryshimet në rregulloren e brendshme, përshkrimet e punës, sipas ndryshimeve në strukturë, ku sektorë të caktuar kanë kaluar në nivel drejtorie, si dhe funksione të një drejtorie kanë kaluar në një drejtori tjetër.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit":

Parimi 10: ***"Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli"***
- Në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës;
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ;
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtoria e Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtoria e Financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA;
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave / punimeve / shërbimeve;
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhornohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave

financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë – hyrjet, etj.;
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve;
- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës;
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Tepelenë, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimor. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar;
- Bashkia Tepelenë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryhen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Parimi 11: ***"Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshëm të kontrollit të teknologjisë"***
- Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara;
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT;
- Në Bashkinë Tepelenë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;
- Në strukturën e Bashkisë Tepelenë është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Parimi 12: ***"Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave"***
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve;
- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës;
- Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.08.2018 *"Për hartimin e PF"*, i ndryshuar). Nga Auditi i Jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në

mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi":

Parimi 13: ***"Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor"***

Bashkia Tepelenë disponon faqen e saj zyrtare në web www.tepelena.gov.al ku pasqyrohet aktiviteti i saj si rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Mungojnë raporte periodike dhe të përditësuara për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, rregulloren e brendshme etj.

Parimi 14: ***"Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor"***

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e komunikimit brenda institucionit. Përsa i përket raportimit të informacionit të përpunuar, evidentohet se përgatiten për menaxhimin / drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën financiare (përmbushjen e detyrave) të njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efiçencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të këtë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre, si dhe raporte mbi aktivitete të tjera të institucionit. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

Parimi 15: ***"Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm"***

Për vitin 2025 nga Bashkia Tepelenë (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin etj) janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Parimi 16: ***"Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryhen vlerësime të vazhdueshme"***

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por nuk administrohen plotësisht raportimet e të gjithë drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave;
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet;
- Bashkia Tepelenë lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2025 e ka raportuar në MFE;
- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2025;
- Nuk ka rregulla të brendshme për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Parimi 17: ***"Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë"***

Sipas kontakteve me menaxhimin nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.

Konkluzion: Bazuar në auditimin e kryer për zhvillimin dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë për vitin 2025, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi për fushën e kontrollit të brendshëm të cilat në gjykimin profesional të grupit të auditimit ndikojnë në progresin e funksionimit të këtij sistemi dhe justifikojnë paraqitjen e një konkluzioni për vlerësimin e kryer, duke e vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm pjesërisht efektiv.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. T.P., me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë (aktualisht i larguar);
- Z. S.K., me funksion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.6.3. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit mbi NJAB, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Tepelenë;
2. Plani Strategjik 2025 - 2027, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2025;
4. Raportimi vjetor në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm:
Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brëndshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2025, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 07, datë 28.02.2025 "Për miratimin e strukturës organike", si dhe ka pasur 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist.
Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe të kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Tepelenë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon:

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim / vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
Për vitin 2025								
1	H.Q.	P/Sektori	Qershor 2024	I lartë	15	2	Në proces	Po
2	D.N.	Specialiste	Shtator 2025	I lartë	7	6 muaj	Në proces	Po
3	K.N.	Specialist (me kontratë)	2021	I lartë	39	22	I certifikuar	Po

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2025:
Plani vjetor i auditimeve i miratuar me urdhrin nr. 158, datë 21.10.2024 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë. Sipas planit vjetor të auditimit janë planifikuar për t'u audituar 8 auditime dhe nuk është realizuar asnjë prej tyre. Theksojmë se Grupit të Auditimit i'u vendosë në dispozicion vetëm një material audites me titullin "Projekt – Raport Auditimi Tematik për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, Njësitë Administrative, Sektorin e Tatim Taksave, si dhe Detyrimet e Prapambetura", pra auditim i papërfunduar. Auditimet e planifikuara për vitin 2025 janë pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Subjekte të Audituara		
	Planifikuar 2025	Realizuar 2025	Niveli i Riskut
1	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Jo	I lartë
2	Drejtoria Ligjore dhe Shërbimet Organizative	Jo	I mesëm
3	Sektori i Tatim -Taksave	Jo	I lartë
4	Tre Njesitë Administrative	Jo	I lartë
5	Detyrimet e prapambetura	Jo	I lartë
6	Zbatimi i rekomandimeve	Jo	I lartë
7	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Jo	I lartë
8	Drejtoria e Rrugëve Rurale	Jo	I lartë

Të dhëna sipas raportimit – Viti 2025								
Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit:						
		Përputh.	Financ.	Kombin.	Performancë	Tematik	IT	Zbat. Rek.
8	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: NJAB Tepelenë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Plani strategjik 2024 - 2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1761/3 prot, datë 21.10.2024;
- Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 344 prot, datë 13.02.2026.

Nga auditimi i raportimit të bërë në MF për vitin 2025, rezulton se janë dhënë 6 rekomandime gjithsej, të cilat janë në proces zbatimi 6 pasqyruar në tabelën më poshtë:

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				Sipas raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2025	6	0	6		1		1	

Burimi: NJAB Tepelenë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 12, shkronja "b" dhe nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, i ndryshuar;
- Për vitin 2025, numri i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është sipas përcaktimit të pikës 3 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, të ndryshuar, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të këtë 3 punonjës, ndërkohë për periudhën Janar – Shtator 2025 ka pasur vetëm 2 punonjës;
- Përgjegjësi i NJAB, Bashkia Tepelenë, znj. H.Q., nuk është i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik" në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, pika 2, shkronja "b". Në këto kushte nuk duhet të ishte rekrutuar si drejtues i NJAB Tepelenë;

- Specialistja e NJAB, znj. D.N., nuk është e certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik", në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, pika 2, shkronja "b".
- Nuk dokumentohet metodologjia për vlerësimin e riskut për fushat / sistemet objekt i auditimit nga NJAB;
- Për periudhën 2025, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete / sisteme që kryhen Bashkia Tepelenë, me risk të lartë, ku sipas përcaktimit të pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit"*, si prokurimet publike, lejet e ndërtimit, shërbimet publike, etj.;
- Nuk është realizuar plani i auditimeve, nga 8 auditime të planifikuara, nuk është realizuar asnjë prej tyre, dhe për këtë nuk pasqyrohet arsye. Theksojmë se në Ministrinë e Financave është raportuar informacion tjetër, pra sikur janë realizuar 4 auditime;
- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"* dhe nenin 19 të Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, pika 1;
- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, në kundërshtim me Kreun 6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, paragrafi 6.3;
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2025 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në nenin 14 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për Auditin e Brendshëm Publik"*, i ndryshuar, shkronja "ç", pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve.

<u>Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:</u>

Në materialin e auditimit "Projekt – Raport" në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, Njësitë Administrative, Sektorin e Tatim Taksave, si dhe Detyrimet e Prapambetura (një material auditimi për fushat e mësipërme të audituara), vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit nuk është sipas formatit standard 4, kapitulli IV, në Manualin e Auditit të Brendshëm, të ndryshuar; nuk administrohet autorizimi për kryerjen e auditimit, njoftimi i fillimit të auditimit, takimi prezantues, programi i auditimit, deklaratat për konfliktin e interesit; ndarja e detyrave, dokumenti sipas formatit standard 6 *"Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"*; formatit standard 9 *"Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"*, si dhe letrat e punës, ku pasqyrohet puna audituese e kryer; Raporti i Auditimit etj.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:
- Struktura e NJAB Tepelenë, sa i përket numrit të punonjësve nuk është në përputhje me pikat 3 dhe 6 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"*;
- Nuk është zbatuar ligji për rekrutimin dhe certifikimin e drejtuesit të NJAB;
- Nuk është realizuar plani i auditimeve për vitin 2025; Për vitin 2025 nuk janë përfshirë dhe nuk janë audituar fusha me risk të lartë;
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. T.P., me funksion Kryetar i Bashkisë Tepelenë (aktualisht i larguar);
- Znj. H.Q., Përgjegjëse e Sektorit të Njësisë se Auditimit të Brendshëm.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tepelenë, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Tepelenë së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, ka devijime me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën specifike ka vlerën 347,062 mijë lekë; buxheti i rishikuar ka vlerën 372,827 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 352,760 mijë lekë ose në masën 94%.
Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 65,000 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 62,339 mijë lekë ose në masën 95%.
Sipas zërave të të ardhurave u konstatuan nivele të ulëta realizimi, si dhe tejkalime të planit duke evidentuar mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe kapaciteteve reale të arkëtimit.
Mosrealizimi i buxhetit u evidentua veçanërisht në zërin e investimeve, për vitin 2025 investimet janë planifikuar për vlerën 24,874 lekë dhe janë realizuar në vlerën 16,374 lekë ose në masën 65.8% me mosrealizim në vlerën 8,500 mijë lekë.
Në nivelin e ulët të realizimit të investimeve ndikuan dy faktorë kryesorë: mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara, si dhe mosfinalizimi brenda vitit buxhetor i disa procedurave të investimeve për shkak të afateve të nevojshme për realizimin e tyre. Kjo e fundit evidentohet edhe nga fakti se në fund të vitit rezultuan të papërdorura fonde nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike në vlerën 34,900 mijë lekë.
Sa më sipër evidentohen mangësi në planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë, të cilat kanë ndikuar në nivelin e realizimit e investimeve të planifikuara për vitet 2024-2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008*, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 39*; Ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3, shkronjat "c" dhe "ç";* Ligjin nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 2 dhe 3, pika 3*; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, pikat 79, 80 dhe 81*, si dhe VKB-të përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tepelenë rezultoi se, më 31.12.2024, stoku i raportuar ishte në vlerën 37,028 mijë lekë. Për shlyerjen e tyre, në buxhetin e vitit 2025 u planifikuan 16,500 mijë lekë, ose rreth 44.6% e stokut të mbartur, sipas VKB-së nr. 72, datë 27.11.2024.
Më 31.12.2025, detyrimet e prapambetura arritën në vlerën 46,151 mijë lekë, me një shtesë neto prej 9,123 mijë lekësh, ose rreth 24.6%, krahasuar me fillimin e vitit. Sipas të dhënave analitike, stoku në fund të vitit përbëhej nga detyrime për investime në vlerën 12,759 mijë lekë, për mallra dhe shërbime në vlerën 32,967 mijë lekë dhe për vendime gjyqësore në vlerën 424 mijë lekë. Rritja e stokut lidhet kryesisht me shtimin e detyrimeve për investime me 9,051 mijë lekë, ndërsa detyrimet për mallra dhe shërbime u ulën me 229 mijë lekë.
Pavarësisht planifikimit të fondeve për shlyerjen e detyrimeve të mbartura, Bashkia Tepelenë nuk ka arritur të ulë stokun e detyrimeve të prapambetura. Rritja e tij evidenton mangësi në menaxhimin e këtyre detyrimeve dhe rrit ngarkesën financiare mbi buxhetin e periudhave pasardhëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin të MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* pikat 153-162, nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për përditësimin e planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, duke përcaktuar grafikun e pagesave dhe burimet e financimit, si dhe për monitorimin e zbatimit të tij, në përputhje me fondet e miratuara dhe duke siguruar vijimësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu, të marrin masa që angazhimet e reja buxhetore të ndërmerren brenda fondeve në dispozicion, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizike/juridike ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e palikuiduara etj, në Bashkinë Tepelenë kryhet në programin Excel. Bashkia Tepelenë për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë ka lidhur aktmarrëveshje me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a Për vitin 2025 është lidhur aktmarrëveshja me nr. 242 prot, datë 05.02.2025.
Bashkia Tepelenë në fund të çdo muaji ka mbajtur akt-rakordimin me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a Në akt-rakordimet e mbajtura përcaktohet shuma e arkëtuar sipas llojit të taksave/tarifave vendore dhe e ndarë sipas arkëtimeve të qytetit dhe fshatrave.
Sektori i Tatim Taksave nuk disponon regjistër për abonentët familjarë të cilëve u lind detyrimi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Gjithashtu nuk disponohet informacion nga sektori i tatim taksave për debitorët për taksat dhe tarifat vendore të cilët kanë një kontratë me UKGJ.
Nga UKGJ tarifohen vetëm abonentët familjarë të cilët kanë një kontratë me këtë shoqëri, abonentët të cilët nuk kanë kontratë nuk ngarkohen me detyrimin për taksa dhe tarifa vendore nga kjo shoqëri. Për abonentët në zonat rurale që nuk kanë infrastrukturë të rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, nuk kryhet tarifimi sipas paketës fiskale, por vetëm për taksën e tokës bujqësore.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,* Kreu XI *"Mbledhja me forcë e*

detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3 dhe Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e qeverisjes vendore",* neni 35. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave Vendore të marrë masa që:

- Të krijojë dhe administrojë regjistrin e plotë të tatimpaguesve vendorë, duke evidentuar abonentët familjarë, detyrimet, pagesat dhe debitorët sipas taksave dhe tarifave vendore të miratuara në paketën fiskale.
- Të identifikojë abonentët familjarë të cilët nuk kanë kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a me qëllim tarifimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore sipas paketës fiskale të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 101 *"Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar"* u konstatua se, më datë 31.12.2024, kjo llogari paraqitej në vlerën 2,745,782,461 lekë. Gjatë vitit 2025, llogaria është kredituar me shumën 425,711,873 lekë dhe debituar me shumën 76,928,802 lekë, duke rezultuar në shtesa neto në vlerën 348,783,071 lekë. Nga analiza e kreditimeve/debitimeve dhe çeljes së vitit ushtrimor, llogaria 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar", duhej të paraqitej në vlerën 3,094,565,532 lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar, kjo llogari është kontabilizuar në vlerën 2,887,383,260 lekë, duke rezultuar e nënvlerësuar me shumën 207,182,272 lekë. Sa më sipër veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar pika 1.1, trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 99-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për verifikimin dhe rakordimin e gjendjes fillestare dhe të lëvizjeve të llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar", si dhe për kryerjen e sistemimeve të nevojshme kontabël, me qëllim paraqitjen e saktë të gjendjes së kësaj llogarie në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025, rezultoi se:

- Llogaria 210 *"Toka, Troje, Terrene"* është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 302,847,617 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2025 dhe është kontabilizuar në vlerën 302,847,617 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.
- Llogaria 211 *"Pyje, Kullota, Plantacione"*, është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 1,149,952,273 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 20,922,391 lekë nga 2 (dy) pasuri të cilat janë certifikuar gjatë vitit 2025. Në fund të vitit 2025 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 1,170,874,664 lekë. Për këto llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.
- Llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2025 nuk kanë një regjistër të përditësuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26-27. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 99-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 *"Toka, Troje, Terrene"*, 211 "*Pyje, Plantacione*", 212 *"Ndërtesa"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore".*

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit referuar procedurës së inventarizimit të marrë masa për kryerjen dhe analizimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

6. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, llogaria 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* paraqitet me tepricë neto 401,671,418 lekë. Gjatë vitit 2025 ka shtesa të AAM-ve nga blerjet me pagesë në shumën 14,311,634 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 7,352,815 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 117,135,523 lekë. Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 21,140,601 lekë.
Nga informacioni për aktivet e kontabilizuara në llogarinë *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* janë konstatuar 2 (dy) projekte që nuk janë marrë në dorëzim dhe janë kontabilizuar në këtë llogari në vlerën 10,811,634 lekë.
Projekti "*Rikonstruksion shkolla Avni Rustemi"* është marrë në dorëzim gjatë vitit 2025, për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 129,178,400 lekë dhe është kontabilizuar me vlerën 120,635,523 lekë. Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerën e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer plotësisht detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE-së nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 16, shkronjat "b" dhe "d", si dhe pika 18, shkronja "b". (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 99-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor për aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"*. Aktivet në këtë llogari të kontabilizohen në momentin kur merren në dorëzim dhe jo në momentin e likuidimit të plotë të detyrimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

7. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* paraqitet me tepricë neto 955,822,413 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* paraqitet në shumën 746,849,236 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi pasur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 5,000,000 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 254,279,619 lekë. Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 50,306,443 lekë. Nga informacioni për aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* 4 (katër) projekte me vlerë 259,279,619 lekë janë marrë në dorëzim përpara vitit 2025 dhe duhet të kontabilizoheshin në këtë llogari në vitin në të cilin janë marrë në dorëzim dhe me vlerën e plotë të projektit.
Nga auditimi u konstatua se projekti *"Rikonstruksion Ujësjellësi Nivicë-Peshtan"* është kontabilizuar për vlerën 221,371,560 lekë, ndërkohë që vlera e kontratës me TVSH është 232,667,018 lekë dhe projekti *"Rikonstruksion Ujësjellësi fshati Salari"* është kontabilizuar për vlerën 32,908,059 lekë ndërkohë që vlera e kontratës me TVSH është 34,697,238 lekë.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE-së nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, Kreu

III, pika 16, shkronjat "b" dhe "d". (*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 99-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për verifikimin e dokumentacionit financiar dhe teknik të katër projekteve dhe kryerjen e sistemimeve të nevojshme kontabël në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore",* duke pasqyruar vlerën e plotë të kostos së dokumentuar të aktiveve dhe amortizimin përkatës nga momenti i marrjes së tyre në dorëzim. Gjithashtu, të marrë masa që njohja e aktiveve në këtë llogari të kryhet në periudhën kur merren në dorëzim, pavarësisht likuidimit të plotë të detyrimeve ndaj kontraktorëve.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

8. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Tepelenë llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se 2 (dy) investime në proces janë kontabilizuar në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione". Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 janë *"Rikonstruksion njësia administrative Qendër"* me vlerë 2,941,518 lekë dhe *"Përmirësim i banesave për komunitetet e pafavorizuara"* me vlerë 7,870,116 lekë dhe me vlerë amortizimi 0 lekë për secilin aktiv. Kontabilizimet e mësipërme kanë nënvlerësuar llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" dhe mbivlerësuar llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" për vlerën 10,811,634 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE-së nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 18, shkronja "b". *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 99-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pagesat e pjesshme për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Investime në proces" dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **10** procedurave të prokurimit në **5** procedura me fond limit 162,383 mijë lekë, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj. si më poshtë:

- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 10.03.2023 dhe me fond limit 11,725,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit. Mjetet e Bashkisë Tepelenë nuk kanë të miratuar normative për sasinë e konsumit të karburanteve.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 08.02.2024 dhe me fond limit 12,512,500 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 11.03.2025 dhe me fond limit 13,500,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i vend-parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait)"* me datë të zhvillimit të tenderit 09.01.2025 dhe me fond limit 15,869,299 lekë pa TVSH. Në projektin e miratuar nuk është përcaktuar se sa do të jetë sipërfaqja e parkimit, gjatësia dhe gjerësia e rrugës që të çon në parking, nëse do të kryhen punime të shtresave rrugore për ndërtimin e parkimit, si: gërmim, mbushje me çakëll, stabilizant, binder, asfalt.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi"* me datë të zhvillimit të tenderit 16.08.2023 dhe me fond limit 108,776,265 lekë pa TVSH. Nga kontrolli i dokumentacionit të dosjes u konstatua se nuk ka gjurmë dokumentare

mbi përllogaritjen e fondit limit; nuk ka një dokument justifikues ku të përcaktohet qartë vlera e fondit limit, dhe si është arritur në këtë vlerë, pasi në dosjen ligjore u gjet një preventiv bosh, pa çmime dhe pa zëra pune, pa volume si dhe pa vlerë të kapitujve të punimeve që do të kryhen.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, *"Për prokurimin publik", i ndryshuar,* neni 34, pikat 1 dhe 2, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* e ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe pika 2, shkronjat "a" dhe "c"; neni 15, pika 3, shkronja "a"; neni 39, pika 2; neni 76, pikat 1 dhe 2; dhe neni 78, pika 2. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 34-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Sektori i Prokurimit Publik në Bashkinë Tepelenë, për procedurat e prokurimit të marrë masa që përllogaritja e fondit limit të kryhet dhe dokumentohet në përputhje me metodat e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator të prokurimit publik, duke u mbështetur në të dhëna të argumentuara dhe të verifikueshme për çmimet e tregut, kontratat e mëparshme ose burime të tjera të lejuara, sipas natyrës së objektit të prokurimit, me qëllim përcaktimin sa më real të vlerës së kontratës dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **10** procedurave të prokurimit në **8** procedura me fond limit prej 201,338 mijë lekë, janë konstatuar shkelje të dispozitave të LPP, konkretisht parregullsi në hartimin e kritereve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 10.03.2023 dhe me fond limit 11,725,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 08.02.2024 dhe me fond limit 12,512,500 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksioni i godinës së Njësisë Qendër, Bashkia Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 27.02.2024 dhe me fond limit 8,750,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 11.03.2025 dhe me fond limit 13,500,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje mjete motorike fadromë dhe borëpastruese"* me datë të zhvillimit të tenderit 06.10.2025 dhe me fond limit 12,750,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"* me datë të zhvillimit të tenderit 01.09.2025 dhe me fond limit 17,455,701 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i vend-parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait)"* me datë të zhvillimit të tenderit 09.01.2025 dhe me fond limit 15,869,299 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë* me datë të zhvillimit të tenderit 09.01.2025 dhe me fond limit 108,776,265 lekë pa TVSH.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, neni 77, pika 1, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* e ndryshuar, neni 2, pika 2, shkronja "c"; neni 39, pika 4, për kontratat e punëve; neni 40, pika 3, për kontratat e mallrave; dhe neni 78, pika 2, për argumentimin dhe dokumentimin e kritereve të kualifikimit.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 34-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Sektori i Prokurimit Publik në Bashkinë Tepelenë, në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, të marrë masa të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **5** procedurave nga **10** të audituara, u konstatua se OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Tepelenë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tij u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të veçanta të vendosura në DST.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje materiale ndërtimi "* me datë të zhvillimit të tenderit 20.02.2023 dhe me fond limit 4,166,561 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksioni i godinës së Njësisë Qendër, Bashkia Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 27.02.2024 dhe me fond limit 8,750,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Tepelenë"* me datë të zhvillimit të tenderit 11.03.2025 dhe me fond limit 13,500,000 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i vend-parkimit, pjesëve funksionale dhe info Point-it (Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait)"* me datë të zhvillimit të tenderit 09.01.2025 dhe me fond limit 15,869,299 lekë pa TVSH.
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i godinës dhe shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi" Bashkia Tepelenë* me datë të zhvillimit të tenderit 09.01.2025 dhe me fond limit 108,776,265 lekë pa TVSH.

Në procedurat e mësipërme është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në moszbatim të plotë të kuadrit ligjor, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë në kushtet kur, këta të fundit, nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 160, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 92, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 82, pika 2.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 34-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertuesve të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit (DST).

Menjëherë

11.2. Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), gjatë fazës së vlerësimit të një procedure, të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë, vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë, Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran", Bashkia Tepelenë* me nr. 3360/13 prot, datë 26.04.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit B.O.E "2." sh.p.k& "G." sh.p.k me vlerë kontrate 232,667,018.4 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të

ndërtimit. Periudha e garancisë së punimeve është 2 vjet nga përfundimi i punimeve. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 809/2 prot, datë 20.07.2023, me kolaudator Ing. F.S., me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3.4. Akti i kolaudimit për të dy nënobjektet është hartuar në datë 08.08.2024, ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është mbajtur në datë 23.04.2024 për nënobjektin nr. 1 "Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë" dhe në datë 28.08.2024 për nënobjektin nr. 2 "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran". Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vihet re se në këtë kontratë të lidhur mes palëve mungon afati i kolaudimit të objektit, mungesë e cila ka sjellë vonesa në hartimin e plotë të aktit të kolaudimit, pasi është kryer fillimisht një kolaudim i pjesshëm i nënobjektit nr. 1 në datë 15.02.2024 dhe më pas kolaudimi përfundimtar i të dy objekteve në datë 08.08.2024. Vonesa në kolaudimin në kohën e duhur të objektit sjell si pasojë mosvënien në punë dhe në funksion të objektit si dhe rrjedhimisht amortizimin e tij.
Në lidhje me kontratën tjetër me objekt: *"Ndërtimi i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë"* me nr. 207/6 prot, datë 14.04.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit OE "2." sh.p.k. Vlera e kontratës është 33,879,243.24 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 1433/1 prot, datë 04.09.2023, me Kolaudator inxhinier F.S me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3..4. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 04.09.2023 ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është mbajtur në datë 03.05.2024. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vihet re se në këtë kontratë të lidhur mes palëve mungon afati i kolaudimit të objektit, mungesë e cila ka sjellë vonesa në hartimin e plotë të aktit të kolaudimit. Vonesa në kolaudimin në kohën e duhur të objektit sjell si pasojë mosvënien në punë dhe në funksion të objektit si dhe rrjedhimisht amortizimin e tij.
Kjo në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar*. Udhëzimi nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu II "Zbatimi I Punimeve Të Ndërtimit" pika 10.2, neni 8.2.* Udhëzim nr. 3, datë 15.2.2001 *"Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të ndërtimit – neni 22 dhe neni 25 Për Kolaudimin e Punimeve".*
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tepelenë, në procedurat e ardhshme të kolaudimit të objekteve të detajohet kontrata me kolaudatorët, ku të përcaktohet afati i kohëzgjatjes së procesit të kolaudimit, vlera e shërbimit të kolaudimit, të drejtat, detyrat dhe penalitetet e secilës palë etj.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Tepelenë është konstatuar se:
- Referuar strukturave organizative të Bashkisë Tepelenë për periudhën nën auditim (2023 – 2025) dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**,** në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, rezultoi se ka pasur në përbërjen e tij maksimalisht 2 punonjës,1 kryeinspektor dhe 1 inspektor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, ku parashikohet se kjo strukturë duhet të këtë në përbërje minimalisht 6 (gjashtë) punonjës;
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezultoi se në IMTV Bashkia Tepelenë ka qenë i punësuar një punonjës (me profil arsimor "Akademia

ushtarake") që nuk plotëson kriteret arsimore të përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar;
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tremujore dhe/ose vjetore të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë. Nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë nuk janë hartuar këto plane periodike pune;
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV Bashkia Tepelenë nuk janë hartuar dhe dërguar në IKMT këto raportime;
- Nga auditimi i procedurës së mbajtur nga IMTV në subjektin "G." sh.p.k, sipas procesverbalit me nr. serie 0000039, datë 14.02.2023, është konstatuar se kjo procedurë është mbajtur në praninë e vetëm një inspektori, edhe pse dispozitat ligjore përcaktojnë qartësisht se IKMT dhe IMTV kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika 1. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 86-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Tepelenë të merren masat për plotësimin e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në përputhje me dispozitat ligjore (minimalisht 1 kryeinspektor dhe 5 inspektorë). Gjithashtu, nga Bashkia Tepelenë të merren të gjitha masat që arsimimi i punonjësve të IMTV-së të jetë sipas kritereve të parashikuara.

Në vijimësi

13.2. Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të merren masat:
- për të hartuar periodikisht, respektuar dhe përmbushur planet dhe programet e punës (mujore/tremujore/vjetore). Gjithashtu, nga IMTV duhet të merren masa për të rritur bashkëpunimin me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim monitorimin e të gjitha lejeve të miratuara nga Bashkia Tepelenë;
- për të raportuar periodikisht në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) çdo tre muaj për masat e marra nga IMTV;
- për të kryer inspektime dhe për të mbajtur akt-konstatimet nga minimalisht dy punonjës të pranishëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Tepelenë, është konstatuar se në disa raste nuk janë zbatuar plotësisht dispozitat ligjore dhe nënligjore lidhur me dokumentimin e kundërvajtjeve, ndjekjen e procedurave administrative, ekzekutimin e vendimeve dhe arkëtimin e gjobave. Konkretisht, ***në gjashtë raste***, kundërvajtjet nuk janë dokumentuar me evidenca fotografike ose fotografitë nuk janë bërë pjesë e dosjes (trajtuar gjerësisht në pikën 2.5.3 të raportit përfundimtar të

auditimit). ***Në një rast***, nuk është kryer inspektimi i dytë për verifikimin e marrjes së lejeve të nevojshme për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, ndërsa gjendja faktike dhe ndryshimet në projekt nuk janë dokumentuar plotësisht (trajtuar gjerësisht në pikën 2.5.3 të raportit përfundimtar të auditimit). ***Në pesë raste***, nuk janë marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimeve të prishjes (trajtuar gjerësisht në pikën 2.5.3 të raportit përfundimtar të auditimit). ***Në dy raste***, nuk janë referuar indiciet për veprën penale pranë organeve ligjzbatuese (trajtuar gjerësisht në pikën 2.5.3 të raportit përfundimtar të auditimit). ***Në një rast***, nuk është marrë vendimi për pezullimin e punimeve, ndonëse ky veprim parashikohet nga legjislacioni në fuqi (trajtuar gjerësisht në pikën 2.5.3 të raportit përfundimtar të auditimit).
Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të plotë të përgjegjësive dhe procedurave ligjore nga strukturat përgjegjëse të IMTV-së, si dhe i mungesës së kontrollit të mjaftueshëm mbi vijimin e procedurave pas konstatimit të kundërvajtjeve administrative. Si pasojë, nuk është garantuar dokumentimi i plotë i kundërvajtjeve dhe ndjekja e të gjitha masave administrative për pezullimin dhe prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, si dhe referimi i rasteve me indicie për vepra penale pranë organeve ligjzbatuese.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 5, 12 dhe 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, nenin 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, si dhe nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 86-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Tepelenë të merren të gjitha masat për t'i siguruar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor mundësinë e bashkëpunimit me ente apo autoritete të tjera për ekzekutimin e vendimeve të prishjes së objekteve të kundërligjshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2. Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të merren masa për përmirësimin e procesit të evidentimit, dokumentimit, ndjekjes dhe trajtimit të kundërvajtjeve në fushën e ndërtimit, duke garantuar përshkrimin dhe dokumentimin e plotë të shkeljeve të konstatuara, kryerjen e verifikimeve pasuese, përcaktimin e saktë të masave administrative dhe ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e tyre, si dhe referimin pranë organeve kompetente të rasteve që përbëjnë vepër penale apo kërkojnë masa të mëtejshme administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:
- Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuara gjatë vitit 2025 mbi rregulloren e brendshme;
- Për vitin 2025 nuk administrohet plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me ndryshimet e strukturës, ku sektorë të caktuar kanë kaluar në nivel drejtorie, si dhe funksione të një drejtorie kanë kaluar në një drejtori tjetër.
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5-vjeçar);
- Nuk janë hartuar "Hartat e proceseve të punës";
- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi;

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut. Nuk administrohet dokument mbi funksionimin e grupit të menaxhimit të riskut përgjatë vitit 2025;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.2, faqe 114-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi dy herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

15.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për:

- Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit "Harta e proceseve të punës".
- Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Deri më datë 28.02.2027

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Tepelenë përgjatë vitit 2025, u konstatua se:

- Nuk është dokumentuar metodologjia e përdorur për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e riskut për fushat/sistemet objekt auditimi.
- Për vitin 2025 janë planifikuar 8 auditime, por nuk është realizuar asnjë prej tyre. Në dokumentacionin e administruar nuk janë evidentuar dhe argumentuar shkaqet e mosrealizimit të planit, si dhe nuk rezulton të jetë dokumentuar analiza e përgjegjësive dhe masave të marra për korrigjimin e kësaj situate.
- Për dosjet e auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, të administruara nga NJAB, u konstatua se ato nuk janë arkivuar në arkivin e Bashkisë Tepelenë sipas kërkesave për administrimin e dokumentacionit të auditimit. Gjithashtu, NJAB nuk ka çelur dhe administruar, në formë shkresore dhe elektronike, dosjet e përhershme për njësitë/sistemet objekt auditimi.
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor të NJAB për vitin 2025, drejtuar strukturës përgjegjëse të harmonizimit të auditimit të brendshëm, nuk është hartuar me të gjithë informacionin e kërkuar, pasi nuk është pasqyruar informacion i plotë mbi veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, i ndryshuar, neni 11, pika 2, shkronja "b"; nenin 13, shkronja "ç"; nenin 14; VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, i ndryshuar, pika 3; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 *"Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik"*; Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kreu VI, pika 3.1.3 dhe paragrafi 6.3. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.3, faqe 120-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të hartojë dhe dokumentojë metodologjinë për identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe, mbi bazën e rezultateve të saj, të

hartojë dhe realizojë planin vjetor të auditimit, duke orientuar angazhimet drejt fushave dhe sistemeve me risk të lartë. Për çdo devijim nga plani i miratuar të dokumentohen shkaqet, përgjegjësitë dhe masat korrigjuese përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për administrimin e plotë të dokumentacionit të auditimit, duke çelur dhe përditësuar dosjet e përhershme, në formë shkresore dhe elektronike, për njësitë/sistemet objekt auditimi, si dhe të kryejë arkivimin e dosjeve të auditimeve të përfunduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që raportimi vjetor mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm të hartohet dhe përcillet sipas strukturës dhe kërkesave të përcaktuara, duke përfshirë informacion të plotë mbi zbatimin e rekomandimeve dhe veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Tepelenë, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:
- Nuk është kryer inventarizimi i plotë i aseteve në pronësi/përdorim të Bashkisë Tepelenë.
- Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe i trojeve të zëna me ndërtesa, të cilat, sipas rastit, i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Tepelenë nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore.
- Nga 2,996 asete gjithsej, Bashkia Tepelenë ka regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie vetëm 216 asete, me sipërfaqe 1,010.3 ha, të llojit pyje, kullota dhe truall, ose 7.2% të numrit total të aseteve.
- Nuk rezulton të jetë organizuar dhe ndjekur në mënyrë të plotë procesi i inventarizimit, plotësimit dhe përditësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe regjistrimit të pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjes së tyre me certifikatë pronësie.

Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masat e nevojshme për të regjistruar në DVASHK Tepelenë, ndryshimet në kartelën e pasurive, të cilat janë dhënë me qira me afat mbi 9 vjet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 *"Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, neni 196 dhe 197; Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*; neni 35; neni 37; neni 41; neni 44; pika 2; VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, pika 26 dhe 27. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.5, faqe 97-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në bashkëpunim me Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

17.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë të nxjerrë urdhër të brendshëm për përcaktimin e afatit konkret, si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri, si dhe ndryshimet e statusit juridik të pasurive që jepen me qira me afat mbi 9 vjet.

Deri më datë 28.02.2027

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit, është konstatuar se në të gjitha rastet e audituara (shtatë raste), dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi me Vendim nr. AR-LNM110123/3, datë 13.01.2023, zhvillues "A.R." sh.p.k – dokumentacion teknik i paplotë (projekt arkitektonik dhe elektrik), mungesë e deklaratave dhe policave të sigurimit profesional, dokumentacionit për efiçencën e energjisë dhe kontratës së sigurimit në favor të autoritetit publik.

2. Leje ndërtimi me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, zhvillues "D.R.R." sh.p.k – mungesë e studimeve gjeologo-inxhinierike dhe sizmiko-inxhinierike dhe dokumentacionit shoqërues, dokumentacion teknik i paplotë, si dhe mungesë/përfundim afati i policave të sigurimit profesional dhe kontratës së sigurimit në favor të autoritetit publik.

3. Leje ndërtimi me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, zhvillues "Z." sh.p.k – problematika në dokumentacionin e pronësisë, dokumentacion teknik i paplotë, polica sigurimi jashtë afatit, si dhe mospërputhje të dokumentacionit të VNM-së dhe efiçencës së energjisë me projektin e ndryshuar; mungon edhe kontrata e sigurimit në favor të autoritetit publik.

4. Leje ndërtimi me Vendim nr. EM-LN270225/4, datë 25.04.2025, zhvillues "E.M.", "P.F." – dokumentacion teknik i paplotë dhe mungesë e kontratës së sigurimit në favor të autoritetit publik.

5. Leje ndërtimi me Vendim nr. AR-CP211223/4, datë 04.04.2024, zhvillues "A.R." sh.p.k – procedura është shqyrtuar në 71 ditë pune, tej afatit, si dhe mungojnë dokumente dhe akte verifikuese të kërkuara për certifikatën e përdorimit, përfshirë procesverbalin e OSHEE-së, planvendosjen, evidencat fotografike për të gjitha objektet, kontratën me mbikëqyrësin dhe verifikimin e akteve të kontrollit nga autoriteti vendor.

6. Leje ndërtimi me Vendim nr. AM-CP190623/5, datë 24.07.2023, zhvillues "A.M." ,"P.F." – mungojnë polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit dhe projekti *as-built*.

7. Leje ndërtimi me Vendim nr. LÇ-CP130325/4, datë 20.03.2025, zhvillues "L.Ç.", "P.F." – mungojnë polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit, projekti *as-built*, si dhe kontrata me shoqërinë ndërtuese dhe licencat përkatëse.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, neni 39, pika 5; neni 44, pika 2; Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 *"Për noterinë"*, i ndryshuar, neni 54; VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii), iv), v); neni 27; neni 27/1, pika 3; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), f), g), j), k), l); VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi"*; Ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, Shtojca II.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 76-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>18.1. Rekomandimi:</u> Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:

- të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* me: praninë, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha projekteve ndërtimore; të kërkojnë përfshirjen në projektet ndërtimore, ndër të tjera, të dhënave si: plani i piketimit të strukturës, plani i organizimit të

punimeve, plani i sistemimit, detajet e elementëve konstruktivë; planimetritë dhe detajet me rrjetin e Ujësjellës – Kanalizimeve, largimin e ujërave të shiut, detajet për sistemet e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; studimet sizmologo-inxhinierike dhe studimet gjeologo-inxhinierike, projektin e auditimit të efiçencës së energjisë;
- të kërkojnë ngarkimin në sistemin e-lejet të dokumentacionit shoqërues si: ngarkimin e deklaratave dhe policave të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, si dhe saktësinë e tyre; plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve të pronësisë; kontratat e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit; kontratat me subjektet ndërtuese dhe mbikëqyrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në asnjë nga katër aplikimet e miratuara, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Ky mendim është kërkuar gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. Ky veprim nuk është në përputhje me dispozitat nënligjore të sipërcituara, pasi gjatë aplikimit për pajisje me leje zhvillimi nuk është i detyrueshëm hartimi / ngarkimi në sistem i të gjithë projektit ndërtimor (por vetëm i projekt – idesë arkitektonike). Si rrjedhim, autoritete si Policia e Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit, Drejtoria Rajonale e Ujësjellës – Kanalizimeve, Operatori për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike apo Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk mund të shprehen dot mbi përputhshmërinë e projektit, apo mbi sigurimin e infrastrukturës kryesore në parcelë. Gjithsesi, edhe pse në këto kushte, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim mendim-marrjen gjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lart cituar, rezulton se:
1. Leje ndërtimi me Vendim nr. AR-LNM110123/3, datë 13.01.2023, zhvillues "A.R." sh.p.k – DPKZHT është mjaftuar me miratimin në heshtje nga DV ASHK dhe nuk ka respektuar mendimin e AZHT lidhur me konvertimin e resursit të pronës nga "Arë" në "Truall", i cili nuk rezulton të jetë kryer përpara miratimit të lejes;
2. Leje ndërtimi me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, zhvillues "D.R.R." sh.p.k – nuk janë administruar në fazën e lejes së ndërtimit mendimet e MTM, AKZM, ARRSH, AEE, OSHEE, PMNZSH dhe UK, sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse. Në veçanti, leja është miratuar pavarësisht se ARRSH nuk kishte dhënë miratimin dhe kishte kërkuar aplikim për hyrje-dalje nga aksi rrugor;
3. Leje ndërtimi me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, zhvillues "Z." sh.p.k – nuk është kërkuar konfirmimi i UPT-së për reflektimin e rekomandimeve të oponencës teknike dhe nuk janë reflektuar sugjerimet e tij për konstruksionin; gjithashtu, nuk është kërkuar mendimi i AEE në fazën e lejes së ndërtimit;
4. Leje ndërtimi me Vendim nr. EM-LN270225/4, datë 25.04.2025, zhvillues "E.M.", "P.F." – DPKZHT është mjaftuar me miratimin në heshtje nga DV ASHK Tepelenë.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 76-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë, të marrë masa për sigurimin dhe dokumentimin e mendimeve/miratimeve të të gjitha autoriteteve kompetente gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, në përputhje me tipologjinë e objektit dhe legjislacionin në fuqi, duke përfshirë edhe dokumentacionin e nevojshëm nga Drejtoria Rajonale e ASHK-së mbi statusin e pronësisë dhe të dhënat kadastrale të pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për katin përdhe me përdorim shërbim dhe distancat nga kufiri i pronës. Këto parregullsi do të duhej të ishin evidentuar nga Drejtoria së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit gjatë shqyrtimit të këtyre aplikimeve. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. RDR-LNM160424/3, datë 16.05.2024, për objektin ***"Strukturë akomodimi agroturistike 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë"***, me zhvillues "D.R.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë minimale të lejuar të katit me funksion "shërbim". Lartësia faktike e katit 0 (dysheme - dysheme) është 3.4 metra. Lartësia minimale e lejuar, sipas përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 3, nënpika c) është 4 metra;
- Objekti i miratuar nuk respekton distancat nga kufiri i pronës. Referuar nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Distanca që objekti do të duhej të respektonte nga kufiri i pronës është 3 metra. Distancat faktike variojnë nga 0 metra – 0.8 metra. Në këtë aplikim është ngarkuar një akt – marrëveshje midis Bashkisë Tepelenë (përfaqësuar nga Kryetari, z. T.P.) dhe z. N.S. (pronar i parcelës në zhvillim), nr. 928 prot, datë 02.05.2023, ku Bashkia Tepelenë pranon distancat e propozuara nga zhvilluesi. Ky dokument është në mospërputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pasi vendim-marrja për mosrespektimin e distancave urbane nuk është në tagrin e Bashkisë Tepelenë;

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë minimale të lejuar të katit me funksion "shërbim". Lartësia faktike e katit 0 (dysheme - dysheme) është 3.7 metra. Lartësia minimale e lejuar, sipas përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 3, nënpika c) është 4 metra.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 76-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë, të merren të gjitha masat për të miratuar vetëm ato aplikime për pajisje me leje ndërtimi të cilat respektojnë kondicionet urbane sipas parashikimeve ligjore, siç janë lartësia e katit përdhe me përdorim në funksion të shërbimit dhe distancat nga kufiri i pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, në tre raste janë konstatuar problematika në lidhje me zhvillimin e objekteve në përputhje me projektet e miratuara. Në një rast zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. Z-LNM010421/5, datë 22.10.2024, për objektin ***"Resort Agroturistik, Peshtan"***, me zhvillues "Z." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: Zhvilluesi ka zbatuar ndryshimin e projektit përpara miratimit të lejes për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, e cila është miratuar në 22.10.2024. Fotografimi satelitor i datës 09.07.2024 tregon se objekti "Hoteli i madh" ishte zhvilluar sipas projektit të ri (të kërkuar në

lejen për ndryshimin e projektit). IMTV Bashkia Tepelenë nuk ka kryer inspektime ose nuk i ka reflektuar këto konstatime në procesverbalet përkatëse. Veprimet janë në kundërshtim me nenin 51, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar;

2. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AR-CP211223/4, datë 04.04.2024, për objektin ***"Shtëpiza druri, kotec, serrë të çmontueshme pa themel të vazhduar në shërbim të aktivitetit bujqësor dhe ambiente për turizëm rural"***, me zhvillues "A.R." sh.p.k, me problematika si më poshtë vijon: Objekti i zbatuar rezulton me ndryshime nga projekti i miratuar, pasi është realizuar një kat pjesërisht nëntokë nënobjektin "Bar & Restorant" dhe një strukturë shtesë në pjesën jugore të tij, ndërsa "Serra" dhe "Koteci" nuk janë ndërtuar. IMTV nuk ka kryer inspektimet dhe nuk ka marrë masat përkatëse ndaj zhvilluesit, mbikëqyrësit, kolaudatorit dhe zbatuesit të punimeve, në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 dhe nenet 7, 8, 12 dhe 15 të Ligjit nr. 8402/1998. Gjithashtu, zhvilluesi ka aplikuar për miratimin e shtesës së ndërtuar me aplikimin nr. AN230220260127, në sistemin elektronik të lejeve, aplikim i cili gjatë fazës së auditimit në terren ka rezultuar të jetë në shqyrtim;

3. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. AM-CP190623/5, datë 24.07.2023, për objektin ***"Rikonstruksion dhe shtesë kati"***, me zhvillues "A.M." P. F., me problematika si më poshtë vijon: Zhvilluesi nuk ka përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Afati i përfundimit ka qenë 07.10.2022, ndërsa sipas deklaratës së përputhshmërisë, punimet kanë përfunduar më 21.02.2023, me vonesë mbi katër muaj. Nga IMTV nuk rezultojnë inspektime, vendim për masë administrative apo dokumentacion për verifikimin dhe ndëshkimin e shkeljes së afatit, në kundërshtim me nenin 52, pika 1, nënpika dh), të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar;

4. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. LÇ-CP130325/4, datë 20.03.2025, për objektin ***"Ngritje një kat shtesë banese"***, me zhvillues "L.Ç." P. F., me problematika si më poshtë vijon: Objekti i ndërtuar rezulton me ndryshime nga projekti i miratuar, pasi veranda (e parashikuar e hapur) është mbyllur dhe kthyer në ambient banimi, si dhe është shtuar një dritare e paparashikuar në projekt. Nga IMTV nuk janë kryer inspektime për verifikimin e zbatimit të projektit dhe nuk rezultojnë masa administrative për këto ndryshime. Veprimet janë në kundërshtim me nenin 52, pika 1, nënpika ë), të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 76-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1. Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tepelenë, të merren të gjitha masat për të kryer inspektime të vazhdueshme në objektet e pajisura me leje ndërtimi, për të monitoruar zhvillimin e tyre sipas lejeve të miratuara.

Në vijimësi

21.2. Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tepelenë, të merren të gjitha masat për të kryer inspektime në objektet e konstatuara nga grupi i auditimit, me qëllim verifikimin e kundërvajtjeve, si dhe marrjen e masave ligjore të parashikuara për zhvilluesit, ndërtuesit, mbikëqyrësit e punimeve apo çdo person tjetër që konstatohet në shkelje të ligjit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, gërmat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkisë Tepelenë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore,

duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,685,246 lekë pa TVSH** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi",* Bashkia Tepelenë me nr. 1187/23 prot, datë 20.09.2023, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe Operatorit Ekonomik B.O.E "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k. Vlera e kontratës është 129,178,400 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 muaj nga data e njoftimit në Bashkinë Tepelenë. Nga verifikimi i dokumentacionit teknik-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren sipas zërave të punës më poshtë:
- Në lidhje me zërat e punës me nr. analizë "*2.273/5 – Veshje shkallësh të brendshme me pllaka mermeri t=3cm*" (19.25 m²) dhe zërin "*2.273/5 – FV mermere pragje dritareje t=3cm*" (80.90 m²), me vlerë 595,734 lekë pa TVSH, në terren u konstatua se mermeri ishte vendosur me trashësi 2cm nga 3cm. Me çmim të rillogaritur (2/3cm × 5,948.42 = 3,965.6 lekë/m²), vlera faktike e tyre është 397,156 lekë. Diferenca prej 595,734 lekë-397,156 lekë=**198,578 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*2.324/b – Plintuse grez importi h=10cm*" (845.52 ml), në terren u konstatua se plintuset ishin vendosur me lartësi 8 cm nga 10cm. Me çmim të rillogaritur (80% × 387.8 = 310 lekë/ml), vlera faktike e tyre është 262,314 lekë kundrejt 327,893 lekë të situacionuara. Diferenca prej (327,893-262,314.1)= **65,579 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*2.206 – Kasete shkarkimi me llamarinë xingat*" (11 copë), u konstatua se në objekt ishin vendosur vetëm ulluqe vertikale dhe horizontale pa kaseta shkarkimi. Vlera prej **17,185 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An – Veshje fasade me polisterol t=7cm + rrjetë + suva*" (647 m²), rezultuan 26 m² më pak, sepse në llogaritje ishte përfshirë një objekt ekzistues ngjitur me fasadën. Vlera e kësaj sasie prej **104,000 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An – F.V Rrethim me rrjetë metalike rombi h=6m*" (542 m²), në terren rezultoi se një pjesë e rrethimit ishte realizuar me rrjetë najloni. Nga verifikimi i librezës së masave rezultoi një diferencë prej 136 m², me vlerë **176,800 lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An-35*" dhe "*An-36 – Pajisje e brendshme VRF Full DC Inverter*", në terren rezultoi se në 8 njësi kondicionimi kishte rrjedhje uji për shkak të montimit jo korrekt. Vlera e montimit, **52,000 lekë pa TVSH**, përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An-11 – Ndriçues LED 60×60, 20W*" (286 copë), ndriçuesit e vendosur ishin 25×25 cm. Me raportin e sipërfaqeve (17%), çmimi zbret nga 3,000 në 520.83 lekë/copë. Diferenca prej **709,042 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An-30 – Central alarmi zjarri 8×30 sensorë*", në terren rezultoi se centrali nuk ishte vendosur në dhomën teknike IT. Vlera prej **145,000 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës me nr. analizë "*An-57 – 4TB Video Server Storage*", në terren rezultoi se pajisja nuk ishte vendosur në dhomën teknike IT. Vlera prej **45,000 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tepelenë në vlerën 1,513,183 lekë pa TVSH, nga shoqëria B.O.E "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k shkaktar të dëmit ekonomik.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,513,183 lekë pa TVSH** nga shoqëria B.O.E "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k shkaktar të dëmit ekonomik, për diferencat në lidhje me volumet e punimeve të likuiduara, por të parealizuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga ana e grupit të auditimit GA u krye shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë, Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran", Bashkia Tepelenë* me nr. 3360/13 prot, datë 26.04.2021, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe Operatorit Ekonomik B.O.E "2." sh.p.k & "G." sh.p.k. Vlera e kontratës është 232,667,018.40 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga data e njoftimit në Bashkinë Tepelenë. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

Për nënobjektin nr. 1*"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë"*

- Në lidhje me zërin e punës *"Anal R–1 – Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 15 km"*, në kapitullin *"Ndërtimi i kaptazhit të burimit"* (133.86 m³), nga libreza e masave rezultoi se nga volumi i gërmimeve nuk ishte zbritur volumi i mbushjes prej 19.41 m³. Vlera prej **13,300 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës *"Anal R–2 – Transport betoni me autobetonierë 35 km"*, në kapitullin *"Punime ndërtimi – Depoja e re 200 m³"* (138.74 m³), në sasi ishin përfshirë gabimisht 66.94 m³ të zërit të punës *"2.136/1 – Mure b/a për rezervuarë rrethorë h~4m, C16/20, t=21~30cm"*. Ky zë e ka transportin e betonit të përfshirë në çmim. Vlera prej **267,760 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punës *"Anal R–21 – Suva me sika"*, në kapitullin *"Punime ndërtimi – Depoja e re 200 m³"* (285.19 m²), në terren u konstatua se suvaja nuk ishte realizuar në 46.33 m² të mureve të depos. Vlera prej **160,308 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.

Vlera totale e dëmit ekonomik për këtë nënobjekt është 441,368.24 lekë pa TVSH.

Për nënobjektin nr. 2*"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"*

- Për zërin e punës *"3.89/a – Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"* (3,950 m³), nga libreza e masave rezultoi se ishin përfshirë gabimisht 142.1 m³ për rrugën e re (km 4+100 – km 4+495). Ky volum mbivendoset me gërmimet për hapjen e trasesë së linjës. Vlera prej **56,840 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"Anal R–1 – Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 15 km"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"* (8,375 m³), volumi i gërmimit të mbivendosur duhet zbritur edhe nga transporti (142.13 m³ × 700 lekë/m³). Vlera prej **99,491 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"3.352 – Mbushje, ngjeshje me gurë kave"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"* (1,950 m³), ishin përfshirë gabimisht 94.8 m³ (395×0.6×0.4) për rrugën e re (km 4+100 – km 4+495). Kjo sasi mbivendoset me mbushjet e seksionit tërthor të linjës. Vlera prej **170,640 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Për zërin e punës *"2.15 – Mbushje, ngjeshje me material të gërmuar"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"* (85 m³), libreza e masave nuk sqaron ku është përdorur kjo mbushje as në cilat progresiva. Vlera prej **51,000 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"Anal R–1 – Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 15 km"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"*, nga transporti duhen zbritur edhe mbushjet e mësipërme, gjithsej 179.8 m³ (94.8 + 85). Vlera prej **125,860 lekë pa TVSH** (179.8 m³ × 700 lekë/m³) përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"Anal R–2 – Transport betoni me autobetonierë 35 km"*, në kapitullin *"Punime ndërtimi – Depoja 50 m³"* (65 m³), në sasi ishin përfshirë gabimisht zërat e punës *"2.262/3 – Shtresë betoni M150"*, *"2.133/1 – Mur beton arme M250"*, *"2.133/1 – Beton M250 themel + dysheme"* dhe *"2.122/1a – Soletë b/a C20/25"*. Këta zëra e kanë transportin e betonit të përfshirë në çmim. Vlera prej **259,920 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"Anal R–1 – Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 15 km"*, në kapitullin *"Punime rrugë për hyrjen në kaptazh"* (448 m³), nga volumi i gërmimeve nuk ishte zbritur mbushja e zërit të punës *"2.19 – Mbushje, ngjeshje me material të gërmuar"*, prej 88 m³. Vlera prej **61,600 lekë pa TVSH** (88 m³ × 700 lekë/m³) përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"2.130/1a – Beton M200 për mbështetëse të tubacionit të çelikut"*, në kapitullin *"Linja e dërgimit"* (16.6 m³), kryerja e këtyre punimeve nuk provohet as në dosjen teknike, as në dokumentacionin fotografik. Për më tepër, tubacioni është prej çeliku me diametër 57 mm dhe është vendosur në thellësi 1.55 m. Në këto kushte, shtytjet hidraulike janë të vogla dhe mbështetëset prej betoni nuk justifikohen teknikisht. Vlera prej **190,900 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik. Vlera totale e dëmit ekonomik për këtë nënobjekt është 1,016,251 lekë pa TVSH. **Vlera totale e dëmit ekonomik për të dy nënobjektet është 1,457,619 lekë pa TVSH.** *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,457,619 lekë pa TVSH** nga shoqëria B.O.E "2." sh.p.k & "G." sh.p.k shkaktar të dëmit ekonomik, për diferencat në lidhje me volumet e punimeve të likuiduara, por të parealizuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga ana e grupit të auditimit u krye shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Ndërtimi i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë"* me nr. 207/6 prot, datë 14.04.2021, lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe Kontraktorit OE "2." sh.p.k. Vlera e kontratës është 33,879,243.24 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:
- Për zërin e punës *"2.195 – Hidroizolim me bitum"*, në kapitullin *"Vepra e marrjes (kaptazhet)"* (264.54 m²), në terren u konstatua se punimi nuk ishte kryer. Vlera prej **211,632 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"2.197 – Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa katrama"*, në kapitullin *"Puseta grumbulluese"* (169.20 m²), në terren u konstatua se punimi nuk ishte kryer. Vlera prej **126,130 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.
- Për zërin e punës *"An-EL-022 – Analizator klori portativ i shoqëruar me kampionët"*, në kapitullin *"F – Makineri dhe pajisje + Pajisjet e sigurimit teknik"* (1 copë), në terren u konstatua se pajisja nuk ishte furnizuar. Vlera prej **250,656 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.

- Për zërat e punës në kapitujt *"Pajisje elektrike"* dhe *"Pajisje mbrojtëse kundër klorit"*, me vlerë 75,274 dhe 50,752 lekë, në terren u konstatua se këto zëra nuk ishin kryer. Vlera totale prej **126,026 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik.

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tepelenë **në vlerën 714,444 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve B.O.E "G.C." sh.p.k &"A." sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **714,444 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE "2." sh.p.k shkaktar të dëmit ekonomik, për diferencat në lidhje me volumet e punimeve të likuiduara, por të parealizuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Avni Rustemi", Bashkia Tepelenë* me nr. 1187/23 prot, datë 20.09.2023, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe Operatorit Ekonomik B.O.E "N.S." sh.p.k & "Sh." sh.p.k. Vlera e kontratës është 129,178,400 lekë me TVSH. Si afat i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 muaj nga data e njoftimit në Bashkinë Tepelenë. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 25.10.2024. Periudha e garancisë së punimeve është 2 vjet dhe deri në përfundim të kësaj periudhë mirëmbajtja e shkollës kryhet nga ana e OE. Nga verifikimi i situacioneve të punimeve, librezës së masave dhe verifikimit në terren, rezultoi se: Në lidhje me zërin e punës: *"An-52- Kamera colour Type 1 IP fix P jashtëm komplet"* të raportuar në sasinë 4 copë dhe *zërin "An-53- Kamera IP Dome te Type 3 UẆDR"* të raportuar në sasinë 6 copë gjatë kontrollit në terren u konstatua se edhe pse kamerat ishin montuar ato nuk ishin vënë në punë, pra nuk ishin funksionale, rrjedhimisht vlera totale e tyre **254,000 lekë pa TVSH përbën punime paefektive.** *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën totale **254,000 lekë pa TVSH,** të paguara për punime që nuk kanë prodhuar efektin e pritshëm në objektin e mësipërm.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt *"Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhinë, Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"*, nr. 3360/13 prot, datë 26.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe B.O.E *"2."* sh.p.k & *"G."* sh.p.k, rezulton se kontrata ka vlerë 232,667,018.40 lekë me TVSH dhe afat zbatimi 150 ditë kalendarike.

Për nënobjektin nr. 2, *"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran"*, punimet janë pezulluar disa herë për shkak të kundërshtimit të banorëve të Mezhgoranit, të cilët pretendonin se linja e dërgimit kalon në prona private. Si pasojë, projekti u rishikua duke realizuar vetëm linjën kryesore nga burimi te depoja 50 m³, ndërsa vepra e marrjes së ujit dhe linja drejt stacionit të pompimit u shtynë për fazën e dytë. Pa veprën e marrjes, ujësjellësi aktualisht nuk është funksional dhe investimi nuk e ka përmbushur qëllimin për të cilin u tenderua. Për këtë arsye, vlera e punimeve të kryera për këtë nënobjekt, prej **63,989,574.84 lekë pa TVSH**, konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, pa efikasitet dhe pa efektivitet, në kundërshtim me parimin 3E.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën **63,989,574.84 lekë pa TVSH** të paguara për punime që nuk kanë prodhuar efektin e pritshëm në objektin e mësipërm.

2.2. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë të marrë të gjitha masat e nevojshme që përpara se të shpallë për tenderim Fazën e II të nënobjektit nr. 2 "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Peshtan-Mezhgoran", të kryejë takime informuese me publikun dhe banorët e zonës për marrjen e dakordësisë dhe shmangien e pengesave/përplasjeve me banorët e zonës, me qëllim realizimin e plotë të investimit duke e vënë në funksion të gjithë skemën teknike të ujësjellësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Tepelenë konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 24,069 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 3,557 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 6,661 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **27,174 mijë lekë** dhe i përket 355 bizneseve.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 27,174 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mosndjekja e tyre

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Gjirokastër, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Deri më datë 31.12.2024, detyrimi i papaguar i taksës së ndikimit në infrastrukturë arrin vlerën 2,051 mijë lekë për 59 përfitues. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 394 mijë lekë për 16 persona, nga i cili është arkëtuar vetëm shuma 380 mijë lekë, duke rezultuar debitorë në vlerën 13 mijë lekë. Më datë 31.12.2025 gjendja totale debitore është 1,972 mijë lekë për 59 persona, shumë e cila përfaqëson të ardhura të paarkëtuara për Bashkinë Tepelenë.

Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Tepelenë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gjirokastër, për bllokimin e pasurisë dhe moskryerjen e veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 1,972 mijë lekë.

Brenda datës 31.12.2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se në territorin e Bashkisë Tepelenë për vitin ushtrimor 2025, kanë ushtruar aktivitet 6 subjekte që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se nga 6 subjekte 3 prej tyre e kanë kryer të plotë pagesën prej 1,000,000 lekë; ndërsa 3 subjektet e tjera kanë kryer pagesa të pjesshme nga 200,000 lekë/vit. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 344 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";* pasi kryerja e pagesës është kusht për marrjen e licencimit për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës.

Subjektet që kanë kryer pagesë të pjesshme janë:

- "O." sh.p.k me NIPT J.....I me afat licence deri më 02.08.2028 është debitor në shumën 800,000 lekë.
- "K." sh.p.k me NIPT J.....P me afat licence deri më 04.06.2028 është debitor në shumën 400,000 lekë.
- "S.G." sh.p.k me NIPT K.....V me afat licence deri më 07.07.2024 është debitor në shumën 800,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Tepelenë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës totale prej 2,000,000 lekë për subjektet.

- "O." sh.p.k me NIPT J.....I me vlerë detyrimi 800,000 lekë;
- "K." sh.p.k me NIPT J.....P me vlerë detyrimi 400,000 lekë;
- "S.G." sh.p.k me NIPT K.....V me vlerë detyrimi 800,000 lekë;

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tepelenë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë, përllogaritjen e kamatëvonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 rezultojnë 55 subjekte debitore për vlerën ***5,896,164 lekë***. Gjithashtu, në vlerën e detyrimit të palikuiduar, nuk është përllogaritur kamatëvonesa. Konkretisht, sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, në fund të vitit 2023, vlera e kamatëvonesave që nuk është përllogaritur nga Bashkia Tepelenë, për 16 subjekte është ***255,629 lekë***; për vitin 2024 vlera e penalitetit për 33 subjekte është ***1,396,176 lekë***; për vitin 2025 vlera e penalitetit për 55 subjekte është ***5,711,962 lekë***.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 *"Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" nenet 455, 481-487 dhe 698. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës debitore ***13,259,931 lekë*** (principal dhe kamatëvonesë).

Deri më datë 28.02.2027

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës midis Bashkisë Tepelenë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a u konstatua se për vitin 2024 kjo shoqëri nuk ka kaluar fonde në vlerën 18,868,344 lekë dhe për vitin 2025 nuk ka kaluar fonde në vlerën 16,442,301 lekë Bashkisë Tepelenë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me aktmarrëveshjen nr. 242 prot, datë 05.02.2025 neni 7. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1.6, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për monitorimin dhe rakordimin me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimi Gjirokastër sh.a dhe ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 35,310,645 lekë për llogari të Bashkisë Tepelenë sipas përcaktimit të aktmarrëveshjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Tepelenë, është konstatuar se në disa raste nuk janë zbatuar plotësisht dispozitat ligjore dhe nënligjore lidhur me ndjekjen e procedurave administrative dhe arkëtimin e gjobave.
Në një rast (PVKK nr. 0000041, datë 23.10.2023) është konstatuar pasaktësi në përllogaritjen e gjobës për ndërtimin pa leje të një bazamenti, i cili kërkon pajisjen me leje ndërtimi. Referuar vlerës së investimit sipas manualeve të ndërtimit, vlera e bazamentit llogaritet 121,101 lekë (11 m × 6 m × 0.13 × 14,114.35 lekë/m³), ndërsa IMTV ka vendosur gjobë 50,000 lekë, duke e trajtuar ndërhyrjen si objekt të deklaratës paraprake të punimeve. Për rrjedhojë, gjoba e vendosur është ***71,101 lekë*** më e ulët se ajo e përllogaritur nga grupi i auditimit.
Në pesë raste, nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e gjobave, përfshirë ndjekjen e procedurave të nevojshme për ekzekutimin e tyre (PVKK nr. 0000041, datë 23.10.2023; nr. 0000044, datë 27.12.2023; nr. 0000045, datë 20.11.2024; nr. 0000046, datë 06.12.2024; nr. 0000048, datë 28.03.2025). Vlera totale e gjobave për të cilat nuk janë marrë masa për arkëtimin e tyre është 10,469,000 lekë.
Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të plotë të përgjegjësive ligjore nga strukturat përgjegjëse të IMTV-së, si në përcaktimin e saktë të masës së gjobës, ashtu edhe në ndjekjen e procedurave për arkëtimin dhe ekzekutimin e tyre. Si pasojë, në një rast gjoba është përcaktuar 71,101 lekë më e ulët se vlera e përllogaritur nga grupi i auditimit, ndërsa në pesë

raste nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e gjobave në vlerën totale 10,469,000 lekë, duke krijuar risk për mosrealizimin e këtyre të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 5, 12 dhe 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, nenin 52, pika 1, shkronja "e", të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, nenet 9, 22 dhe 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*, i ndryshuar, si dhe nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 86-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për të ardhurat dhe Drejtorinë Juridike, të marrë masa administrative dhe ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e gjobave të vendosura dhe të paarkëtuara, në vlerën totale 10,469,000 lekë, si dhe të verifikojë masën e gjobës në vlerën 71,101 lekë të konstatuar më të ulët nga grupi i auditimit, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive sipas rastit.

Deri më datë 28.02.2027

D. MASA DISIPLINORE

D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

D.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja "c", Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, gërma "a" dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

- **"Vërejtje",** për punonjësin e mëposhtëm:

1. Z. D.M., me funksion kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për moskryerjen e inspektimeve në objektet e pajisura me leje ndërtimi (në një rast), për mangësitë në hartimin e planeve periodike të punës dhe raportimin periodik në IKMT, për mosdokumentimin fotografik të kundërvajtjeve (në tre raste), për mosmarrjen e masave për arkëtimin e gjobave (në tre raste), për mangësi në ekzekutimin e vendimeve të prishjes (në tre raste), mangësi në referimin e indicieve të veprave penale (në dy raste), si dhe për mosnxjerrjen e vendimit të pezullimit të punimeve (në një rast);

2. Z. G.M., me funksion kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor për periudhën 01.01.2023 - 30.11.2024, për moskryerjen e inspektimeve në objektet e pajisura me leje ndërtimi (në tre raste), për mangësitë në hartimin e planeve periodike të punës dhe raportimin periodik në IKMT, për kryerjen e inspektimeve nga vetëm një inspektor (në një rast), për mosdokumentimin fotografik dhe mangësi në dokumentimin/përshkrimin e kundërvajtjeve (në tre raste), për moskryerjen e riinspektimeve/verifikimeve (në një rast), për llogaritjen e pasaktë të masave administrative (në një rast), për mosmarrjen e masave për arkëtimin e gjobave (në tre raste) dhe për mangësitë në ekzekutimin e vendimeve të prishjes (në dy raste);

3. Z. E.L., me funksion inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për moskryerjen e inspektimeve në objektet e pajisura me leje ndërtimi (në katër raste), për kryerjen

e inspektimeve nga vetëm një inspektor (në një rast), për mosdokumentimin fotografik të kundërvajtjeve (në gjashtë raste) dhe mangësi në dokumentimin/përshkrimin e gjendjes së konstatuar në aktet e inspektimit (në një rast);
4. Znj. H.Q., me detyrë Përgjegjëse e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë. Për mosrealizimin e detyrave funksionale në zbatimin e planit të auditimeve, nga 8 auditime të planifikuara, nuk është realizuar asnjë prej tyre; Për mungesën e certifikatës së audituesit të brendshëm, detyrim ligjor për drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm; Për raportimin e pasaktë të informacionit pranë Ministrisë së Financave, për aktivitetin vjetor të vitit 2025. Për mosrealizimin e detyrave funksionale në zbatimin e planit të auditimeve, nga 8 auditime të planifikuara, nuk është realizuar asnjë prej tyre; Për mungesën e certifikatës së audituesit të brendshëm, detyrim ligjor për drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm; Për raportimin e pasaktë të informacionit pranë Ministrisë së Financave, për aktivitetin vjetor të vitit 2025.
5. Z. G.S., me funksion Drejtor i Zhvillimit Rural;
Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **5 (pesë) raste;**
6. Z. M.S., me funksion përgjegjës në Sektorin për Zhvillimin Rural si dhe në në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **9 (nëntë) raste;**
7 Z. A.A., me funksion përgjegjës në Sektorin për Zhvillimin Rural;
Për mangësitë e konstatuara në inventarizimin, vlerësimin fizik, si dhe regjistrimin e pasurive në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; Për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve të krijuara nga qiradhënia e pasurive të llojit pyll, tokë bujqësore, kullotë etj;
8. Z. R.H., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **8 (tetë) raste;**
9. Z. S.K., në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **5 (pesë) raste;**
10. Z. G.G., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **3 (tre) raste;**
11. Znj. J.K., në cilësinë e juristes së Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për problematikat e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, si dhe me funksion Kryetare i Bashkisë Tepelenë (e komanduar, aktualisht e larguar nga ky pozicion), për miratimin e lejes së ndërtimit në mungesë të Planit të Detajuar Vendor të miratuar **(në një rast)**, si dhe në cilësinë e përgjegjësit të prokurimeve, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në **10 (dhjetë) raste;**

D. 2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.
Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.
1. Z. L.B., me funksion drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (aktualisht i larguar), për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në dokumentacionin teknik dhe shoqërues të projektit ndërtimor në shtatë raste, për miratimin e lejeve të ndërtimit pa kërkuar / respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen paraprakisht në katër raste, për miratimin e lejeve të ndërtimit në kushtet e mosrespektimit të kondicioneve urbane në dy raste, për miratimin e lejes së ndërtimit në mungesë të Planit të Detajuar Vendor të miratuar (në një rast);

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Tepelenë, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për Nëpunësin Civil"* i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për Nëpunësin Civil"* i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.